Kjo kontratë lidhet bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në VKM nr.54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, proçedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", në VKB nr.33 datë 27.4.2010 "Për miratimin dhe dhënien me qira të ambjenteve në godinën e Sport Klub Elbasani "Tomorr Sinani"" dhe në VKB nr. 17 datë 11.02.2020 "Mbi dhënien me qira (rinovim kontratash) të disa ambjenteve nga Bashkia Elbasan".

Neni 3

Pagesa e Qirasë

1. Vlera e qirasë, që është në shumën 4000 (Katermijë) lekë / muaj, do të derdhet në llogarinë bankare të Klubit Shumësportesh Elbasan, nëpërmjet bankës.

2. Mënyra e pagesës zbatohet si më poshtë:
   a. Pagesa e qirasë për 3 muajt e parë (janar, shkurt, mars) 2020 do të bëhet me nënshkrimin e kësaj kontrate, deri më datë 30 prill 2020;

   b. Për muajt e tjerë pagesa bëhet për çdo muaj deri në datë 30 të muajit pasardhës;

3. Mospagesa brenda afateve, të caktuara më sipër, e ngarkon qiramarrësin me kamatëvonesë, e cila është **0,2%** e qirasë për çdo ditë vonesë të pagesës së qirasë, për mosrespektim të afateve të mësiperme, a dhe b.

Neni 4

Të Drejtat dhe Detyrimet e Qiradhënësit

1. *QIRADHËNËSI* është i detyruar të garantojë gëzimin e qetë të ambjentit (sendit objekt kontrate), kundrejt palëve të treta, të cilët mund të ngrejnë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

2. *QIRADHËNËSI* ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës dhe njofton me shkrim brenda 15 ditëve që nga momenti i konstatimit se qiramarrësi nuk është kujdesur për mirëmbajtjen e ambjenteve, kur nuk ka kryer pagesat e qirasë për më shumë se dy (2) muaj dhe / ose kur nuk ka zbatuar kushtet e kontratës.

Neni 5

Të Drejtat dhe Detyrimet e Qiramarrësit

1. *QIRAMARRËSIT* nuk i lejohet të bëjë asnjë adoptim të ambjentit të marrë me qira, që do të konsistonte në ndërhyrje në strukturën ndërtimore të objektit, pa marrë miratimin nga ana e Qiradhënësit dhe nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve në Bashki.

2. *QIRAMARRËSI* është i detyruar të riparojë të gjitha dëmtimet e mundshme që mund t'i bëhen ambjentit të dhënë me qira, si pasojë e keqpërdorimit apo pakujdesisë së tij; në të kundërt, qiramarrësi është i detyruar të dëmshpërblejë Bashkinë në masën e dëmit të shkaktuar, të vlerësuar sipas ekspertëve.

3. *QIRAMARRËSI* ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë, të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

4. *QIRAMARRËSI* ka për detyrë që të përdorë ambjentin vetëm sipas objektit të kësaj kontrate.

5. *QIRAMARRËSIT* nuk i lejohet që pronën e dhënë me qira ta japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

6. Janë në ngarkim të qiramarrësit të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e përditshme të ambjentit të marrë me qira. Qiramarrësi duhet të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj subjekteve përkatëse në lidhje me konsumin e energjisë elektrike, ujit, etj. Për këtë, qiramarrësi do të instalojë matësat përkatës dhe do të kontaktojë me subjektet furnizues. Janë në ngarkim të Qiramarrësit të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

Neni 6

Kohëzgjatja e Kontratës

Kjo kontratë lidhet me afat 1(një) vjeçar, nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020.

Neni 7

Zgjidhja e Kontratës

Amendimi (ndryshime ose shtesa) i kontratës realizohet vetëm me vullnetin e shprehur të palëve kontraktore, përveç rasteve parashikuar ndryshe në këtë kontratë.

Të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të lindin midis palëve gjatë regjimit të kontratës së qirasë, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre. Në të kundërt palët do t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Neni 8

Dispozita të Përgjithshme

Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) kopje origjinale, ku 2 (dy) kopje i mban QIRADHËNËSI, (Klubi Shumësportesh dhe Sektori Protokoll - Arkivë), 1 (një) kopje e merr QIRAMARRËSI.

Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve kontraktore.

QIRAMARRËSI

Personi Fizik

Nuri Balla

Me urdher e porosi

Zv/Kryetari; Irland Sina

QIRADHENËSI

BASHKIA ELBASAN

Kryetari

Gledian Llatja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Financieri i KSHE: B. Gjini

Pranoi:

Përgjegjësi i KSHE: M. Backa

Miratoi:

Drejtoria Juridike: O. Deliallisi

Konfirmoi:

Zv/Kryetari: A. Kovaçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ Prot. Elbasan, më 03.03.2020

KONTRATË QIRAJE

Lidhur sot, në datë 03.03.2020, midis palëve:

- ***Bashkia Elbasan,*** përfaqësuar nga Kryetari i saj, *z.* ***Gledian Llatja,*** referuar më poshtë "Qiradhënësi";

dhe

- ***Subjekti*** Jorgo Bipiku, me NUIS L53328218G, me aktivitet "Riparim e elektro shtëpiake" referuar më poshtë "Qiramarrësi";

të cilët ranë daktort sa më poshtë:

Neni 1

Objekti i Kontratës

Kjo kontratë ka si objekt dhënien me qira të ambjentit në katin e Tretë, të pallatit të sportit "Tomorr Sinani" Elbasan, me sipërfaqe 19 m^2, sipas planvendosjes bashkëlidhur, qiramarrësit, për t'a përdorur si lokal.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo kontratë lidhet bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në VKM nr.54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, proçedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", në VKB nr.33 datë 27.4.2010 "Për miratimin dhe dhënien me qira të ambjenteve në godinën e Sport Klub Elbasani "Tomorr Sinani"" dhe në VKB nr. 17 datë 11.02.2020 "Mbi dhënien me qira (rinovim kontratash) të disa ambjenteve në Pallatin e Sportit".

Neni 3

Pagesa e Qirasë

1. Vlera e qirasë, që është në shumën 2850 (dymijë e tetëqindepesëdhjetë) lekë / muaj, do të derdhet në llogarinë bankare të Klubit Shumësportesh Elbasan, nëpërmjet bankës.

2. Mënyra e pagesës zbatohet si më poshtë:
   a. Pagesa e qirasë për 3 muajt e parë (janar, shkurt, mars) 2020 do të bëhet me nënshkrimin e kësaj kontrate, deri më datë 30 prill 2020;

   b. Për muajt e tjerë pagesa bëhet për çdo muaj deri në datë 30 të muajit pasardhës;

3. Mospagesa brenda afateve, të caktuara më sipër, e ngarkon qiramarrësin me kamatëvonesë, e cila është **0,2%** e qirasë për çdo ditë vonesë të pagesës së qirasë, për mosrespektim të afateve të mësiperme, a dhe b.

Neni 4

Të Drejtat dhe Detyrimet e Qiradhënësit

1. *QIRADHËNËSI* është i detyruar të garantojë gëzimin e qetë të ambjentit (sendit objekt kontrate), kundrejt palëve të treta, të cilët mund të ngrejnë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

2. *QIRADHËNËSI* ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës dhe njofton me shkrim brenda 15 ditëve që nga momenti i konstatimit se qiramarrësi nuk është kujdesur për mirëmbajtjen e ambjenteve, kur nuk ka kryer pagesat e qirasë për më shumë se dy (2) muaj dhe / ose kur nuk ka zbatuar kushtet e kontratës.

Neni 5

Të Drejtat dhe Detyrimet e Qiramarrësit

1. *QIRAMARRËSIT* nuk i lejohet të bëjë asnjë adoptim të ambjentit të marrë me qira, që do të konsistonte në ndërhyrje në strukturën ndërtimore të objektit, pa marrë miratimin nga ana e Qiradhënësit dhe nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve në Bashki.

2. *QIRAMARRËSI* është i detyruar të riparojë të gjitha dëmtimet e mundshme që mund t'i bëhen ambjentit të dhënë me qira, si pasojë e keqpërdorimit apo pakujdesisë së tij; në të kundërt, qiramarrësi është i detyruar të dëmshpërblejë Bashkinë në masën e dëmit të shkaktuar, të vlerësuar sipas ekspertëve.

3. *QIRAMARRËSI* ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë, të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për të gjthë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

4. *QIRAMARRËSI* ka për detyrë që të përdorë ambjentin vetëm sipas objektit të kësaj kontrate.

5. *QIRAMARRËSIT* nuk i lejohet që pronën e dhënë me qira ta japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

6. Janë në ngarkim të qiramarrësit të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e përditshme të ambjentit të marrë me qira. Qiramarrësi duhet të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj subjekteve përkatëse në lidhje me konsumin e energjisë elektrike, ujit, etj. Për këtë, qiramarrësi do të instalojë matësat përkatës dhe do të kontaktojë me subjektet furnizues. Janë në ngarkim të Qiramarrësit të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

Neni 6

Kohëzgjatja e Kontratës

Kjo kontratë lidhet me afat 1(një) vjeçar, nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020.

Neni 7

Zgjidhja e Kontratës

Amendimi (ndryshime ose shtesa) i kontratës realizohet vetëm me vullnetin e shprehur të palëve kontraktore, përveç rasteve parashikuar ndryshe në këtë kontratë.

Të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të lindin midis palëve gjatë regjimit të kontratës së qirasë, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre. Në të kundërt palët do t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Neni 8

Dispozita të Përgjithshme

Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) kopje origjinale, ku 2 (dy) kopje i mban QIRADHËNËSI, (Klubi Shumësportesh dhe Sektori Protokoll - Arkivë), 1 (një) kopje e merr QIRAMARRËSI.

Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve kontraktore.

QIRAMARRËSI

Personi Fizik

Me urdher e porosi

Zv/Kryetari; Irland Sina

QIRADHENËSI

BASHKIA ELBASAN

Kryetari

Gledian Llatja

Konceptoi:

Financieri i KSHE: B. Gjini

Pranoi:

Përgjegjësi i KSHE: M. Backa

Miratoi:

Drejtoria Juridike: O. Deliallisi

Konfirmoi:

Zv/Kryetari: A. Kovaçi



272

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 699/1 prot. Elbasan më 18/02/2020

VENDIM

Nr.18 datë 11/02/2020

" Mbi bashkimin e ndërmarrjes së terreneve sportive me klubin shumësportësh Elbasan dhe rishikimin e numrit të punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve Publike".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës...../...../2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore për bashkimin e ndërmarrjes së terreneve sportive me klubin shumësportësh Elbasan dhe rishikimin e numrit të punonjësve të këtij klubi dhe të Agjensisë së Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8,9,54 të tij, ligjin 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", neni 40;

VENDOSI :

1- Ndërmarrja e Terreneve Sportive i bashkohet Klubit Shumësportësh Elbasan, duke pushuar së funksionuari si njësi buxhetore më vete.
2- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Klubit Shumësportësh Elbasan të jetë 41.
3- 11 punonjësit që do transferohen nga klubi shumësportësh do i kalojnë Agjensisë së Shërbimeve Publike.
4- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve publike shkon në 248.
5- Administrata e Bashkisë dhe ajo e njësive që bashkohen, të marrin masat për transferimin e inventarit dhe aseteve që zotërojnë, nga ndërmarrja e terreneve sportive në Klubin shumësportësh Elbasan.
6- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë , Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit, Klubi Shumësportësh, Ndërmarrja e terreneve sportive dhe Agjensia e Shërbimeve Publike.
7- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

KRYETAR

Hektor Çiftja

Konceptoi: DABNJ L.Balliu
Prgj KSHS M. Backa
Prgj NMT E.Koçia
D.Juridike O.Deliallisi
Dr.Përgj B. Çabiri
Av i Qytetit A.Hoxha
Konfirmoi: Zv/kryetar A.Kovaçi

Adresa:Bashkia Elbasan,Rr. "Qemal Stafa",Tel.+355 54 400152,E-mail bashkia elbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

273

14.02.2020

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 769/1 **Prot.** **Elbasan, më** 18 **.02.2020**

VENDIM

Nr. 19 **date** 11 **.02.2020**

"Mbi miratimin e Bordit Artistik pranë Qendrës së Artit, Bashkia Elbasan"

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e datës ___.02.2020, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) dhe në ligjin nr.10352 datë 18.11.2011 "Për artin dhe kulturën" (i ndryshuar) kreu IV, neni 28 (pika 3):

VENDOSI

1. Të miratojë Bordin Artistik pranë Qendrës së Artit, Bashkia Elbasan, si mëposhtë vijon:

• ***Kliton Kapaj***	-	*Drejtor i Qendrës së Artit*	-	*kryetar;*
• ***Fatmir Musaj***	-	*Drejtor i Drejtorisë së TKRS*	-	*anëtar;*
• ***Klinsi Lala***	-	*Regjizor*	-	*anëtar;*
• ***Astrit Lopari***	-	*Muzikolog*	-	*anëtar;*
• ***Mehdi Zena***	-	*Këngëtar*	-	*anëtar;*
• ***Enea Jorgji***	-	*Arbitër*	-	*anëtar;*
• ***Fatbardha Topuzi***	-	*Specialiste muzike*	-	*anëtare;*

2. Anëtarët e Bordit Artistik kanë mandat 4-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

3. Anëtarët e Bordit Artistik do të paguhen me një shpërblim prej 4.500 lekësh, për çdo mbledhje që do të zhvillohet, shpenzim ky që do të përballohet nga fondi i buxhetit të Bashkisë Elbasan për projektet kulturore.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe

Sporteve, Qendra e Artit dhe Drejtoria e Buxhetit në Bashkinë Elbasan.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Konceptoi:

Drejtori i DTKRS: *F. Musaj*

Drejtori i Q. Artit: *K. Kapaj*

Pranoi:

Drejtoria e Buxhetit: *M. Beluli*

Drejtoria Juridike: *O. Deliallisi*

Miratoi:

Drejtori i DPPAABF: *Q. Tusha*

Drejtori i DPShO: *B. Çabiri*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1124 Prot
11

Elbasan më 26 /02/ 2020

VENDIM
Nr. 20 datë 26 /02/2020

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin JANAR 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **JANAR 2020** gjithsej 95 familje me një fond prej 283.324 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Vendimi nr 2 datë 27.01.2020"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2020" shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

333

26.2.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1125/1 Prot Elbasan më 26 /02/2020

VENDIM

Nr 21 datë 26 /02/2020.

Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë, për muajin JANAR 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin JANAR 82 familje me fond 270.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Vendimi Nr 1 datë 27.01.2020 "Mbi dhenien e ndihmes ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin Janar 2020" shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Sh. K. Soc Komunit Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Financës A.Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr.1213 **Prot** **Elbasan më**02/03/**2020**

VENDIM

Nr. 22 **datë** 26**/02/2020**

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN"

Këshilli Bashkiak Elbasan në mbledhjen e tij të datës 21.02.2019 në mbështetje Ligjit nr. 8417 datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetë qeverisjes Vendore"

VENDOSI:

1. Të miratoj Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Elbasan, sipas tekstit bashkangjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen anëtarët e Këshillit Bashkiak, Sekretari Këshillit Bashkiak, Kryetari dhe Administrata e Bashkisë më njohjen, respektimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd GRIPSHI

KRYETARI
Hektor ÇIFTJA

Adresa:BashkiaElbasan,Rr. QemalStafa",Tel.+355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al eeb:eee.elbasani.gov.al

11.02.2020

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE **6**

Misioni i vetëqeverisjes bashkiake .....

PJESA I **6**

Objekti i rregullores .....

Qëllimi i rregullores .....

Baza ligjore .....

Përshkrimi i Termave 7

PJESA II. KONSTITUIMI DHE FUNKSIONIMI I KESHILLIT **11**

KREU I. Konstituimi i Këshillit Bashkiak .....

Thirrja e Mbledhja e Parë të Këshillit Bashkiak

Hapja e mbledhjes se parë të Këshilli 12

Verifikimi i mandateve dhe Betimi i Këshilltareve

Komisioni i Mandateve 13

Zgjedhja e Organeve Drejtuese dhe Strukturave të tjera të Këshillit 14

Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvëndëskryetarëve të Këshillit

Votimi për zgjedhjen e kryetarit dhe zv/kryetarit të këshillit

Komisioni i Votimit 15

Zgjedhja e Përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut

Emërtimin e Komisioneve të Përhershme të Këshillit

KREU II. Organizimi dhe Struktura e Keshillit

Kryesia e Këshillit 16

Lirimi dhe Shkarkimi nga Detyra i Kryetarit dhe Zv/kryetari të Këshillit

Sekretari dhe Sekretariati i Këshillit të Bashkisë

Ngritja e Sekretariatit

Kriteret dhe emërimi i Sekretarit të Këshillit.....17
Emërimi ,lirimi dhe shkarkimi i Sekretarit të Këshillit
Detyrat e Sekretarit të Këshillit
Specialistja për konsultimin me publikun dhe mediat 18
Specialisti i mbajtjes së protokollit dhe arshivës
Konferenca e kryetarëve 19
Përbërja dhe funksioni i Konferencës së Kryetarëve
Grupet e Këshilltarëve
Krijimi i grupeve të Këshilltarëve.....
Miratimi i Grupeve të Këshilltarëve
Kryesia e Grupit të Këshilltarëve.....20
Komisionet e Këshillit .....
Komisionet e Përhershëm 21
Ngritja e dhe Përbërja e Komisioneve të Përhershme 22
Vendet bosh në Komisionet e Përhershëm
Funksionimi i Komisioneve të Përhershme 23
Funksionet dhe Detyrat e Komisioneve.....
Kontrolli nga Komisionet e Përhershme veprimtarise se administrates se bashkise.....
Kryesia e Komisionit 24
Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme .....
Komisioni i Ekonomisë, Financës dhe privatizimeve.....
Komisioni i Mandateve, Ceshtjeve Ligjore dhe Administrative .....
Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit të Mbledhjes (KVPM).....
Seksioni. Komisionet e Perkohshme.....
Komisioni i Përkohshëm Hetimor 25
Ngritja e komisionit hetimor.....
Detyrimet e Kryetarit të Këshillit për Komisionin Hetimor .....
Përbërja e Komisionit 26
Hetimi dhe Raporti i Komisionit Hetimor .....
Dhënia e titujve vendorë të nderit 27
KREU III. Të Drejtat, Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit, Organeve të tij dhe Këshilltarit.....28
Kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Bashkiak.....
Të Drejtat e dhe Detyrat e Këshilltarit.....29
Detyrat dhe kompetencat e Kryetarit të Këshillit .....

Detyrat dhe kompetencat e Zv.Kryetarit 30
Detyrat e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të komisionit .....
KREU IV. Financimi i Aktiviteteve të Këshilli 30
Pagesa dhe Kompensimi i Këshilltarëve.....
Kontrolli i Jashtëm dhe Auditimi.....
KREU V. Shqyrtimit dhe Miratimi i Akteve, Rezolutave, Nismave dhe Peticioneve
Hartimi i projekt akteve 31
Paraqitja e projekt akteve.....
Njoftimi i projekt akteve/ propozimeve.....
Projekt aktet e paraqitura nga administrata e Bashkise .....
Projekt aktet e paraqitura nga komuniteti – Iniciativa qytetare 32
Shqyrtimi dhe miratimi i Peticioneve nga Publiku.....

KREU VI . Kuorumi dhe Veprimi i Këshillit
Kuorumi 33
Pjesëmarrja Mbledhjen e Këshillit e Këshilltarit, nepërmjet Sistemit AudioVideo (SAV)
KREU VII. Shqyrtimit legjislativ i Buxhetit dhe Situatës Financiare të Bashkisë
Shqyrtimit i projekt buxhetit vjetor dhe afatmesem 34
Plani i punës dhe Kalendari i shqyrtimit te projekt buxhetit nga Keshilli.....
Struktura e dokumentit te projekti buxhetit vjetor dhe afatmesen, dhe struktura e buxhetit per qytetarin dhe e raportit për zbatimin e buxhetit.....
Procesi i shyrtimit të projekt programit buxhetor afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor nga Këshilli Bashkiak.....
Shyrtimi i projekt buxhetit nga Komisioni i "Finances, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik' 36
Informimi dhe Konsultimi publik i projekt buxhetit
Dokumentimi dhe reflektimi i propozimeve per ndryshimet e projekt buxhetit pas konsultimit publik
Rishikimi i buxhetit vendor dhe rishpërndarja e fondeve..... 37
Mungesa e buxhetit të miratuar nga Këshilli.....
Shyrtimit i raportit te zbatimit te buxhetit.....
Kontrolli i brendshëm financiar publik.....
Kontabiliteti 38
Performanca e Bashkisë.....

Shqyrtimit i rasteve të Veshtirësive financiare dhe Paaftësisë paguese .....
Probleme Financiare 39
Vështirësi Financiare .....
Vështirësi Serioze Financiare .....
Situata e paaftësisë paguese .....
Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve financiare .....
KREU VIII. Mbledhjet e Këshillit 40
Mbledhjet e Radhës se Këshillit .....
Mbledhjet Jashtë Radhe .....
Mbledhje Jashtëzakonshme/Emergjence. 42
Rendi i Ditës i Mbledhjes 43
Kërkesat për pikat e rendit të ditës.....
Pika e rendi të ditës për çështje emergjente .....
Miratimi i Rendi të Ditës në Mbledhje .....
Rishqyrtimi i urdhrave, rezolutave dhe mocioneve. .....
Anullimi i Rekomandimit të Komisionit të Përhershëm
Mbajtja e Mbledhjes së Hapur 44
Mbajtja e Mbledhjes së Mbyllur .....
Procedimi i mbledhjes..... 45
Qetësia dhe Rregulli në mbledhjet e Këshillit dhe të Komisionet e Përhershme .....
Fuqitë e Kryesuesit të Mbledhjes..... 46
Debati..... 47
Procedura e Debatit.....
Replika gjatë diskutimeve..... 48
Etika gjatë proçedimit të Mbledhjes 49
KREU IX. E Drejta e Votës dhe Votimi 49
Votimi i hapur.....
Votimi i fshehtë
Barazia e votave..... 50
Shpjegimi i Votës apo Mosvotimit .....
Inspektimi i Votave të Këshilltarëve nga Publiku .....
KREU X. Marrëdhënjet me Publikun dhe Median..... 50
Informimi i Bashkësisë .....
Transparenca e Veprimtarisë së Këshillit .....

Programi i Transparencës 51
Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes 52
Publikimi i Aktet, Rezolutave dhe Deklaratave të Këshillit .....
Transmetimi direkt i mbledhjeve të Këshillit .....
Pasqyrimi i aktiviteteve të Këshillit, Komisioneve dhe Këshilltareve .....
Prezanca në Internet .....
Seksioni- Pjesëmarrja dhe Konsultimi i Publikut .....
Te drejtat e qytetareve për pjesëmarrje në qeverisjen bashkiake 53
Garantimi i pjesëmarrjes së Bashkësisë në procesin e vendimmarrjes së Këshillit .....
Mënyrat e Këshillimit me Bashkësinë .....
Seancat e Këshillimit me Bashkësinë
Standartet minimale të pjesëmarrjes së konsultimit me publikun 54
Konsultimi i Publikut me projektaktet e depozituara në Këshill për shqyrtim .....
Të drejtat e palëve të interesuara për njoftimin dhe konsultimin publik të projektakteve 55
Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve .....
Iniciativa qytetare .....
KREU XI. Kërkesat, Ankesës dhe Vërejtjet 56
E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes .....
Administrimi i kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve 57
Procedurat për shqyrtimin e ankesave
Rastet e masave disiplinore ndaj këshilltarëve .....
AKTET E KËSHILLIT 58
Vlefshmëria e Akteve .....
Shpallja dhe hyrja në fuqi e akteve 59
Dergimi i Akteve të miratura tek Prefekti .....
Anullimi dhe Shfuqizimi apo Ndryshimi i Akteve
Salla e mbledhjeve dhe pjesët e rezervuara .....
KREU XII. Administrimi i Mbledhjeve dhe Punëve të Këshillit 60
Proçesverbali i Mbledhjes .....
Në Procesverbalin e Mbledhjes së Këshillit fiksohen: .....
Perfshirja ne procesverbal e votave "kunder" 61
KREU XIII. Marredheniet e Këshillit Bashkiak me të Tretët .....
Marredhëniet me kryetarin dhe administratën e bashkisë .....
Takimet e Këshillit me Kryetarin e Bashkisë 63

Llogaridhënja e Kryetari të Bashkisë.....
Marrëdhënjet me Administratën e Bashkisë..... 64
Marrëdhëniet me Autoritetet jashë Bashkisë..... 65
Marrëdhëniet me institucioneve të qeverisjes qendrore.....
Komunikimi dhe informimi i Këshillit me organevet e qeverisjes qendrore.....
Marrëdhënjet me Deputete e Qarkut.....
Marrëdhënjet me Prefektin e Qarkut
Marredheniet me KQZ..... 66
Auditimi i performances se Këshillit.....
Monitorimi i punës së Këshillit nga Media dhe OJF-të.....
KREU XIV. Kushtet e Punës dhe Siguria e Veprimptarisë së Këshillit.....
Kushtet e punës për organet e Këshillit Bashkiak .....
Shërbimi i sigurisë në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit.....
KREU XV. Zgjedhja e Strukturave Komunitare..... 67
Perpilimi i procedurave.....
Zgjedhja e Kryesise se Fshatrave.....
Zgjedhja e Kryetarit te Kryesise se Fshatrave .....
Struktura te tjera komunitare .....
PJESA II. RREGULLORJA E KËSHILLIT..... 68
KREU XVI. Zbatueshmëria, Interpretimi dhe Ndryshimi i Rregullores.....
Zbatushmëria e Rregullores .....
Interpretimi i Rregullores.....
Ndryshimi i Rregullores.....
KREU XVII. Miratimi dhe Hyrja në Fuqi e Rregullores 69
Miratimi i Rregullores.....
Hyrja në fuqi .....

Referenca:

Rregullorja e projektit "Bashki të Forta"

HYRJE

Misioni i vetëqeverisjes bashkiake

Bashkia e Elbasanit ushtron të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e saj në kuadër të misionit të vetëqeverisjes dhe autonomisë vendore dhe siguron qeverisjen e efektshme, efikase në një nivel sa më afër qytetarëve, dhe gëzon të drejtën t'i drejtohen organeve gjyqësore me qëllim që të sigurojnë mbrojtjen e ushtrimit të lirë të kompetencave të tyre dhe respektimin e parimeve të autonomisë vendore të njohura nga Kushtetuta apo legjislacioni.

PJESA I

KONSIDERATA TE PERGJITHESHME DHE BAZA LIGJORE

Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Elbasan, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve dhe strukturave të Këshillit, si dhe marrëdhëniet e Këshillit me organin ekzekutiv të Bashkisë Elbasan si dhe institucioneve të tjera dhe me publikun.

Qëllimi i rregullores

Qëllimi kësaj rregullore është:

- Të garantojë një vendimmarrje të ligjshme;
- Të rrisë efiçencën e vendimmarrjes së Këshillit;
- Të përmirësojë marrëdhëniet mes Këshillit dhe Ekzekutivit;
- Të garantojë të drejtën e publikut për t'u informuar për punët e Bashkisë dhe vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak;
- Të garantojë transparencën e qeverisjes lokale
- Të garantojë dokumentimin e plotë të punës së Këshillit
- Të garantojë administrim efiçent të punëve të Këshillit

Baza ligjore

Baza ligjore kryesore ku mbështetet funksioni dhe përmbjatja e kësaj model rregullore është:

a. Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
b. Ligji nr. 8548 datë 11.11.1999 "Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore"
c. Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetë-Qeverisjes Vendore"
d. Ligji nr. 8480, date 27.5.1999, "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"

e. Ligji nr. 115 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive te qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"
f. Ligji nr. 44 datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"
g. Ligji nr. 107 datë 27.10.2016 "Për prefektin e Qarkut"
h. Ligji nr. 119 datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit"
i. Ligji nr. 146 datë 301.10.2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"
j. Ligji nr. 68 datë 27.04. 2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
k. Ligji nr. 152 datë 17.10.2013 "Për Nëpunësin Civil"
l. Ligji 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
m. Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile.
n. Ligji Nr. 9970/2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"
o. Ligji nr. 8137 datë 31.07.1996 "Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore"
p. Ligji nr. 10221 datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"
q. Ligji nr. 8550 datë 18.11.1999 "Statusi i Deputetit"

Përshkrimi i Termave

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, termat kanë kuptimin si më poshtë:

Akt: Çdo vendim, urdhër, urdhëresë, rezolutë, kontratë apo çdo rregullim apo veprim tjetër që ka efektin e të sipërpërmendurave, dhe që kërkohet me ligj, i shqyrtuar dhe miratuar nëpërmjet proçedurave, normave, standarteve, kritereve të miratuara nga ligji dhe rregullorja e Këshillit Bashkiak, dhe për të cilën ka votuar shumica e domosdoshme e Këshilltarëve në një mbledhje zyrtare dhe të vlefshme të Këshillit. Akti është i zbatueshëm, përsa kohë është në fuqi.

Akti administrativ: a) "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektesh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
b) "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektesh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete (KPA, Ligji nr. 44/2015).

Akt normativ nënligjor: është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik (Këshilli Bashkiak), në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij (KPA, Ligji nr. 44/2015).

Arkivi Elektronik i Akteve: është baza elektronike e të dhënave, që përmbledh të gjitha gazetat zyrtare në formatin elektronik, dhe të gjitha aktet e botuara, që është lehtësisht i përdorshëm dhe me aksesim të plotë nga publiku, në rrugë elektronike.

Buxheti i Bashkisë: është tërësia e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, miratuar nga Këshilli Bashkiak (Ligji 68/2017, neni 3/2) dhe përbëhet nga programi buxhetor afatmesëm dhe buxheti vjetor i Bashkisë.

Buxhetor afatmesëm i Bashkisë, programi: Pasqyron mënyrën e krijimit dhe të shpërndarjes së burimeve financiare afatmesme për një periudhe tre (3) vjeçare, dhe bën të zbatueshëm planin strategjik të zhvillimit të Bashkisë.

Çështje: Mocion, projekt-akt, peticion, rezolutë, raport i prezantuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Ekzekutivi i Bashkisë: Kryetari dhe administrata e Bashkisë, institucionet, ndermarrjet dhe agjencitë në varësi të Bashkisë.

Emergjencë Civile: është situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cënon sigurine e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësite që sjellin dëme të menjëhershmee të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

Fatkeqësi: është ndërprerja serioze e cfarë do lloj shkalle e funksionimit të një komuniteti ose shoqërie për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit cënueshmërisë dhe kapaciteteve përballuese, duke çuar në humbje të mundshme njërëzore, materiale, ekonomike dhe mjedisore.

Fatkeqësi Natyrore: janë fatkeqësi që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rreshqitjet arkitektonik, ortegët, erërat e forta në tokë dhe ne det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektivemasive dhe dukuri të tjera që ndikojne në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin

Fatkeqësi të tjera: janë aksidentet teknologjike rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore ekologjike ose industriale dhe aksidenti të të tjera të shkaktuar nga veprimi njerëzor, lufta ose gjendjet emergjente, përdorimi i armeve dhe mjeteve të shkatarrimit në masë, sulmet terroriste, si dhe lloje të tjera të dhunës masive.

Grup Politik: Grupim politik Këshilltarësh Bashkiak të një forcë politike elektorale ose Këshilltarësh të pavarur.

Grup nismëtar: është një grup qytetarësh, me të drejtë vote, që marrin inisiativën, hartojnë dhe paraqesin tek Këshilli kërkesën për iniciativë qytetare apo referendum vendor sipas kërkesave dhe procedurave ligjore.

Informacion konfidencial: Informacion i klasifikuar me ligj si jo publik (psh. informacion për personat që marrin ndihmë ekonomike, rekorde kriminale, rekorde mjeksore, të shëndetit mendor etj).

Informacion publik: është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.

Iniciativë qytetare: propozim me shkrim dhe i nënshkruar nga propozuesit, i paraqitur nga çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind (1%) e banorëve të bashkisë, për vendimmarrje në Këshillin Bashkiake cila ka në përmbajtjene e saj çështje që janë brenda juridiksionit të Bashkisë.

Këshilli: Këshilli Bashkiak Elbasan

Këshillimet me Bashkësinë:Përfshijnë takime të inicuara nga Këshilli i Bashkiak, të kërkuara nga ligji apo jo, e të hapura me banorët, takime me specialistët, me institucionet dhe organizatat jo-qeveritare të interesuara për çështjen në shqyrtim', apo për rastet e marrjes së nismës për organizimin e referendumit vendore.

Komision i Përhershëm: Komision me Këshilltarë Bashkiak i cili krijohet nga Këshilli në funksion të diskutimit, debatimit dhe rekomandimit të një drejtimi për veprim që duhet të marrë Këshilli për të marrë vendime në zbatim të ushtrimit të kompetencave të dhëna me ligj, i cili funksionon gjatë gjithë mandatit të Këshillit.

Komision i Përkohshëm: Komision me Këshilltarë Bashkiak i cili krijohet nga Këshilli për një qëllim të veçantë në funksion të diskutimit, debatimit dhe rekomandimit të drejtimit për veprimit që duhet të marrë Këshilli për të marrë vendime në zbatim të ushtrimit të kompetencave të dhëna me ligj, i cili funksionon për një periudhë të kufizuar deri në realizimin e qëllimit të veçantë për të cilin është ngritur.

Konsultim Publik: Tërheqja e mendimeve, sygjerimeve dhe vërejtjeve të publikut për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit deri në miratimin përfundimtar nga Keshilli Bashkiak.

KQZ: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

Konferenca e kryetarëve të grupeve.: Kryetarët e Grupimeve politike të Këshillit, këto të fundit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Kryesia: Kryetari ,N/kryerari i Këshillit Bashkiak dhe Sekretari i Këshillit.

Kryesuesi: Kryetari, Z/kryetari

Kuorum: Shumica e të gjithë Këshilltarëve, duke përjashtuarnga numërimi vendet e mundshme bosh në Këshill në momentin e llogaritjes së Kuorumit apo Këshilltarin i cili nuk merr pjesë në

mbledhje për arsye të konfliktit të interesit, shumicë e cila e bën të vlefshme për proçedim një mbledhje zyrtare të Këshillit.

Ligji organik: ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Llogaridhënie – Llogaridhënie e Këshllit për përgjegjësitë ligjore ndaj qytetarëve për punën e kryer, vendimet e nxjerra si dhe veprimet e ndërmarra;

Mbledhje e Mbyllur:Është një mbledhje ku nuk lejohet pjesëmarrja e publikut dhe e jo-Këshilltarëve. Në këtë mbledhje të lejohet të marrë pjesë Sekretari i Këshillit për të mbajtur protokollin e mbledhjes.

Mbledhje e Rregullt: Është një mbledhje e Këshillit Bashkiak e cila mbahet në datën, orën dhe vendin e caktuar nga Këshilli Bashkiak në mënyrë të përhershme sipas kësaj rregulloreje.

Mbledhje e Vlefshme:Është mbledhja e Këshillit Bashkiak gjatë proçedimeve të së cilës është i pranishëm kuroumi.

Mbledhje Emergjence: Është një mbledhje e Këshillit Bashkiak e cila mbahet në rrethana të papritura dhe emergjence gjatë proçedimeve të së cilës shqyrtohen dhe diskutohen çështje emergjente për të cilat nuk mund të pritet për 48 orë dhe ku ndërmerren veprime të menjëhershme nga Këshilli.

Mbledhje Vazhduese:Është çdo mbledhje e rregullt, jashtë radhe, emergjence dhe mbledhje e mbyllur e Këshillit Bashkiak për të cilën data, ora dhe vendi i mbajtjes së saj caktohet në mbledhjen paraparake dhe ku shqyrtohen çështje të rendit të ditës të po kësaj mbledhjeje paraprake.

Mbledhje Zyrtare:Është çdo Mbledhje e Rregullt, Mbledhje Jashtë Radhe, Mbledhje Emergjence, Mbledhje Vazhduese qoftë kjo e hapur apo e mbyllur e cila zhvillohet me pjesëmarrjen e kuorumit, dhe për të cilën data, ora, vendi dhe rendi i ditës i janë njoftuar Këshilltarëve dhe publikut sipas proçedurave të ligjit, dhe kësaj rregulloreje.

Mbledhje Jashtë Radhe:Është një mbledhje e Këshillit Bashkiak, përveç mbledhjes emergjente dhe vazhduese, e cila mbahen në një kohë dhe vend ndryshe nga ato të mbledhjes së rregullt të Këshillit.

Mocion: Parashtrim me propozim i bërë gjatë mbajtjes së Mbledhjes së Këshillit për një çeshtje të debatueshme për shqyrtim dhe vendim.

Njoftim publik për konsultim të projektakteve: është ftesa zyrtare e Këshillit Bashkiak për të marrë pjesë në procesin e konsultimit të projektaktit të propozuar për tu shqyrtuar nga Këshilli Bashkiak dhe nisjen e procedurave të konsultimit publik (ligji 146/2014, neni 2).

OJF - Organizata jofitimprurëse: kuptohet shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti (Ligji nr. 8788 datë 7.5.2001

"Për organizatat jofitimprurëse", neni 2/3) dhe që ndjekin objektiva jo fitimprurëse të themeluesve apo anëtarëve të tyre.
Organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore: Këshilli Bashkiak (përfaqësues), Kryetari i Bashkisë (ekzekutiv)

Person: Çdo person, fizik ose juridik, vendas ose i huaj.

Peticion: Kërkesë kolektive me shkrim që i adresohen Këshillit Bashkiak nga një grup interesit apo një grup organizatash, për çështje në kompetencë ligjore të Këshillit Bashkaik me qellim qe Këshilli të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me çështjen.

Prezantim: Prezantim zyrtar, i plotë dhe në përputhje me proçedurat e përcaktuara në ligj dhe rregulloren e Këshillit i një mocioni apo projekt-akti i bërë para Këshilli Bashkiak.

Proces i vendimmarrjes: përfshin proceset e hartimit e të miratimit (Ligji 146/2014, neni 2/10), të vlerësimit dhe riformulimit nga Këshilli të projektakteve, si dokument politikash, strategji, akt normativ, rregullore, rezolute, deklarate ose çdo proces ku është marrë një vendim që prek publikun, ose një segment i tij, e për të cilin Këshilli Bashkiak është investuar nëpërmjet autoritetit ligjor për ta bërë këtë.

Proçesverbali i Mbledhjes: Proçesverbali i Mbledhjes Zyrtare të Këshillit Bashkiak.

Publikim: Eshtë bërja publike e vendimeve, raporteve dhe dokumenteve të Këshillit Bashkiak, në faqen zyrtare të internetit të bashkisë dhe çdo formë tjetër të paraqitjes së informacionit/ dokumenteve për publikun/ bashkësinë (Ligji 68/2017, neni 3/7).

Referendum vendor: është referendumi që zhvillohet sipas pikës 4 të nenit 108 të Kushtetutës.

Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: Eshtë ndërfaqja në faqjen zyrtare të internetit të Bashkisë ku do të publikohen projektaktet e depozituara për shqyrtim nga Këshilli Bashkiak, sipas përcaktimeve të nenit 7 të ligjit 146/2014 'Për Informuimin Publik'.

Rekomandim: Eshtë çdo sugjerim, propozim apo mendim me karakter konsultativ për projektaktet e hartuara, i shprehur verbalisht dhe/ose me shkrim nga palët e interesuara (Ligji 146/2014, neni 2/13).

Replikë: Një qëndrim i paraqitur në mënyrë të përmbledhur nga një Këshilltar në lidhje me përmbajtjen e një diskutimi të përfunduar.

Shpallje e Aktit: Bërja publike e një akti të miratuar nga Këshilli, duke e botuar në shtypin periodik Bashkiak apo vendor, duke vendosur në këndet e njoftimit të miratuara nga Këshilli për shpallje të akteve të tij dhe vendndodhja e të cilëve është publikisht e ditur, apo duke e bërë të njohur nëpërmjet radios dhe televizionit vendor.

Shumica absolute: Shumica, 50% +1, e numrit të përgjithshëm të të gjithë Këshilltarëve Bashkiakë/Anëtarëve.

Shumica e cilësuar: Shumicë e cila është cilësuar në ligj apo rregullore të Këshillit Bashkiak, p.sh 1/3 apo 3/5 e të gjithë Këshilltarëve Bashkiak apo e Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

Shumicë e Domosdoshme: Shumica absolute, e thjeshtë apo e cilësuar që përbëjnë numrin e mjaftueshëm të Këshilltarëve për të shqyrtuar apo për të ndërmarrë një veprim ligjor për një çështje, mocion, projekt-akt, apo tre të pestat të numrit të përgjithshëm të Këshilltarëve, kjo për rastet e parashikuara në ligjin 139/2015.

Shumicë e Thjeshtë: Numri 50% +1 të këshilltarëve të pranishëm, shumicë kjo e mjaftueshme për mbajtjen e një mbledhje apo marrjen e një vendimi nga Këshilli sipas kërkesave të ligjit apo kësaj rregullore.

Takim publik: është çdo takim i hapur me palët e interesuara për diskutimin e projektakteve që i nënshtrohen procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, me qëllim sqarimin dhe informimin e opinionit publik në lidhje me këto projektakte, si dhe marrjen e komenteve e të rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tyre (ligji 146/2014, neni 2/14).

Transparencë - është veprimtaria e hapur e Këshillit Bashkiak për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese (ligji 146/2014, neni 2/15)

Vendim - nënkupton aktin normativ që nxirret nga organi kompetent bashkiak dhe në kuadër të autorizimeve të dhëna në bazë të ligjit dhe me të cilat vendoset për çështje, për të cilat kërkohet një vendim i organit përkatës;

KONSTITUIMI DHE FUNKSIONIMI I KESHILLIT

KREU I.

Konstituimi i Këshillit Bashkiak

Mbledhja e parë dhe organizative e Këshillit Bashkiak

Neni 1
Numri dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit

Këshilli Bashikak i Bashkisë Elbasan përbëhet nga 51 anëtarë. Anëtarët e Këshillit Bashkiak, zgjidhen sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Thirrja e Mbledhja e Parë të Këshillit Bashkiak Konstituimi i KB.

1. Këshilli Bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
2. Mbledhja e parë e Këshillit thirret nga Sekretari i Këshillit Bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr Prefekti. Data për mbajtjen e mbledhjes së parë të Këshillit përcaktohet nga Sekretari (ligji 139/2015, neni 48 pika 2), në konsultim të ngushtë me Kryetarin e Bashkisë dhe Prefektin. Sekretari me ndihmën e stafit të bashkisë e shpall në murin e jashtëm të godinës së bashkisë dhe e njofton në median vendore datën e mbledhjes së parë të Këshillit.
3. Sekretari dhe/apo Prefekti merr nga KQZ tabelën përfundimtare me rezultatet dhe emrat e personave të zgjedhur Kryetar Bashkie dhe anëtarët të Këshillit Bashkiak per efekt te konstituimit të Këshillit dhe shpalljes së vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë.
4. Sekretari i këshillit për mbledhjen konstituitive si rregull njofton nëpërmjet një ftese me shkrim:

   -Deputetët e Qarkut,

   -Prefektin e Qarkut,

   -Kryetarët e subjekteve politike që kanë këshilltarë në KB

   -Ish kryetarët e Bashkive,të këshillave të qarqeve dhe këshillave bashkiakë

   - Drejtuesit e institucioneve dhe komuniteteve fetare.
5. Mbi tavolinat ku ulen këshilltarët të ketë një dosje me:

   -rendin e ditës,

   -formula e betimit,me emër,mbiemër dhe nënshkrim

   -kartonat e votimit.

6. Në rast se Sekretari është i pamundur të jetë prezent në mbledhjen e parë të Këshillit, ai/ajo njofton me shkresë Prefektin së paku dy ditë përpara datës së mbledhjes. Në këtë rast Sekretari e shoqëron shkresen drejtuar Prefektit, me dokumentacionin ligjor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Për konstituimin e mbledhjes së parë të KB duhen patjetër 3 dokumente:

   -shpallja përfundimtare e rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi nga KQZ,

   -Shkresa e Prefektit të Qarkut sipas nenit 46 pika 2 e ligjit 139/2015 ku përcaktohet numri i anëtarëve të KB për çdo bashki në juridiksionin e saj, mbi bazën e numërit të banorëve sipas evidencës së ZGJC të datës 1 janar të vitit kur bëhen zgjedhjet në Bashkinë Elbasan.

   -Vertetimi i mandatit të kryetarit të bashkisë nga gjykata e rrethit gjyqësor , dhoma civile, sipas nenit 60 pika 1 e ligjit 139/2015.

Neni 3

Hapja e mbledhjes se parë të Këshillit

1. Deklarimi i hapjes së mbledhjes se parë të Këshilli bëhet nga Sekretari i Këshillit, si thirrës i mbledhjes, dhe në mungesë të tij, nga Prefeti i Qarkut.
1. Sekretari apo në mungesë të tij Prefekti lexojnë me zë të lartë listen më emrat e Këshilltarëve të miratuat nga KQZ.
2. Sekretari apo në mungesë të tij Prefekti ftojnë Këshilltarin më të vjetër në moshë, sipas listës së KQZ, që është i pranishëm në mbledhje, për drejtimin e përkohshëm të mbledhjes deri në zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit.

Neni 4

Verifikimi i mandateve dhe Betimi i Këshilltareve

Verifikimi i mandateve të Këshilltarëve bëhet nga Komisioni i Mandateve të Këshillit përpara se Këshilltarët bëjnë betim para Këshillit. Me marrje e drejtimit të mbledhjes së Këshillit nga Këshilltari më i vjetër në moshës i pranishmë në mbledhje, kërkon ngritje e Komisionit të Mandateve dhe verifikimin e mandateve të Këshilltarëve.

Neni 5

Komisioni i Mandateve

1. Komisioni i Mandateve ngrihet me përbërjen e 3 (tre) Këshilltarëve. Propozimet për përbërjen dhe Kryesinë e Komisionit bëhen nga Këshilltarët me mandat që deklarojnë përfaqësimin e partive politike. Komisioni i Mandateve miratohen nga Këshilli me votim të hapur, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij me mandat.

2. Komisioni shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve dhe i paraqet Këshillit, brenda mbledhjes së parë të Këshillit, raportin për vlefshmërinë e mandateve të Këshilltarëve. Nëse Komisioni vëren paligjshmëri të dokumentacionit të dorëzuar nga Sekretari i Këshill apo Prefekti dhe për këtë arsye nuk arrin të përgatisë raportin brenda mbledhjes së parë të Këshillit, i kërkon drejtuesit të mbledhjes shtyrjen e mbledhjes për në ditën e mëpasme për të verifikuar dhe konsultuar dokumentacion shtesë, shtyrje e cila njoftohet publikisht në median vendore dhe faqen e interneti zyrtaret të Bashkisë. Raporti miratohet me minimumin 2 nga 3 anëtarët e tij.
3. Nëse Komisioni veren paligjshmëri të një apo më shumë mandateve të Këshilltarëve, i paraqet Këshillit kërkesën e firmosur nga minimumi 2 anëtarë, për tja dërguar më pas organeve kompetente gjygjësore për shqyrtim.
4. Komisioni i Mandateve merr parasysh dhe verifikon cdo pretendim të ngritur nga pjesëmarrësit në sallë për pavlefshmërinë e mandatit të një Këshilltari, sipas listës emërore të KQZ.
5. Në qoftëse mendimi për dhënjen e mandatit një Këshilltari nuk është unanim nga anëtarët e Komisionit të Mandateve, në raportin që përgatit Komisioni mendimi i shumicës shoqërohet me mendimin e pakicës.
6. Kryetari i Komisionit të Mandateve lexon me zë të lartë para Këshillit listën me emrat e Këshilltarëve mandati i të cilëve është i vlefshmëm dhe deklaron numrin e Këshilltarëve me mandat të vlefshëm nga numri total i Këshiltarëve të Këshillit. Me pas Këshilltarët me mandat të vlefshëm zënë vend në karriget e sallës së Këshillit Bashkiak.
7. Drejtuesi i mbledhjes fton Këshilltarët e pranishëm të votojnë raportin e Komisionit të Mandateve.
8. Mandati i jepet këshilltarit me vendim të Këshillit Bashkiak.
9. Me miratimin e raporti të Komisionit të Mandateve me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, (ligji 139, neni 49/1,2) dhe me vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij nga Komsioni (ligji 139, neni 48/7), drejtuesi i mbledhje shpall konstitutimin e Këshillillit.

Neni 6

Betimi i Këshilltarëve

1. Pas verifikimit të mandateve nga Komisioni i Mandateve, dhe miratimit të raporti te Komisionit nga Këshilli, Këshilltarët bëjnë këtë betim para Këshillit (Ligji 139/2015, neni 50)

"Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutes dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimatrinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Elbasan dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre".

2. Teksti i betimit lexohet nga drejtuesi i mbledhjes dhe Këshilltarët ftohen, një e nga një, të ngrihen në këmbë dhe të deklarojnë "Betohem". Çdo këshilltar nënshkruan tekstin e betimit.

1. Hartimi projektakteve që paraqiten nga Kryetari i Bashkisë bëhet nga drejtoria përkatëse në bashkëpunim më drejtorinë juridike dhe drejtorinë e financave të Bashkisë. Drejtoria propozuese ka të drejtë ta konsultojë projektaktin edhe me drejtoritë e tjera të Bashkisë, sipas nevojës, rregullores së brendhshme të administratës së Bashkisë.
2. Projekt aktet dhe relacioni përkates i dorezohet detyrimisht Sekretarit të Këshillit jo më vonë se 10 ditë përpara mbledhjes së Këshillit, dhe jo më pak se 5 ditë përpara mbledhjes së komisioneve.

Neni 53

Paraqitja e projekt akteve

Të drejtën për të paraqit projekt akte, rezoluta, deklatara e kanë:

1. Këshilltarët,
2. Grupet Politike të Këshilltarëve,
3. Kryetari i Bashkisë,
4. Komisioni e ngritura me vendim Këshilli,
5. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij,
6. Jo më pak se një (1) për qind e banorëve .

Neni 54

Njoftimi i projekt akteve/ propozimeve

1. Të gjitha projekt-aktet/propozimet drejtuar Këshillit, i njoftohen Kryetarit të Këshillit nga Sekretari.
2. Kryetari i Këshillit me ndihmën e Sekretarit, pasi njihet me projektaktet/propozimet dhe nëse i gjen ato në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore, i paraqet në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit, e cila vendos për kohën e shqyrtimit të tyre në Këshill.

Neni 55

Projekt aktet e paraqitura nga administrata e Bashkise

1. Këshilli pranon për shqyrtim vetëm projekt-akte të administratës së Bashkisë të cilat janë firmosur paraprakisht nga Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar me shkrim nga Kryetari, drejtuesi i departamenti/sektorit që ka përgatitur projekt-aktin dhe juristi i administratës së Bashkisë i caktuar nga Kryetari i Bashkisë për verifikimin e bazueshmërisë ligjore të projekt-akteve që i paraqiten Këshillit.
2. Projektakti duhet të nënshruhet edhe nga konceptuesi i aktit, krahas drejtorit përkatës dhe drejtorit juridik.

Neni 56

Projekt aktet e paraqitura nga komuniteti – Iniciativa qytetare

1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në Këshillin Bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të Bashkisë.
2. Iniciativa mund të jetë një propozim drejtuar Këshillit për të filluar një iniciativë legjislative, miratimin e një akti, apo një propozim i një projektakti për t'u shqyrtuar e miratuar në Këshill.

3. Iniciativa qytetare të paraqitura për vendimarrje në Këshillin Bashkiak i drejtohët Këshillit dhe depozitohet pranë Kryetarit të Këshillit dhe shqyrtohen paraprakisht nga Kryesia e Këshillit. Kryetari i Këshillit organizon nje degjesë publik me perfaqësues të autorizuar të banorëve që kanë nënshkruar iniciativën, ku marrin pjesë sëpaku Kryetari i Komisionit Mandateve dhe Rregullores, që mbulon fushën e iniciativës qytetare, kryetarët e Grupeve më të mëdha politike të Këshilltareve dhe drejtuesi i drejtorisë që mbulon cështjet të cilën trajton iniciativa qytetare. Nje kopje e iniciativës i dorëzohet Kryetarit të Bashkisë, nëpërmjet Sekretarit. Punojësit e Sekretariatit, bëjnë vlerësimin judidik e financiar të këtyre iniciativave qytetare.
4. Propozimet e ardhura në Këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e Bashkisë (ligji 139, neni 20/2), nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e Kryetarit të Bashkisë. Kryetari i Bashkisë është i detyruar ti dergojë Këshillit vlerësimin e tij për iniciativën jo më vonë se 20 ditë pune nga marrja e kërkeses nga Sekretari i Këshillit. Gjithashtu drejtoria juridike e Bashkisë dhe drejtoria që funksion çështjet që trajton iniciative janë të detyruara të shprehet me shkrim për iniciativën. Sekretari i Këshillit i përcjell pranë këtyre dy drejtorive/sektorëve propozimin dhe ato duhet të shprehet për bazueshmërinë ligjore të propozimit jo më vonë se 20 ditë pune nga marrja e kërkeses.
5. Propozimi shoqërohet me listën e personave propozues, nënshkrimin e tyre, nr. Personal të identitetit, të dhënat dhe adresën e përfaqësuesit, dhe duhet të përmbajnë:
   a) propozuesin/it;
   b) objektin që propozohet;
   c) bazën ligjore të propozimit;
   ç) arsyet e propozimit dhe efektet e pritshme të aktit;
   d) materiale shtesë nëse ka.
6. Propozimi dorëzohet zyrtarisht, në zyrën e protokoll arkivit të Bashkisë dhe i drejtohet Këshillit Bashkiak
7. Mbas dëgjesës publike dhe shprehjen me shkrim të mendimit të Kryetari të Bashkisë, si dhe vlerësimin e bazueshmerisë ligjore të iniciatives nga drejtoria juridike e Bashkisë, iniciativa shqyrtohet nga Komisioni për Mandatet dhe Rregulloren. Përfaqësuesit e autorizuar të grupit që ka paraqitur iniciativën ftohen në mbledhjen më të afërt të Komisionit. Anëtarët e Komisionit. Këshilltarët kanë të drejtën t'u paraqesin këtyre përfaqësuesve pyetjet dhe komentet e tyre mbi cështjen që trajton iniciativa.
8. Pas marrje së propozimit dhe raporti nga Komisionit, iniciativa shqyrtohet në Këshill, e në fund të debatit, Këshilli me shumicën e votave vendos pranimin e iniciativës për ta shqyrtura dhe marrë vendim në Mbledhjen e Këshillit, apo kalimin e iniciativë në një referendum vendor.
9. Në raste kur iniciativa qytetare lidhen me çështje për të cilat Bashkia dhe Këshilli Bashkiak nuk është drejtpërdrejt kompetente, Kryetari i Këshillit brenda afatit prej 10 ditësh e njofton me shkrim parashtruesin e peticionit se është jo kompetente në shqyrtimin e iniciativës.

Neni 57

Shqyrtimi dhe miratimi i peticioneve nga publiku

1. Secili person apo organizatë me interes në punët e Bashkisë ka të drejtë në paraqitjen e peticionit në Këshillin Bashkiak, për cilëndo çështje që lidhet me punën e Bashkisë. Peticioni është kërkesë apo pyetje për Këshillin Bashkiak, për t'u marrë me çështjet specifike apo për të miratuar vendime të caktuara dhe përbën një të drejtë themelore demokratike.
2. Peticionet shqyrtohen nga Këshilli Bashkiak brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Peticioni mund të rezultojë gjithashtu me mbajtjen e takimit publik në të cilin popullata diskuton, bashkë me stafin e Bashkisë dhe përfaqësues te Këshillit Bashkiak , për çështjet me interes për ta.
3. Peticionet, të cilat i drejtohen Këshillit shqyrtohen nga komisionet e përhershme përkatëse.
4. Pranohen për shqyrtim peticionet, të cilat janë bërë me shkrim, kanë emrin e dërguesit dhe nënshkrimet përkatëse, janë të kuptueshme dhe tregojnë qartë objektin e tyre.
5. Peticionet dërgohen nga Kryetari i Këshillit në Komisionin e Përhershëm që ka lidhje me objektin e paraqitur në peticion. Kryetari komisionit mund t'ia kthejë peticionin dërguesve për rihartim ose t'u kërkojë atyre sqarime shtesë.
6. Jo më vonë se 45 ditë nga data e marrjes së peticionit, kryetari i komisionit e paraqet peticionin në komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e zgjidhjes ligjore ose mospranimin e peticionit. Në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit për të paraqitur një deklaratë në Mbledhjen e Këshillit.
7. Pas shqyrtimit në Këshillin Bashkiak, dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit Sekretari njofton me shkrim parashtruesit/n e peticionit për hapat e ndërmarrë dhe zgjidhja e çështjes së ngritur në peticion.
8. Në raste kur peticioni, lidhen me çështje për të cilat Bashkia dhe Këshilli Bashkiak nuk është drejtpërdrejt kompetente, Kryetari i Këshillit brenda afatit prej 10 ditësh e njofton me shkrim parashtruesin e peticionit se është jo kompetente, si dhe procedon atë tek organet kompetente duke njoftuar edhe parashtruesin e peticionit.

KREU V.

Kuorumi dhe Veprimi i Këshillit

Neni 58

Këshilli vepron apo pranon për shqyrtim mocione, projekt-akte të administratës së Bashkisë, rezoluta, raporte të Komisioneve të Përhershme, të Përkohshme dhe të Përziera, vendime të Prefektit në lidhje me vlefshmërinë e akteve të Këshillit, deklarata, marrëveshje, kontrata, nisma qytetare.

Neni 59

Kuorumi

Çdo veprim i Këshillit ndërmerret vetëm nësë është i pranishëm kuorumi i Këshilltarëve sipas pikave 2,3,4 të nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

KREU VI.

Shqyrtimit legjislativ i Buxhetit dhe Situatës Financiare të Bashkisë

Neni 60

Shqyrtimit i projekt buxhetit vjetor dhe afatmesem

Këshilli duhet të sigurojnë financimin e prioriteteve strategjike të Bashkisë, në përputhje me politikat sektoriale e ndërsektoriale kombëtare dhe me nevojat e komunitetit, të cilit i shërbejnë (ligji 68/2017, neni 5/c) dhe harton Buxhetin Vendore mbi Bazë Përformance.

Neni 61

Plani i punës dhe Kalendari i shqyrtimit te projekt buxhetit nga Keshilli

1. Këshill miraton çdo vit planin e punës dhe kalendarin për procesin e shqyrtimit të projekt buxhetit nga Këshilli, sipas propozimit të bërë nga Kryetari i Këshillit në konsultim me kryesinë e Këshillit, Kryetarin e Komisionit të finance buxhetit dhe aseteve publike dhe Kryetarin e Bashkisë.
2. Gjatë hartimit të planit të punës Kryeari i Këshillit merr parasysh nevojat për asistencë teknike të paraqitura nga çdo Këshilltar dhe Kryetari i Komisionit për finance buxhetit dhe aseteve publike për tema që ato nuk kanë ekspertize apo jane subjekt i shmangies së konfliktit të interesave, si ekspertizë ad hock (nga jashte), asistencë nga programe të asistencës teknike të donatorëve.

Neni 62

Procesi i shyrtimit të projekt programit buxhetor afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor nga Këshilli Bashkiak.

1. Këshilli Bashkiak e shqyrton buxhetin vjetor dhe afatmesëm te Bashkisë zakonisht në dy mbledhje, ku në Mbledhjen e pare **(muaji tetor)** Këshilli shqyrton raportin e Kryetarit të Bashkisë për të ardhurat si dhe projekt buxhetin e Bashkisë nëse është përgatitur dhe në Mbledhjen e dytë **(muaji Dhjetor)** Këshilli bën shqyrtimin final të projekt buxhetit mbi bazën e raportit të paraqitur nga Komisioni për Financa dhe Buxhet dhe rekomandimet e

propozimet në lidhje me projekt buxhetin dhe raportin e të ardhurave të paraqitura nga Kryetari i Bashkisë.

2. Këshilli miraton ndryshimet në politikën fiskale vendore të taksave dhe tarifave vendore, jo më vonë se **30 ditë** pas miratimit nga Kuvendi të ndryshimeve në legjislacionin fiskal, me impakt në të ardhurat e vetëqeverisjes vendore.

3. Këshilli merr për shqyrtim, jo më **vonë se data 31 janar,raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave**, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, për:

   a) dy vitet para vitit buxhetor;
   b) vitin buxhetor;
   c) tre vitet e ardhshme buxhetore. (ligji 68/2017, neni 34/1), dhe e miraton raportin jo më vonë se data 1 mars . (ligji 68/2017, neni 34/4).

4. Këshilli merr për shqyrtim **tavanet përgatitore** të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi (ligji 68/2017, neni 34/5), dhe miraton ato jo më vonë se data **15 mars** (ligji 68/2017, neni 34/6).

5. Këshilli merr për shqyrtim dhe miraton brenda muajit Maj projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm, i cili brenda datës **1 qershor**i dërgohet Ministrisë së Financave për mendime nga Kryetari i Bashksë (ligji 68/2017, neni 35).

6. Këshilli brenda datës **30 qershor** shqyrton dhe miraton **projektin e parë** të programit buxhetor afatmesëm, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe shoqëruar me mendimet e Ministrisë së Financave, duke shprehur gjatë shqyrtimit edhe opinionin e Tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave. Ky **projekt i parë** i programit buxhetor afatmesëm **publikohet** nga Kryetari i Bashkisë brenda datës **5 korrik** (ligji 68/2017, neni 35/8,9).

7. Këshilli brenda datës **20 korrik** miraton **tavanet përfundimtare** të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm praqitura nga Kryetari i Bashkisë (ligji 68/2017, neni 37/1), dhe që bazohen në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave.

8. Këshilli, brenda **datës 10 shtator, miraton dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar**, dhe Kryetari i Bashkisë ja dërgon më pas Ministrisë së Financave brendas datës 15 shtator (ligji 68/2017, neni 38/3) së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë. Pas miratimit të projektit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, Kryetari i Bashkisë përgatit projekt buxhetin vjetor (ligji 68/2017, neni 40/1).

9. Kryetari i Këshillit në bashkëpunim më Kryetarin e Bashkisë organizojnë, brenda datës **5 tetor**, një **dëgjesë publike të përbashkët me Ministrine e Financave**. Kryetari i Këshillit,

brenda datës 20 tetor, merr mendimet përfundimtare të Ministrisë së Financave (nëse ka), për t'i reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm. (ligji 68/2017, neni 38/4). Në kërë dëgjesë publike merr pjesë edhe Kryetari i Komisionit të finance buxhetit dhe aseteve publike. Njoftimi për dëgjesën publike bëhet nga Sekretari.

10. Këshilli, brenda datës **30 nëntor, merr për shqyrtim** nga Kryetari dokumentin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe projektbuxhetin vjetor.Mendimet e Ministrisë së Financave dhe vlerësimi i Kryetari të Bashkisë për marrjen në konsideratë të tyre, paraqiten në një aneks të veçantë të projektit të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar(ligji 68/2017, neni 39/1; 41/1). Çdo anëtar i Këshillit mund të propozojë ndryshime të argumentuara të projektbuxhetit të paraqitur nga kryetari. Këto ndryshime duhet të jenë në përputhje me parimet dhe rregullat e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligjit 68/2017 (ligji 68/2017, neni 41/2).

11. Këshilli, brenda datës **25 dhjetor, miraton** dokumentin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe projektbuxhetin vjetor (ligji 68/2017, neni 39/2; 41/3). Gjatë shqyrtimit të projekti final të projekt buxhetit, Këshilli dëgjon edhe komentet e publikut, të cilat pasqyrohën në shtojcën e dokumenti të buxhetit sëbashku me komentet e marra nga dëgjesat publike dhe dëgjesën e Komisionit të finance buxhetit dhe aseteve publike.

12. Kryetari i Bashkisë, brënda datës **31 dhjetor**, bën publikimin e dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor të miratuar, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre (ligji 68/2017, neni 39/3)

Neni 63

Shyrtimi i projekt buxhetit nga Komisioni i finance buxhetit dhe aseteve publike

1. Komisioni shqyrton raportin për të ardhurat dhe e projektin e buxhetine të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

2. Komisioni mban sëpaku një dëgjesëpublike në mjediset e godinës së Bashkisë kur ka mundësi salle etj dhe mbledh komente dhe sugjerimet për projekt buxhetin e Kryetarit të Bashkisë dhe për raportin e të ardhurave. Degjesa publike si rregull zgjatë jo më shumë se 1 orë.

3. Komisioni shqyrton propozimet dhe rekomandimet e dokumentuara nga dëgjesa publike si dhe kërkesat me shkrim qe ijanë dërguar Komisionit nga publiku dhe grupet e interest. Dëgjesa publike thirret nga Kryetari iKomisioni dhe i njoftohet Këshilltarëve, ekzekutivit të Bashkisë dhe publikut nepëmjet Sekretarit.

4. Kryetari i Komisionit harton dhe nënshkruan raportin e Komisionit për projekt buxhetin, në të cilin përfshihen rekomandimet e Komisionit për shtesa dhe rregullime, rekomandime, këto

duhet të kenë reference të qartë tek numri i paragrafit të dokumentit të projekt buxhetit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

5. Raporti i Komisionit i dërgohet Kryetarit të Këshillit së paku 15 ditë pune para Mbledhje së Këshillit dhe njëkohësisht edhe Kryetarit të Bashkisë. Sekretari i shpëndan Këshilltarëve mundësisht 10 ditë pune para Mbledhje së Këshillit kopje të raportit të Komisionit.

Neni 64

Informimi dhe Konsultimi publik i projekt buxhetit

1. Programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore (ligji 68/2017, neni 5/ç)
2. Kryetari i Këshillit në konsultim me Kryesia e Këshillit dhe Kryetarin e Bashkisë harton kalendarin e dëgjesave publike për buxhetin afatmesëm e vjetor të Bashkisë dhe Sekretari ia njofton të gjithë Këshilltarëve 10 ditë pune përpara fillimit të dëgjesave publike. **Dëgjesat publike për buxhetin organizohen në muajin tetor-nëntor.** Në kalendarin e dëgjesave publike specifikohet data, ora, vendi dhe pjesemarrësit që do të jenë të pranishëm nga Këshilli Bashkiak, për secilën prej dëgjesave publike. Këshilli organizon së paku një dëgjesë publike në secilën njesi administrative të Bashkisë.
3. Kryetari i Këshillit me mbështetje e Sekretarit harton listën eKëshilltarëve me emrat dhe njësine administrative që ato kanë njoftuar se do të marrin pjesë në dëgjesën publike. Çdo Këshillar është i lirë të marrë pjesë në një dëgjesë publike të organizuar nga Këshilli, edhe pa vënë në dijeni paraprakisht Kryetarin e Këshillit.
4. Në lidhje me raportin financiar, Këshilli publikon treguesit financiarë në një aneks të veçantë të projektbuxhetit vjetor dhe raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit (ligji 68/2017, neni 54/1).

Neni 65

Dokumentimi dhe reflektimi i propozimeve per ndryshimet e projekt buxhetit pas konsultimit publik

1. Rekomandimet dhe propozimet e prezantuar në dëgjesat publike të organizuara nga Këshilli, Komisioni i finance buxhetit dhe aseteve publike, Kryetari i Bashkisë, si dhe ato të paraqitura në mbledhjet ku diskutohen projekti i parë dhe projekti final i buxhetit, dokumentohet në shtojcën për Konsultimin Publik të dokumentit të miratuar të buxhetit, ku dhe në këtë të fundit, pasqyrohet edhe fotot takimeve dhe dëgjesave me publikun të organizuara për konsultimin e projekt buxhetit.

2. Gjithashtu Rekomandimet dhe propozimet e prezantuar në dëgjesat publike të organizuara nga Komisioni i finance buxhetit dhe aseteve publike dokumentohet në shtojcën për konsultimin publik të raportit të Komisionit.

Neni 66

Rishikimi i buxhetit vendor dhe rishpërndarja e fondeve

1. Këshilli shqyrton kërkesën e Kryetarit për rishpërndarjen e fondeve të buxhetit nga një zë shpenzimesh në një tjetër, brenda dhe midis programeve të ndryshme buxhetore (ligji 139/2015, neni 40/4).
2. Këshilli, brënda muajit korrik, shqyrton propozimin e Kryetarit të Bashkisë për rishikimin e zbatimit të buxhetit vendor të paraqitur, jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti (ligji 68/2017, neni 46).

Neni 67

Mungesa e buxhetit të miratuar nga Këshilli

1. Në rastin kur Këshilli nuk miraton buxhetin vendor brenda datës **25 dhjetor** (ligji 68/2017, neni 41/3), prefekti i kërkon Kryetarit të Bashkisë thirrjen e një mbledhjeje të dytë të Këshillit, e cila duhet të mbahet jo më vonë se data **5 janar** e vitit pasardhës. Nëse edhe në këtë rast Këshilli nuk arrin të miratojë buxhetin, Këshilli i Ministrave vendos shpërndarjen para kohe të Këshillit.

2. Në rast të mosmiratimit të buxhetit të Bashkisë, sipas pikës 1, Kryetari i Bashkisë zbaton procedurat për buxhetin e përkohshëm vendor. (ligji 68/2017, neni 41/4, 5). Në këto kushtet të mungesës së buxhetit të miratuar nga Këshilli, Kryetari i Bashkisë merr përkohësisht kompetencat e Këshillit dhe autorizon kryerjen e shpenzimeve mujore deri në 1/12 e shpenzimeve faktike të buxhetit vendor në vitin buxhetor paraardhës (ligji 139/2015, neni 40/2). Në këtë rast Këshilli, brënda muajit Janar dhe permes rezolutës, i kërkon Kryetarit të Bashkisë ta njoftojë zyrtarisht Këshillin për fillimin e autorizimit të shpenzimeve mujore, si dhe paraqitjen e shpenzimeve faktike të buxhetit vendor në vitin buxhetor paraardhës. Kryeari i Bashkisë i dërgon Këshillit njoftimin zyrtar për fillimin e autorizimit të shpenzimeve mujore si dhe shpenzimeve faktike të buxhetit vendor në vitin buxhetor paraardhës.

Neni 68

Shyrtimit i raportit te zbatimit te buxhetit

1. Këshilli shqyrton tre raporte katër mujore të zbatimit të buxhetit (ligji 68/2017, neni 48/1), të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, dhe përkatësisht në Mbledhjet e muajve shkurt, maj, shtator, të vitit parardhës. Sekretari, sëpaku 10 ditë pune para Mbledhjes së Këshllit ku do të shqyrtohene këto raporte, i dërgon Këshilltarëve dhe Komisionit finance buxheti dhe aseteve

publike një kopje të raportit sëbashku me komentet dhe rekomandimet e Ministrise së Financave, nëse ka të tilla (ligji 68/2017, neni 48/5).

2. Këshilli dhe Komisioni i finance buxheti dhe aseteve publike mbajnë secili sëpaku një dëgjesë publike (maksimumi 30 minuta). Raportet bëhet publik nga Sekretari. Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi autorizues në faqen zyrtare të njësisë përkatëse, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit (ligji 68/2017, neni 48/3).

3. Këshilli, brenda muajit **prill/qershor,** shqyrton dhe miraton raportin vjetor për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë, raport i cili i përmba raportine performancës së Bashkisë dhe raportin e auditimit të jashtëm, raport i cili paraqitet Këshillit nga Kryetari i Bashkisë jo më vonë se data **31 mars**(ligji 139/2015, neni 44) **apo 31 maj**(ligji 68/2017, neni 51/1) të vitit pasardhës. Sekretari, sëpaku 20 ditë pune para mbledhjes së Këshllit ku do të shqyrtohet raporti, i dërgon Këshilltarëve dhe Komisionit të finance buxheti dhe aseteve publike një kopje të raportit.

4. Këshilli dhe Komisioni finance buxheti dhe aseteve publike mbajnë secili sëpaku një dëgjesë publike (maksimumi 30 minuta) në mbledhjen ky shqyrtohet raporti. Shqyrtimi i raportit të zbatimit të buxhetit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë bëhet sëpari në Komisionin e Financave dhe Buxheti, në të cilin paraqiten vërejtjet, komentet dhe propozimet e Tij. Raporti i Komisionin prezantohet dhe shyrtohet në Këshill mbas prezantimit nga Kryetari i Bashkisë. Raporti vjetor për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë bëhet publik nga Kryetari i Bashkisë (ligji 139/2015, neni 51/4).

Neni 69

Kontrolli i brendshëm financiar publik.

1. Këshilli, jo më pak se një here në vit, i kërkon Kryetarit të Bashkisë të raportojë edhe për çështje që kanë lidhje me kontrollin e brendshëm financiar publik të Bashkisë (ligji 139/2015, neni 48/6).

2. Kërkesa mund të propozohet nga Kryerati i Këshillit, Kryetari i Komisionit finance buxhetit dhe aseteve publike, një grup prej jo më pak se 5 këshilltarësh.

3. Kërkesa shqyrtohet nga Këshilli dhe nëse miratohet, me shumicë të thjeshtë, i dërgohet Kryetarin të Bashkisë, permes Sekretarit, jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e miratimit. Raporti i përgatitur nga Kryetari i Bashkisë shqyrtohet fillimisht nga Komisioni finance buxhetit dhe aseteve publike.

4. Këshilli, në mbledhjen e muajit mars, si pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit vendor shqyrton edhe raportin e auditimit të jashtëm të dërguar nga Kryetari i bashkisë (ligji 68/2017, neni 50/4).

5. Këshilli shqyrton raportin e progresin të Planit të veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga raportet e auditimit të jashtëm,r aportin e progresi që është hartuar dhe prezantohet nga Kryetari i Bashkisë (ligji 68/2017, neni 50/5).

6. Këshilli vendos për auditimin e organet ekzekutive të Bashkisë, nga shoqëri të specializuara në fushën e audimit. (ligji 139/2015, neni 43/4). Procedurat e përzgjedhjes së shoqërisë së specializuara **kryhet nga Këshilli** sipas përcaktimeve dhe procedurave ne vendimin e Këshillit dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 70

Performanca e Bashkisë

Këshilli,në mbledhjen ku shqyrton raportin të konsoliduar të zbatimit të buxhetit vendor, shqyrton raportin vjetor të performancë së Bashkisë të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (ligji 68/2917, neni 51/3/a).

Shqyrtimit i rasteve të Veshtirësive financiare dhe Paaftësisë paguese

Neni 71

Probleme Financiare

1. Këshillin shqyrton informacionin dhe propozimin për masat që duhen marrë, të dërguar nga Kryetari i Bashkisë për vështirësinë financiare të Bashkisë, nëse në muajin pasues totali në vlerë i detyrimeve financiare të konstatuara dhe të papaguara tejkalon nivelin prej 20 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara (ligji 68/2917, neni 55/2).

Neni 72

Vështirësi Financiare

Këshillit shqyrton dhe miraton, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes, planin për daljen nga situata e vështirë financiare dhe alternativat përkatëse (specifikuar në ligji 68/2917, neni 56/1,3), të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë 20 ditë mbas konstatimit nga ana e këtij të fundit. (ligji 68/2917, neni 56/2).

Neni 73

Vështirësi Serioze Financiare

1. Këshillit shqyrton informacionin e përgatitur nga Kryetari i Bashkisë për situatën në vështirë serioze financiare (*kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara*) në të cilën ndodhet Bashkia (ligji 68/2917, neni 57/2).

2. Në rasti kur Këshilli i Ministrateve shpall Bashkinë në mbikëqyrje financiare, si masë për daljen nga situata e vështirësise serioze financiare, Këshilli nuk mund të:
   i) marrë asnjë vendim që mund të çojë në shtimin e detyrimeve financiare të Bashkisë;

ii) të vendosë shërbime të reja publike, të themelojë sipërmarrje publike apo çdo institucion tjetër;

iii) të shlyejë asnjë detyrim financiar, të krijuar para shpalljes së rastit të vështirësisë financiare, përveç detyrimeve të përcaktuara shprehimisht në planin e rehabilitimit financiar të Bashkisë (ligji 68/2917, neni 57/3/c).

3. Këshilli, brenda 30 ditëve nga shpallja e Bashkisë në mbikëqyrje financiare miraton Planin e rehabilitimi financiar, që përgatitet dhe propozohet nga Kryetari i Bashkisë me asistencën e Ministrisë së Financave, plan i cilin i dorëzohet për miratim Ministrisë së Financave.

Neni 74

Situata e paaftësisë paguese

1. Këshillit shqyrton informacionin e përgatitur nga Kryetari i Bashkisë për situatën e paaftësisë paguese të Bashkisë (*nëse nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe/ose nëse raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të papaguara ndaj shpenzimeve vjetore të miratuara është më i lartë sesa 1/3)* në të cilën ndodhet Bashkia (ligji 68/2917, neni 59/2).

2. Këshilli shqyrton dhe vendos masat zbatuese të plani i veprimit për daljen nga situata e paaftësisë paguese të Bashkisë, plan i cili shoqëron vendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e situatës së paaftësisë paguese të Bashkisë(ligji 68/2917, neni 59/3, 4).

Neni 75

Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve financiare

Këshilli miraton rregulloren e brendshme për arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VII.

Neni 76

Mbledhjet e Këshillit.

1. Mbledhjet e Këshillit janë të hapura për publikun, përveç rasteve të parashikuara me ligj dhe në këtë rregullore. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në këtë rregullore (ligji 139/2015, neni 17).

2. Të gjitha mbledhjet e Këshillit mbahen brenda juridiksionit të Bashkisë. Mbledhjet mbahen në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, përvec rasteve kur shumica e numrit të përgjithëshëm të antarëve vendos ndryshe për shkaqe të përligjura, dhe në këtë rast njoftimi për ndryshimin e vendit të mblejtjes së mbledhjes se Këshillit njoftohet me njoftimine mbledhjes.

Neni 77

Mbledhjet e Radhës se Këshillit

1. Mbledhjet e radhës së këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.(ligji139/20165, neni 53/2)
2. Mbledhjet e Radhës mbahen javen e fundit të çdo muaji në oren e përcaktuar sipas e-mail nisur nga Sekretari i Këshillit ose përfaqësuesi i sekretariatit sipas porosisë së Sekretarit.
3. Pjesa e fundit e çdo mbledhje te pika të ndryshme lihet në dispozicion të këshilltarëve për probleme dhe shqetësime që ata kanë nga komuniteti.
4. Këshilltaret mundësisht ti paraqesin çeshtjet që kanë për të diskutuar 5 ditë përpara mbledhjes, me shkrim/e-mail prane Sekretarise se KB, si dhe per dijeni keshilltareve te tjere, duke kerkuar dhe prezencen e perfaqesuesve te administrates se bashkise apo te institucioneve te varesise qe kane lidhje me problematikat dhe ceshtjet qe do diskutohen.
5. Materialet apo projektvendimet ti vihen në dispozicion Këshillëtarëve nëpërmjet email të paktën 5 ditë kalendarike përpara. Ky kusht përbën detyrim për pranueshmërinë e futjes në rendin e ditës në Këshill dhe diskutimin apo miratimin. Përvec rasteve të urgjencës dhe/apo me miratimin paraprak të Komisionit përkatës

Neni 78

Mbledhjet Jashtë Radhe

1. Këshilli mblidhet jashtë radhe (ligji 139/2915, neni 53/3),
   a) me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë;
   b) me kërkesën e 1/3 së Këshilltarëve të tij;
   c) me kërkesën e motivuar të Prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij
2. Në secilin prej rasteve Kryetarit të Këshillit dhe nëpërmjet tij Këshilltarëve duhet t'i paraqitet me shkrim dhe e firmosur kërkesa për mbajtjen e mbledhjes jashtë radhe ku të specifikohet qartë çështja që propozohet të shqyrtohet, qëllimi dhe arsyet e mbajtjes së mbledhjes.
3. Mbledhjet jashtë radhe mbahen në datën, vendin dhe kohën e caktuar nga Kryetari.
4. Njoftimi për Këshilltarët bëhet nga Sekretari dhe në mungesë të tij nga Kryetari apo zëv/kryetari, me telefon apo njoftim gojor direkt. Ky njoftim bëhet së paku 48 orë para mbajtjes së mbledhjes dhe përfshin datën, orën, vendin, rendin e ditës, arsyet dhe qëllimin për të cilin mbahet Mbledhja. Në njoftim specifikohet se kush nga autoritet e specifikuara më mësipër e ka kërkuar mbledhjen jashtë radhe.
5. Njoftimi për publikun bëhet nga Sekretari, dhe në mungesë të tij nga Kryetari apo zëv/kryetari, në median vendore, në tabelën informative jashtë dhe afër ndërtesës kryesore të Bashkisë, dhe në gazetën e Bashkisë, nëse kjo e fundit shpërndahet brenda afatit të njoftimit. Sekretari njofton të gjithë ato persona apo organizata të cilat kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt për çdo mbledhje të Këshillit.

6. Në mbledhjen jashtë radhe shqyrtohen vetëm ato çështje për të cilat është thirrur mbledhja. Çështje të tjera mund të diskutohet vetëm më miratimin e shumicës së Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 79

Mbledhje Jashtëzakonshme/Emergjence.

1. Mbledhja e Jashtëzakonshme (ligji peremergjencat civile) /Emergjence është mbledhje jashtë radhe dhe mbahet jo më vonë se 24 orë nga njoftimi i mbledhjes Këshilltarëve apo depozitimi i kërkesës me shkrim për mbajtjen e mbledhjes e cila, për tu pranuar, detyrimisht duhet të shoqërohet me rendin ditës dhe me shpjegimin e arsyes se mbajtjes se mbledhjes se Jashtëzakonshme. Sekretati në çdo rast njofton median vendore për mbajtjen e mbledhjes.
2. Njoftimi i Këshilltarëve, nga Sekretari dhe në mungesë të tij nga vetë Kryetari i Këshilli apo nga zevëndëskryetarët e Këshillit behet me telefon apo mjete të tjera të njoftimit. Personi që ka bërë njoftimin, Sekretari apo personi i autorizuar nga Kryetari, e informon Këshillin për mënyrën e njoftimit dhe emrat e Këshilltarëve të njoftuar.
3. Mbledhja thirret nga Kryetari i Këshillit, dhe mbahet kur gjykohet se rrethanave kërkojnë vendimarrje urgjente të Këshillit.
4. Mbledhja e Jashtëzakonshme e Këshillit caktohet mbi bazë të kërkesën së bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të Këshilltarëve Bashkiakë apo me kërkesë të Kryetarit të Këshillit, si dhe të Kryetarit të Bashkisë.
5. Në rast se Kryetari dhe zëvëndës kryetaret e Këshillit nuk mund të jenë të pranishëm, Mbledhja e Jashtëzakonshme kryesohet nga këshilltari më i vjetër në moshë që përfaqëson shumicën politike në Këshill. Në këtë rast procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga shumica e këshilltarëve të pranishëm dhe vendimi nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes.
6. E drejta për të thirrur një Mbledhje të Jashtëzakonsheme përfshin detyrimin për caktimin e rendit të ditës së kësaj Mbledhje. Pikat e caktuara në rendin e ditës për Mbledhjet e Jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.
7. Mbledhjet e Jashtëzakonshme nuk mbahet nëse të gjithë anëtarëvë të Këshillit, nuk u është bëre njoftim, sipas kërkesave të kësaj rregullore, së paku 24 orë para datës së mbajtjes së Mbledhjes.
8. Kërkesa për mbajtjen e Mbledhjes Emergjence duhet të specifikojë shkurtimisht natyrën dhe objektin e çështjes emergjente për shqyrtimin e së cilës kërkohet të mbahet Mbledhja. Në Mbledhjen Emergjence shqyrtohen vetëm çështjet për të cilat është thirrur mbledhja.
9. Njoftimi për publikun duhet të bëhet në median televizive vendore, në tabelën informative jashtë dhe afër ndërtesës kryesore të Bashkisë. Sekretari njofton të gjithë ato persona apo organizata të cilat kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt për çdo mbledhje të Këshillit, duke i dërguar me email njoftimin dhe rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit.

Neni 80
Njoftimi i mbledhjes

1. Njoftimi për zhvillimin e Mbledhjes së Këshillit bëhet nga Sekretari (ligji 139/2015 neni 57/2). Njoftimi për Këshilltarët bëhet jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes **ndersa per ceshtje si buxheti mundësisht jo me pak se 10 dite pune.**

2. Në mungesë të Sekretarit njoftimi bëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari apo një person i ngarkuar me shkrim prej tyre. Në çdo rast njoftuesi shkruan emrin dhe nënshkruan në fund të dokumentit të njoftimit të bërë.

Neni 81
Mbajtja e mbledhjes së Këshillit në kundërshtim me rregullin

Mbledhja e Këshillit është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara në këtë Rregullore per thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetem ne rast se ne ate mbledhje marrin pjese 2/3 e anëtaret me te drejte vote, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes .

Neni 82

Rendi i ditës i mbledhjes

1. Kryetari **(apo kryesia, më sipër)** në bashkëpunim me zevëndëskryetarët dhe Sekretarin, dhe në këshillim paraprak me Kryetarin e Bashkisë përgatit rendin paraprak të ditës, radhën e shqyrtimit të çeshtjeve dhe oraret perkatëse, për të gjitha mbledhjet zyrtare të Këshillit bazuar edhe në sugjerimet për rendit të ditës së diskutuar në mbledhjen e mëparshme.Titulli dhe kodi i secilit projektakt apo rezolutë për të cilin Këshilli do të shqyrtojë dhe do të marri vendim në atë mbledhje duhet të përfshihet në rendin e ditës.
2. Kërkesa për informacion dhe raporte drejtuar ekzekutivit te Bashkisë nga Këshilltarët në lidhje me administrimin e Bashkisë apo me veprime apo mosveprime te Ekzekutivit nuk përfshihen në rendin e ditës, nëse një kërkesë e tillë nuk i është dërguar me parë Sekretarit të Keshillit Bashkiak.

Neni 83
Pika e rendi të ditës për çështje emergjente

Pika e rendi të ditës për çështje emergjente mund të shtohen në rend të ditës, sic janë çështjet që prekin menjëherë shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit, të tilla si mungesë e rendit civil masiv, katastrofat dhe emergjencat e tjera të rënda. Arsyeja (et) për shtimin e një pike emergjente në rendin e ditës do të shpallet publikisht në mbledhje, dhe çështja do të përfshihet në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 84
Miratimi i Rendi të Ditës në Mbledhje

1. Rendi i ditës miratohet nga Këshilli

2. Para propozimit për të aprovuar rendin e ditës, Kryetari/ Kryesuesi i drejtohet Këshilltarëve nëse dëshirojnë që një pikë e rendin paraprak të ditës të paraqitur të hiqet apo të shtohet një pikë tjetër.
3. Çdo projekt-akt, rezolutë apo mocion që paraqitet me shkrim duhet të ketë emrin dhe nënshkrimin e propozuesit, dhe nëse ka, edhe të mbështetetësve, si dhe datën.

Neni 85

Mbajtja e Mbledhjes së Hapur

1. Në orën e caktuar për hapjen e mbledhjes Kryesuesi/ja hap mbledhjen dhe Sekretari i Këshillit proçedon me shprehjen e ligjshmërisë të vendimeve të miratuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut.
2. Nëse kuorumi nuk paraqitet brenda 30 minutave pas orës së hapjes së Mbledhjes, asnjë anëtari të pranishëm nuk mund t'i kërkohet nga Kryetari/Kryesuesi të qëndroje më gjatë, përveçse kur ai e dëshiron një gjë të tillë. Në këtë rast Kryetari/Kryesuesi mund të deklarojë lejimin e largimit të Këshilltarit/ëve nga salla e mbledhjes, përveç se në rastin kur shumica e Këshilltarëve të pranishëm bien dakort ndryshe.
3. Kurdoherë që Kryesuesi verifikon se shumica e domosdoshme nuk është e pranishëm, Kryesuesi mund të urdhërojë Sekretarin t'u kërkojë Këshilltarët mungues të jenë të pranishëm në mbledhje. Ky urdhër merret pa debat dhe derisa të ekzekutohet ai dhe deri kur shumica e domosdoshme do të jenë të pranishëm, asnjë propozim nuk do të jetë në rendin e ditës përveç kur bëhet fjalë për shtyrje të mbledhjes.

4. Kryesuesi i kërkon specialistit të protokollit të shënojë në Procesverbalin e Mbledhjes se i bën të ditur Këshilltarit jo të pranishëm se prania e tij kërkohet pasi bllokon fillimin e mbledhjes së Këshillit. Njoftimi konsideroheti bërë kur Sekretari ia komunikon këtë me telefon direkt Këshilltarit.

5. Kur edhe pas këtyre veprimeve nuk sigurohet kuorumi, bazuar në nenin 11 të ligjit nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale te administratës shtetërore dhe enteve publike", Kryesuesi vendos thirrjen e mbledhjes ne një dite tjetër, te paktën 24 ore pas se parës. Ne këtë rast mbledhja është e vlefshme ne qoftëse sigurohet kuorumi i nevojshëm sipas çështjeve që trajtohen.

6. Kryesuesi deklaron hapjen e mbledhjes, nëse Kuorumi është i pranishëm, gjë të cilën ia konfirmon Sekretari. Në fillim të mbledhjes Këshilli miraton përfundimisht pikat e rendit të ditës dhe radhën e zhvillimit të tyre.

Neni 86

Mbajtja e Mbledhjes së Mbyllur

1. Mbledhja e Mbyllur mbahet me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë ose të një të pestës (1/5) së anëtarëve të Këshillit Bashkiak, dhe kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat (3/5) e gjithë anëtarëve të Këshillit, nëse kjo nuk pengohet nga ligji, dhe sipas procedurave ligjore dhe kësaj Rregulloreje.

2. Në cdo rast vendimi për të mbajtur një Mbledhjen e Mbyllur bëhën në një mbledhje të hapur të Këshillit, ku Drejtuesi i mbledhjes shpjegon arsyet, bazushmërine ligjore, çështjen/t që do shqyrtohen, sidhe njofton datën, orën dhe vendin e mbajtjes së mledhjes.

3. Pjesëmarrësit në mbledhjen e mbyllur regjistrohen dhe kjo e dhënë është publike. Mbledhjet

4. e mbyllur regjistrohet në procesberbalin e mbledhjes dhe ne audio, dhe kjo e dhënë nuk është e hapur për publikun. Të dhënat e mbledhjes së mbyllur hapen për publikun jo më vonë se dy vjet nga mbajtja e mbledhjes së mbyllur.

5. Nëse ka pretendimi që në mbledhjen e mbullyr janë trajtuar çështje shtesë apo të ndryshme nga ato të shpallura në mbledhjen e hapur, pretenduesi mund ti drejtohet gjykatës.

6. Këshilli mund të mbajë një Mbledhje të Mbyllur kur kjo kërkohet për të:
   a. Penguar zbulimin e një informacioni të privilegjuar dhe konfidencial (jo publik), i përcaktuar si i tillë me ligj.
   b. Shqyrtuar fillimin e proçedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së Këshillit.
   c. Shqyrtuar cështje konflikti mes banorëve.
   d. Shqyrtuar ankesa kundrejt Këshilltarëve, Kryetarit dhe stafit të Bashkisë.
   e. Planifikuar, raportuar apo dëgjuar raporte që kanë lidhje me hetime të sjelljeve kriminale.
   f. Penguar daljen e parakohshme të informacionit për një titull honorifik, apo çmim.
   g. Thyerje te Kodit te Sjelljes apo Etikes
7. Çështje të cilat shqyrtohen në një Mbledhje të Mbyllur i duhen njoftuar publikut. Persona jo Këshilltarë mund të lejohen të marrin pjesë në një Mbledhje të Mbyllur nëse ato ndihmojnë në shqyrtimin e çështjes/ve dhe kur për këtë vendos shumica e Këshilltarëve të pranishëm në mbledhje.

8. Materialet e paraqitura dhe të shqyrtuara në një Mbledhje të Mbyllur nuk publikohen. Ato mund të bëhen publike vetëm mbas rënies së shkakut për të cilën është mbajtur Mbledhja e Mbyllur. Këshilli i mëpasshëm mund të vendosi të hapë për inspektim publik rekordet e Mbledhjeve të Mbyllura të Këshillit/ave të mëparshëm.
9. Sekretari dhe këshilltarët ruajnë konfidencialitetin e mbledhjeve të mbyllura të Këshillit dhe çdo shkleje e këtij detyrimi përbën shkak për masë disiplinore ndaj tij/saj.

Neni 87

Proçedimi i mbledhjes

Proçedimi i mbledhjes vazhdon sipas radhës vijuese:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Leximi i vendimeve të mbledhjes se mëparshme dhe konfirmimet e prefektit.
3. Rishqyrtim i projekt-akteve të Këshillit.
4. Paraqitja e shqetësimeve të komunitetit nëpërmjet këshilltarëve.

Neni 88

Qetësia dhe rregulli në mbledhjet e Këshillit dhe të Komisionet e Përhershme

1. Kryetari i Këshillit/kryesuesi i mbledhjes së Këshillit ruan rregullin dhe qetësinë gjatë zhvillimit të mbledhjes. Këshillaret apo personat e tjerë të pranishmë në mbledhjen e Këshillit të cilët prishin qetësinë dhe pengojnë zhvillimin normal të mbledhjes se Këshillit, u kërkohet nga Kryetari i Këshillit/kryesuesi i mbledhjes të largohen nga mbledhja. Në rast refuzimi Kryetari i Këshillit/ kryesuesi i mbledhjes i kërkon trupës së sigurisë së mbledhjes ti largoj përsonat në fjalë.
2. Publiku apo të ftuarit në mbledhje nuk lejohen të duartrokasin apo brohorasin në mbështjetje apo kundështi të një çështje që shqyrtohet apo votohen në Këshill.
3. Një person që largohet nga mbledhja për prishje të qetësisë, rregullit, mosrespektim të kësaj rregulloreje, nuk lejohet të marrë pjesë përsëri në të njëjtën Mbledhje nga e cila është larguar. Nëse të njëjtën sjellje personi e ka edhe në mbledhjene radhës, atij/asaj i ndalohet pjesëmarrja në Mbledhje por jo me shumë se gjashtë (6) muaj.
4. Në rast të nje situate rrëmuje apo pasiguri Kryetari /Kryesuesi kërkon, qoftë edhe me ndihmën e trupës së sigurië së mbledhjes, boshatisjen e salles së Mbledhjeve.
5. Ndalohet përdorimi i telefonave celular përgjatë mbledhjeve të Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme. Kryetari i Këshillit/kryesuesi i mbledhjes së Këshillit do të zbatojë këtë rregull duke kërkuar që të gjitha telefonat celular të mbahen të heshtur në fillim të mbledhje deri në përfunim të saj. Mos repsektimi i këtij rregulli nga Këshillarët apo personat e tjerë të pranishmë në mbledhjen e Këshillit konsiderohet prishje e mbledhjes së Këshillit apo Komisionit të Përhershëm, dhe Kryesuesi kërkon largimin nga mbledhja po mjediset perreth.

Neni 89

Rregjistrimi i mbledhjes.

Te gjitha Mbledhjet e Këshillit në rastet kur administrata ka marrë masat dhe instaluar aparaturat rregjistrohen audiovideo dhe kopjet e rregjistrimeve ruhen nga Sekretari sipas rregullave të ruajtjes së të dhenave e dokumenteve zyrtarë. Rregjistrimet janë të hapura për publikun për aq sa mbajnë të dhëna publike.

Neni 90

Kryesuesi i Mbledhjes

1. Kryetari i Këshillit drejton gjithmonë një Mbledhje Zyrtare të Këshillit
2. Zëv/kryetari i Këshillit vepron si Kryetar gjatë sëmundjes, apo mungesës së përkohshmetë Kryetarit. Në rastin kur të dy Zëvendëskryetarët, gjatë kohës që veprojnë si Drejtues, janë të sëmurë ose mungojnë përkohësisht, Kryetari i Komisionit të Mandateve dhe Rregullores, kur është i disponueshëm, vepron si Drejtues në intervalin e përmendur. Në mungesë të Kryetarit, Z/kryetarit dhe Kryetari i Komisionit të Mandateve dhe Rregullores mbledhja drejtohet nga këshilltari më i vjetër prezent në sallë.
3. Firmosja e vendimeve të asaj mbledhje duhet bërë nga kryetari dhe në mungesë të tyre nga zëvendëskryetarët.
4. Për çështje proçeduriale vendimet e Kryesuesit janë përfundimtare, ndonëse për çdo vendim të tillë çdo Këshilltar mund të kërkojë votim të përgjithshëm të Këshilltarëve të pranishëm.

Neni 91

Kryesuesi ka fuqitë e mëposhtme:

1. Të drejtojë mbledhjen duke respektuar proçedurat e miratuara në mbledhje, dhe të parashikuara në këtë rregullore, duke përfshirë heqjen nga rendi i ditës të çdo mocioni që ai e gjykon se ka qëllim pengues për vazhdimin apo zgjatjen e paarsyeshme të Mbledhjes.
2. Të vlerësojë nëse një Këshilltar ka kapërcyer standardet e mirësjelljes dhe etikës gjatë fjalës së tij.
3. Te drejtoje mbledhjen në mënyre te paanshme dhe me kohë të barabartë në diskutime pa dallim.
4. Të bëjë shpalljen e rezultateve të votimi të hapur dhe të fshehtë.
5. Të urdhërojë daljen nga salla e mbledhjes të një Këshilltari i cili tenton të prishë mbledhjen, si dhe çdo të pranishmi nga publiku apo stafi i Bashkisë i cili nuk respekton qetësinë dhe rregullin e mbledhjes.
6. T'i heqë të drejtën e vazhdimit të fjalës çdo Këshilltari i cili gjatë fjalës së tij kalon kohën e vënë në dispozicion, sipas kësaj rregulloreje, për çdo Këshilltar.

Neni 92

Procedura e shqyrtimit të çështjeve/projekt akteve

1. Projekt-aktet shqyrtohen dhe votohen një nga një sipas rendit të ditës së miratuar.
2. Si rregull fillimisht i jepet fjala propozuesit të projekt-aktit për të relatuar për propozimin.
3. Pas relatimit të propozuesit, vijohet me relatimin e komisioneve që kanë shqyrtuar materialin.
4. Pas relatimit të komisioneve vijohet me pyetje nga këshilltarët për propozuesin e projekt aktit. Pyetjet mund të paraqiten me shkrim ose verbalisht. E drejta e fjalës për të bërë pyetje jepet nga drejtuesi i mbledhjes.

5. Pas përfundimit të pyetjeve, i jepet fjala propozuesit të projekt- aktit për tu përgjigjur. Në rastin e çështjeve komplekse, propozuesi ka të drejtën të kërkojë kohë për të përgatitur përgjigjet. Gjatë përgjigjeve nuk lejohet debat.
6. Pas përgjigjeve nga propozuesi, çdo këshilltar që kërkon fjalën mund të diskutojë për projekt aktin/çështjen. Koha e diskutimeve për çdo këshilltar si rregull është 5 min, përveç rasteve kur këshilli mund të vendosë ndryshe. Një diskutant nuk mund të marrë nga koha e një diskutanti tjetër.
7. Kryetari i këshillit me ndihmën e sekretarit mban shënim emrat e këshilltarëve që kanë kërkuar fjalën. Radha e fjalës për të diskutuar caktohet nga Kryetari, duke respektuar edhe përfaqësimin politik të këshilltarëve. Këshilltarit që nuk i është dhënë fjala, nuk mund të diskutojë.
8. Kur këshilltari del jashtë temës së diskutimit të çështjes, i tërhiqet vëmendja nga Kryetari i këshillit. Kur këshilltari edhe pas kësaj e përsërit veprimin, atij i ndërpritet fjala nga Kryetari.
9. Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë. Janë çështje të procedurës kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e rregullores, kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e seancës ose të diskutimeve, si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerjes së votimit.
10. Ndërhyrjet për çështjet e procedurës bëhen shkurtimisht dhe pa prekur thelbin e çështjes kryesore. Në këto raste, përveç propozuesit që diskuton jo më shumë se 2 minuta, kanë të drejtë të diskutojnë një folës pro dhe një folës kundër, jo më shumë se 2 minuta secili.
11. Kryetari i këshillit kryesisht, ose me kërkese të një kryetari grupi, mund të vendosë që mes çështjeve të caktuara, të bëhet një pushim i shkurtër.
12. Kur një këshilltar ka pyetje për Kryetarin e Bashkisë, jashtë rendit të ditës, ato paraqiten me shkrim te Sekretari i Këshillit, i cili ia dërgon Kryetarit të Bashkisë. Kryetari i bashkisë ka të drejtë të kërkojë kohë për përgjigjet, por jo më shumë se mbledhja tjetër e radhës e këshillit. Kur këshilltari e kërkon, përgjigja e pyetjeve përfshihet në rendin e ditës, si pikë më vete, në sesionin e përgjigjeve të Kryetarit të Bashkisë. Kryetari i Bashkisë nuk ka detyrim t'i përgjigjet pyetjeve, pavarësisht se kjo është futur në rendin e ditës, nëse këshilltari/ët nuk është/ janë i/të pranishëm.

Neni 93

Debati

Procedura e Debatit

1. Këshilltarit i jepet fjala nga Kryesuesi për të ngritur një ceshtje për debat. Fjala kërkohet me ngritjen e dorës dhe Këshilltarët mund të flasin nga vendi ose në tribunë .
2. Kryetari i Këshillit, përcakton rradhën e diskutimeve, duke mbajtur parasysh kohën e kërkesës, si dhe kombinimin e grupeve të këshilltarëve. Kryetarët e grupeve kanë të drejtë të diskutojnë jashtë rradhe, në rast se e kërkojnë fjalën.

3. Kryetari i Komisioni të Përhershëm që ka radhën të raportojë në mbledhjen e Këshillit, apo i autorizuari prej tij/saj, i jepet mundësia nga Kryesuesi i Mbledhjes të hapë debatin për mocionin/ çështjen për shqyrtim e rendit të ditës. Pas njoftimit nga Kryesuesi i Mbledhjes se debati është i mbyllur, Kryetari i Grupit Politik të Pakicës apo i autorizuari prej tij/saj, mund të jetë folësi i parafundit dhe mbyll debatin për pakicën politike. Kryetari i Grupit Politik të Shumicës, ose personi i autorizur prej i tij, mund të mbyllë debatin për partinë e shumicës dhe është folësi i fundit për atë mocion.
4. Çdo Këshilltar, kur i jepet e drejta e fjalës nga drejtuesi i Mbledhjes, mund të flasë për çdo çështje kur pikë e rendit të ditë janë çështjet e përgjithshme. Këshilltari mund të futë, përfshijë në procesverbalin zyrtar të Mbledhjes dokument ose deklaratë të shkruar por jo më shumë se pesë (5) faqe, ose mund të flasë jo më shumë se dy (2) minuta, përveç nëse leja për të zgjatur kohën i jepet nga shumica e anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje.
5. Nëse Këshilltari gjatë debatit del nga tema Kryesuesi i bën vërejtje por nëse ai vazhdon Kryesuesi i heq të drejtën e fjalës për atë çështje.
6. Vetëm Këshilltarit të cilit i është dhënë fjala nga Kryesuesi ka të drejtën t'i regjistrohen fjalët në procesverbalin e mbledhjes apo në mjetet audiovizive zyrtare të Këshillit
7. Secili Këshilltar para se të marrë fjalën i drejtohet Kryesuesit me fjalët "Zoti/Zonja Kryetar/e".
8. Kur Kryesuesi i drejtohet një Këshilltari, ai i drejtohet atij duke përdorur titullin "Anëtar i Këshillit Z/Znj". Anëtari që kërkon i pari fjalën dëgjohet i pari dhe nëse dy Këshilltarë të tjerë kërkojnë njëkohësisht fjalën Kryesuesi vendos se kush do të flasë i pari.
9. Këshilltari nuk mund të flasë për të njëjtën çështje më shumë se një herë.
10. Çdo Këshilltar ka të drejtën e replikës nëse gjatë fjalës së një Këshilltari atij i përmendet emri. Replika mbahet menjëherë pas diskutimin të Këshilltarit ndaj të cilit do të bëhet replika dhe nuk vazhdon më shumë se një (1) minutë.
11. Kryetari (në mungesë Z/kryetari) i Bashkisë ka të drejtë të marrin fjalën për të diskutuar për çështjen që shqyrtohet nga Këshilli, por jo më shumë së dy herë për të njëjtën çështje. Fjala u jepet edhe drejtuesve të departamenteve/drejtorive të ftuar në mbledhje, nëse Këshilli ka nevojë për sqarime.
12. Në rast se Kryesuesi nuk ka më kërkesa për debat ai deklaron mbylljen e debatit dhe fillimin e votimit. Asnjë Këshilltari nuk i jepet e drejta e fjalës mbas fillimit të votimit.
13. Mocioni për mbylljen e debatit kërkon dy të tretat e Këshilltarëve të pranishëmve në mbledhje. Çdo Këshilltar ka të drejtëtë bëjë mocion për mbylljen e mbledhjes.

Neni 94

Replika gjatë diskutimeve

Këshilltari ka të drejtën e replikës, në rast se i përmendet emri në diskutimin e prafolësit.
Replika është një qëndrim i paraqitur në mënyrë të shkurtër, për përmbajtjen e problemit që është në diskutim. Replika bëhet menjëherë, pas diskutimit dhe nuk mund të vazhdojë më shumë se 2 minuta. Pas replikës, nuk ka kundër replikë.

Neni 95

Etika gjatë proçedimit të Mbledhjes

Këshilltari shmang në çdo kohë fyerjen apo mungesën e respektit ndaj Këshillit apo të pranishëmve në mbledhje.

KREU VIII.

E Drejta e Votës dhe Votimi

Neni 96
E drejta e votës

1. Këshilltari nuk mund të delegojë të drejtën e votës.
2. Këshilltari voton në një mbledhje zyrtare dhe të vlefshme të Këshillit, kur votimi kërkohet dhe kryhet sipas procedurave ligjore dhe atyre të parashikuara nga kjo rregullore e Këshillit. Votimi është individual.
3. Votimi i Këshilltarit me telefon apo nëpërmjet video konferencës nuk lejohet përveç në rastet e emergjencës civile të shpallur zyrtarisht dhe sipas kërkesave ligjore dhe procedures së kësaj Rregullore.
4. Votimi në Mbledhjen e Këshillit mund të bëhet i hapur apo i fshehtë.

Neni 97

Votimi i hapur

1. Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës në përgjigje të fjalëve Pro, Kundra, Abstenim të thëna nga Kryesuesi i mbledhjes.

2. Votimi i hapur mund të bëhet nominal. Në këtë rast Sekretari thërret emrat një nga një sipas listës së përgatitur me Këshilltarët pjesmarrës në mbledhje. Mbas thirrjes së emrit Këshilltari voton me zë me Pro, Kundër dhe Abstenoj. Në secilin rast Sekretari bën numërimin e votave dhe rezultatin e votave ia komunikon Kryesuesit të mbledhjes.

Neni 98
Votimi i fshehtë

1. Votimi i fshehtë bëhet për çështje me karakter individual që lidhen me persona fizikë apo juridik (persona, organizata apo biznese private) ndaj të cilëve krijohen pasoja juridike mbi bazë të akti me karakter individual të nxjerrë nga këshilli, si dhe në rastet e vlerësimeve mbi sjelljen ose cilësitë e një individi. Mënyra e votimit përcaktohet me shumicën e votave të të gjithë antarëve të Këshillit Bashkisë.
2. Votimi i fshehtë administrohet nga Komisioni i Votimit i përbërë minimalisht nga tre këshilltarë. Mbas mbarimit të votimit dhe numërimit të votave, Kryetari i Komisionit i

komunikon Këshillit rezultatet e votimit. Rezultatet e votimit regjistrohen në një procesverbal të firmosur nga të gjithë anëtaret e Komisionit të Votimit. Nëse një anëtar i Komisionit të Votimit ka vërejtje për procesin e votimit, mënyrën e numërimit të votave dhe nxjerrjen e rezultateve ai/ajo i shkruan në procesverbalin e votimit.

3. Kryesuesi i bën të ditur të gjithë Këshilltarëve përmbajtjen e procesverbalit të votimit, rezultatet e votimit si dhe vërejtjet e mundshme të një apo disa anëtarëve të komisionit, të cilat regjistrohen në Procesverbalin e Mbledhjes.
4. Çdo Grup Këshilltarësh, para fillimit të votimit, ka të drejtë të tërhiqet për konsultim për një kohë deri në 10 minuta.
5. Votimi i akteve si rregull fillimisht bëhet në parim dhe pastaj, nëse kërkohet nga shumica e Këshiltarëve të pranishë në mbledhje, bëhet në total apo nen për nen.
6. Në rast se votimi ndërpritet për arsye të mungesës së rregullit në sallë Kryesuesi, mbas rënies së shkakut të ndërprerjes së votimit, shpall rifillimin e votimit.

Neni 99

Barazia e votave

1. Ne rastet kur votimi nuk ka qene i fshehtë dhe rezultati i votimit është i barabartë, vota e Kryetarit/drejtuesit të mbledhjes është vendimtare.
2. Në rast se votimi behet i fshehte dhe votat jane te barabarta, do te kryhet nje votim i dyte. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do te shtyhet per mbledhjen tjeter. Në qoftë se në votimin e pare te mbledhjes tjetër do të kemi përsëri një barazi votash, atehere do te kryhet votim i hapur.
3. Kryetari voton i fundit.

Neni 100

Numerimi i votave ne votimin e hapur

Votat si rregull i numëron sekretari i Këshillit i cili prezanton rezultatin me zë të lartë në Këshill.

Neni 101

Shpjegimi i Votës apo Mosvotimit

1. Këshiltari mund të shpjegojë votën e tij vetëm me leje të Kryesuesit të Mbledhjes dhe për një kohë jo më shumë se dy (2) minuta.
2. Këshilltarët mund ti paraqesin me shkrim Këshillit dhe Komisionit të Përhershëm arsyet e votimit apo mos votimit të një projekt akti apo çështje, dhe ky shpjegim bëhet pjesë e dokumentacionit të mbledhjes dhe shënohet në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 102

Inspektimi i Votave të Këshilltarëve nga Publiku

Emra e Këshilltarëve që kanë votuar Pro dhe Kundër si dhe të atyre Këshilltarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje por nuk kanë votuar, si në mbledhjen e Këshilli dhe në ato të Komisioneve të Përhershme, pasqyrohen në proceverbalin e mbledhjes. Rekordet e votimit të Këshilltarëve janë të hapura për inspektim nga publiku, nëpërmjet Sekretarit të Këshillit.

Marrëdhënjet me publikun dhe median

Informimi i publikut dhe transparenca

Neni 103

Informimi i Bashkësisë

Informimi i publikut nga Këshilli Bashkiak bëhet në përputhje me ligjin 119/29014 "Për të drejtën e Informimit" dhe rregullat e përcaktuara nga Këshilli në këtë rregullore (ligji 139, neni 18/3).

Neni 104

Transparenca e Veprimtarisë së Këshillit (ligji 139, neni 15/1)

Këshilli garanton për publikun transparencën e veprimtarisë së tij. Informacioni i veprimtarisë së Këshillit që i vihet në dispozicion publikut në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë duhet të jetë i plotë, lehtësisht i aksesueshëm, i përditësuar, i kuptueshëm, lehtësisht i përdorshëm nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Neni 105

Programi i Transparencës

1. Këshilli Bashkiak është i detyruar të miratojë programin e transparencës (ligji 139, neni 15/3) në referencë të modelit të përgatitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Këshilli Bashkiak bën transparent për bashkësinë, minimalisht për (referuar ligjit 119/2014, neni 7, ligjit 146/2014):
   a. Përbërjen dhe strukturat (anëtarët, kryetari i këshillit, sekretari i këshillit, komisionet, grupet e këshilltarëve), CV-të, fotot dhe kontaktet e Këshilltarëve.
   b. Detyrat dhe kompetencat e Këshillit , të Komisioneve dhe Sekretariti të Këshillit
   c. Rregulloren e Këshillit Bashkiak
   d. Kalendarin e mbledhjeve të Këshillit dhe Komisioneve

e. Njoftimet për mbledhjen e Këshillit dhe Komisioneve
f. Rendi i ditës për mbledhjen e Këshillit dhe Komisioneve
g. Projekt vendimet në proçes shqyrtimi
h. Aktet, rezolutat dhe deklaratat e miratuara (ligji 139, neni 15/2), përveç atyre që nuk lejohen me ligj.
i. Planin vjetor të punës
j. Planin vjetor të vendimmarrjes (ligji 146/2014, neni 16/b)
k. Rregjistrin elektronik të p/akteve (ligji 146/2014, neni 7, 16/a)
l. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit dhe Komisioneve
m. Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ
n. Kodin e Sjelljes
o. Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve të Këhsillit bahkiak për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhet të Këshillit.
p. Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim pranë Këshillit Bashkiak, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.
q. Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e Këshillit Bashkiak.
r. Çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër Këshillin Bashkiak në hartimin e akteve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Këshillit Bashkiak;
s. Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi Këshillin Bashkiak, përfshirë planet e punës, raportet e auditimit, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së Këshillit Bashkiak.
t. Raportin vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes
u. Dokumente të tjera që kërkohen sipas ligji 119/2014 Për të Drejtën e Informimit

3. Programi i Transparencës së Këshillit hartohet nga Kryesia e Këshillit në bashkëpunim me Sekretarin e Këshillit dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak. Rishikimi i programit të transparencës së Këshillit bëhet një herë në vit, dhe ndryshimet propozohen nga Kryetari apo cdo grup Këshilltarësh.

Neni 106

Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes

1. Këshilli Bashkiak është i detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raportin vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:
   a) numrin e akteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak përkatës gjatë vitit referues;
   b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;

c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;

ç) numrin e takimeve publike të organizuara.

2. Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes publikohet sipas parashikimeve të nenit 11 të ligjit146/29014.

Neni 107

Publikimi i Aktet, Rezolutave dhe Deklaratave të Këshillit

Aktet e miratuara nga Këshilli afishohen edhe në vende publike, të caktuara nga Këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të Bashkisë dhe, sipas mundësive, Këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. (ligji 139, neni 15/2)

Neni 108

Pasqyrimi i aktiviteteve të Këshillit, Komisioneve dhe Këshilltareve

Aktivitetet e Këshillit, Komisioneve dhe Këshilltarëve pasqyrohen në faqen e internetit të Bashkisë, në një ndërfaqe të veçantë.

Neni 109

Prezenca në Internet

1. Këshilli Bashkiak ka ndërfaqen e Tij në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.
2. Kryesia harton planin vjetor të komunikimit dhe kosnultimit me publikun, dhe shpenzimet për zbatimin e plani i perfshin në buxhetin vjetor të Këshillit.
3. Specialisti i sekretariatit në bashkëpunim me Sekretarin e Këshillit është përgjegjës për bërjen publike të dokumenteve dhe për pasqyrimin e aktiviteteve të Këshillit, Komisioneve dhe Këshilltareve, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë, të ndihmura nga punonjësit e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe ato të komunikimit me publikun të Bashkisë.
4. Vendimi i Këshillit për detyrimet fiskale vendore publikohet brenda 15 ditëve nga miratimi i tij. (ligji 68/2017, neni 5/ b)

Pjesëmarrja dhe Konsultimi i Publikut

Neni 110

Te drejtat e qytetareve për pjesëmarrje në qeverisjen bashkiake

1. E drejta për të marrë pjesë në në qeverisjen bashkiake nënkupton të drejtën për të kërkuar për të përcaktuar ose për të ndikuar në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësive të qeverisë bashkiake.
2. Këshilli Bashkiak është i detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes (ligji 139, neni 16/1), nëpëmjet seancavë të këshillimit me bashkësinë apo pjesëmarrjes direkte të bashkisisë në hartimin e dokumenteve të politikave dhe projektakteve.

Neni 111

Mënyrat e Këshillimit me Bashkësinë

Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në këte rregullore të Këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si:

a-takimet e hapura me banorët e grupet e interesit,
b-seanca dëgjimore me bashkësinë,
c- takime me specialistë,
d-takime me me institucione të interesuara,
e- takime me organizata jofitimprurëse, ose
f- nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.
g- forumet me qytetarët
h-panele me qytetarët
i- tryeza të rrumbullakëta
j- anketimet (elektronike)

Neni 112

Seancat e Këshillimit me Bashkësinë

1. Këshilli mban Seancat e Këshillimit me bashkësinënë rastet kur:
   a. Zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet
   b. Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
   c. Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave Bashkiake.
   d. Vendos për taksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.
   e. Miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik".
   f. Plani rregullues i qytetit,
   g. Ndertime, prishje apo modifikime sheshesh, rrugesh, trotuaresh, lulishtesh, parqesh etj.
2. Këshilli mban seanca këshillimi me bashkësinë edhe në rastet kur miraton dokumente strategjike të Bashkisë apo për çdo çeshtje tjetër që Këshilli e gjykon të nevojshme të këshillohet me bashkësinë apo grupet e interesit.
3. Sekretari i Këshillit është përgjegjës për përgatitjen e seancave të këshillimit të Këshillit me Bashkësinë (ligji 139 nenin 18/1), sipas kalendarit të takimeve të hapura me bashkësine dhe grupet e interesit të miratuar nga Kryesia e Këshilli.
4. Sekretari i Këshillit në konsultim më Kryetarin e Këshillit përgatisin planin e seancave të këshillimit me bashkësinë. Menjëherë pas përcaktimit të vendit, datës dhe orës për zhvillimin e seancës së këshillimi me bashkësinë, Sekretari bën njoftimin drejtuar Këshilltarëve publikut dhe OJF-ve të interesuara për të marrë pjesë në takim, si dhe të medias.

5. Kryetarët e Komisioneve të Përhërshme duhet të marrin pjesë në seancat e këshillimit me bashkësine, në varësi të fushës që mbulon Komisioni i Përhershëm.
6. Në përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë Sekretari bashkëpunon dhe ndihmohet nga Kordinatori i Bashkisë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe punonjësit e Sekretariatit.
7. Vendi, data dhe koha kur do të mbahen seancash dëgjimore me publikun, shpallen në mediat elektronike dhe të shkruara, në tabelën e shpalljeve në ndërtesën kryesore të Bashkisë dhe në vendet më frekuentuese në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, në ueb faqen zyrtare të Bashkisë si dhe në rrjetet sociale. Shpalljen publike e bën Sekretari në bashkepunim më Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.
8. Seancat e këshillimit më bashkësinë drejtohen nga një Këshillari i Këshillit/Kryetari i komisionit të Përhershëm, dhe lehtësohen nga Sekretari i Këshillit apo Koordinatori për Konsultimin Publik i Bashkisë.
9. Mendimet e shprehura nga publiku në seancat e këshillimit me bashkësinë dokumentohen në proçes-verbalin mbledhjes dhe i bashkëngjiten projekt aktit dhe vendimit të Këshilli
10. Kryetari i secili Komision të Përkohshëm mund të thërrasë një dëgjesë publike mbi çështje që i përkasin fushës së veprimtarisë së Komisionit. Kryetari i secili Komision të Përkohshëm gjithashtu ka të drejtë të pranojë paraqitjen e dëshmive të publikut në mbledhjen e Komisionit për çështje që shqyrtohen nga Komisioni.

Standartet Minimale të Pjesëmarrjes e Konsultimit të Publikut

Neni 113

Njoftimi takimeve e dëgjesave publike

Njoftim bëhet përmes:

1. Ndërlidhësit komunitar në lagjet e qytetit apo kryetarët e fshatrave (ne rastet kur takimet behen atje);
2. Media audiovizive vendore
3. Faqes zyrtare të internetit të Bashkisë;
4. Rrjete sociale zyrtare të Këshillit

Neni 114

Konsultimi i Publikut me projektaktet e depozituara në Këshill për shqyrtim.

1. Çdo qytetar ka të drejtë:
   a) të kërkojë informacion për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë aksesin në projektakt, sipas legjislacionit në fuqi;

b) t'i propozojë këshillit bashkiak fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projektakteve, sipas planit vjetor të procesit të vendimmarrjes, publikuar nga këshilli bashkiak në faqen zyrtare të internetit;

c) t'u dorëzojë organeve publike komente dhe rekomandime për projektaktet që janë në proces të njoftimit e të konsultimit publik.

2. Çdo projekt akt që depozitohet për shqyrtim në Këshillin Bashkiak, publikohet paraprakisht në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në faqen zyrtare të internet të Bashkisë. Ky regjistër shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me Këshillin në lidhje me projekt aktet e propozuara (ligji 146/2014, neni 7/1).

Neni 115

Të drejtat e palëve të interesuara për njoftimin dhe konsultimin publik të projektakteve

Palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik kanë të drejtë:

1. Ti kërkojnë Këshillit Bashkiak informacion për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë aksesin në projekt aktet, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 6, të ligjit 146/2014, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 4 të po këtij ligji;

2. Ti propozojnë Këshillit Bashkiak fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projekt akteve, sipas planit vjetor të procesit të vendimmarrjes, publikuar nga Këshilli Bashkiak, në përputhje me parashikimet e shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 6, të ligjit 146/2014;

3. Ti dorëzojnë Këshillit Bashkiak komente dhe rekomandime për projekt aktet që janë në proces të njoftimit e të konsultimit publik.

Neni 116

Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve

1. Njoftimi për projektaktet që do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrit elektronik. Në rastet kur Këshilli Bashkiak e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme: (Ligji 146/2014, neni 11/1)

a) me postë elektronike;

b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e Bashkisë;

c) me një lajmërim në mediat audiovizive vendore;

2. Kryetari i Këshillit mbas konsultimit me Zëvendëskryetarët e Këshillit Bashkiak, vendos për rastet kur do të përdoren format e tjera të njoftimit të përmendua më gërmat e pikës 1 të këtij neni, dhe ja njofton me shkrim këto Sekretarit të Këshillit.

3. Sekretari i Këshillit është përgjegjës për përbërjen e njoftimeve publike për konsultim të projektakteve të depozitura për shqyrtim në Këshillin Bashkiak, njoftim të cilin e bën mbas miratimit të rendit të dits së mbledhjes së Këshillit Bashkiak, dhe e realizon me mbështetjen e Koordinatorit të Bashkisë për njoftimin dhe Konsultimin Publik, punonjësve të Drejtorisë së Teknologjise së Informacinit dhe ato të Drejtorisë së Komunikimit me Publikun të Bashkisë.
4. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet me postë elektronike, me shkrim si dhe në raste të caktuara në formë verbale të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike (Ligji 146/2014, neni 11/2).
5. Sekretari i Këshillit, më mbështetjene e punonjësve të Sekretariatit të Këshillit Bashkiak, mundëson grumbullimin dhe sistemin e komenteve dhe rekomandimeve të publikut në procesin e konsultimit, dhe ja bashkengjit secilit prej projektakteve.

Neni 117

Iniciativa qytetare

1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij apo jo më pak se një për qind e banorve të bashkisë me të drejtë vote, ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në Këshillin Bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të bashkisë (ligji 139/2015, neni 20/1).
2. Këto iniciativa qytetare duhet të kene dhe të përmbajnë:
   a) propozuesin/it;
   b) objektin që propozohet;
   c) bazën ligjore të propozimit;
   ç) arsyet e propozimit dhe efektet e pritshme të aktit;
   d) materiale shtesë nëse ka.
3. Iniciativa qytetare shoqërohet me listën e personave propozues, nënshkrimin e tyre, nr.personal, të dhënat dhe adresën e përfaqësuesit.
4. Iniciativa qytetare dorëzohet zyrtarisht, në zyrën e protokoll arkivit të Bashkisë, e cila më pas ja përcjell Kryetarit të Këshillit
5. Këto iniciativa qytetare para se ti paraqiten Këshillit duhet të marrin mendimin me shkrim të Kryetarit të Bashkisë qoftë përsa i përkët çështjes që propozohet si dhe ndikimeve finaciare nëse ka, si dhe konfirmimin për bazueshmërinë ligjore, nga drejtoria/ sektori juridik i Bashkisë (ligji 139/2015, neni 20/2).
6. Sekretari i Këshillit përcjell pranë sektorit juridik iniciativën qytetare dhe ky sektor duhet të shprehet për bazueshmërinë ligjore të propozimit jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkeses.
7. Iniciativat qytetare prezantohen në mbledhjen e Këshillit nga Kryetari i Këshillit, sëbashke me mendimin e Kryetarit të Bashkisë dhe vlerësim juridik për iniciaitivën të bërë nga drejtori juridike e Bashkisë.

8. Vendimi për iniciatinën nuk merret në mbledhjen e Këshillit Bashkiak ku prezantohet iniciativa për herë të parë, pervec rastit kur me vendim të shumicës së të gjithe Këshilltarëve vleresohet se iniciativa trajton një rast emergjent.
9. Miratimi i iniciativës qytetare bëhet me votimin PRO të shumicës së të gjithe Këshilltarëve Bashkiakë.

KREU IX.

Kërkesat, Ankesës dhe Vërejtjet

Neni 118

E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes

Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë Bashkësinë kanë të drejtë t'i drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje Këshillit Bashkiak për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e Këshillit dhe Ekzekutivit të Bashkisë. (ligji 139, neni 19/1)

Neni 119

Administrimi i kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve

1. Këshilli është i detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj (ligji 139, neni 19/2)
2. Sekretari i Këshillit regjistron kërkesat, ankesat dhe vërejtjet drejtuar Këshillit dhe ja pëcjell Kryetarit të Këshillit i cili vendos nëse ato i duhen përcjellë fillimisht Kryetarit të Bashkisë apo Komisioneve të Këshillit.
3. Përgjigjet e kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve drejtur Këshillit firmosen nga Kryetari i Këshillit ose nga Sekretari i Keshillit me pelqimin paraprap te Kryetarit.

Neni 120

Procedurat për shqyrtimin e ankesave

1. Nëse procesit të konsultimi publik të projekt akteve të depozituara pranë Këshillit Bashkiak për shqyrtim e miratim, palët e interesuara vlerësojnë se Këshilli Bashkiak ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 146/2014, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të po këtij ligji, mund të ankohen pranë Kryetarit të Këshillit Bashkiak, kur projektakti nuk është miratuar ende.
2. Kryetari i Këshillit Bashkiak, me marrjen e ankesës, merr masa të menjëhershme për korrigjimin dhe reflektimin e vërejtjeve të paraqitura në ankesën e palës së interesuar. Në çdo rast, Kryetari i Këshillit Bashkiak njofton palën e interesuar për masat e marra dhe e fton të japë komentet dhe rekomandimet për projektaktin.

65

Neni 121

Rastet e masave disiplinore ndaj keshilltareve

1. Kur këshilltari nuk respekton kohën e diskutimit, ndërhyn gjatë kohës që flet një këshilltar tjetër ose Kryetari i Bashkisë, apo diskuton jashtë temës, i tërhiqet vëmendja nga Kryetari i Këshillit.
2. Kur këshilltari e përsërit shkeljen në të njëjtën mbledhje, pasi i është tërhequr një herë më parë vëmendja, i jepet vërejtje nga Kryetari i Këshillit. Vërejtja regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes.
3. Keshilltarit, i cili përdor fjalë jashtë etike, apo pengon me sjelljen e tij zhvillimin normal të mbledhjes, i jepet vërejtje nga Kryetari i Këshillit.
4. Kur këshilltari e përsërit veprimin, drejtuesi i seancës urdhëron dhe i kërkon që të dalë jashtë salle.
5. Në rast se këshilltari nuk pranon të dalë nga salla, drejtuesi i seancës e ndërpret mbledhjen dhe i jep porositë e nevojshme shërbimit të sigurisë në Këshill për zbatimin e urdhrit të dhënë.
6. Në rast se shprehjet ose fyerjet e bëra nga këshilltari në mbledhje tërhiqen prej tij në po të njëjtën mbledhje dhe këshilltari kërkon publikisht ndjesë për sjelljen e tij, masa disiplinore e dhënë anullohet nga drejtuesi i seancës.
7. Kur këshilltari pengon zhvillimin e rregullt të mbledhjes, nëpërmjet moslejimit të këshilltarit të rradhës të marrë fjalën, për më shumë se 2 minuta, atëherë Kryetari e paralajmëron për marrjen e masës së përjashtimit në rast vazhdimi.
8. Në rast se këshilltari vazhdon të mos lejojë këshilltarin të vazhdojë fjalën edhe pas paralajmërimit, për më shumë se një minutë, përjashtohet nga pjesmarrja në atë mbledhje.
9. Kur këshilltari bën thirrje për përdorim dhune, provokon rrëmujë në mbledhje gjë që pengon zhvillimin e saj të rregullt, fyen ose kërcënon këshilltarët e tjerë, anëtarët e administratës, ose përdor fjalë fyese për Kryetarin e Bashkisë, me urdhër të drejtuesit të seancës përjashtohet nga seanca për atë ditë si dhe kërkohet të ndalohet të marrë pjesë në mbledhjen e rradhës së Këshillit.
10. Ndalimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e rradhës vendoset nga Kryesia e Këshillit me propozimin e Kryetarit ose propozimit me shkrim të jo më pak se 5 këshilltarëve. Mbledhja e Kryesisë zhvillohet brenda 48 orëve dhe këshilltari, ndaj të cilit kërkohet marrja e masës disiplinore, ka të drejtë të marrë pjesë në të për të paraqitur qëndrimin e tij.
11. Për ngjarje tepër të rënda që ndodhin jashtë saliës ku zhvillohen punimet e mbledhjes, por brenda mjediseve të godinës, procedohet si në piken 10 të këtij neni.

12. Çdo Këshilltar që largohet pa leje nga salla e Këshillit gjatë mbajtjes së një Mbledhjeje Zyrtare të Këshillit dhe kur kjo shkakton pezullim e mbledhjes apo të votimit, ai gjobitet me dymijë (2000) lekë, përveç rastit kur Kryesuesi lejon largimin. Masa e gjobës deklarohet nga Kryesuesi në atë mbledhje të Këshillit ku ajo jepet dhe regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes. Leja për t'u larguar nga sallae mbledhjes së Këshillit i kërkohet Kryesuesit në sesion të hapur të Këshillit, pasi arsyeja të jetë bërë e njohur. Shuma e gjithë gjobave zbritet nga shpërblimi e Këshilltarit, nga borderoja e muajit pasardhës.

13. Këshilltari që thotë fjalë të pahijshme, kapërcen standardet e mirësjelljes dhe etikës gjatë fjalës së tij, pengon me sjelljen e tij zhvillimin e diskutimeve apo cënon rregullin e mbledhjes, i hiqet vërejtje nga kryesuesi i mbledhjes.

14. Kur këshilltari fyen një këshilltar tjetër gjatë mbledhjes, veç sanksioneve të tjera të parashtruara në këtë rregullore, kryesuesi i mbledhjes mund ta gjobisë atë në një masë që shkon deri në heqjen e honorarit mujor. Kjo shënohet në proçesverbalin e mbledhjes dhe bëhet e mundshme për ekzekutim nëse miratohet në atë moment me votim të hapur nga kryesia e Këshillit.

Neni 122

Përgjegjësia ligjore e Këshilltarit

1. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve nga secili Këshilltarët, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si Këshilltarë mund të rezultojë që ai/ajo të jetë përgjegjës personalisht për dëmet që nuk do të mbuloheshin nga sigurimi i Bashkia.
2. Këshilltarët marrin pjesë në trajnime për menaxhimin e rrezikut për të zvogëluar përgjegjësinë për shkak të veprimeve të ndërmarra.

KREU X

AKTET E KËSHILLIT

Neni 123

Vlefshmëria e Akteve

Një akt i Këshillit quhet i vlefshëm nëse ai është miratuar në një Mbledhje Zyrtare, ku është shqyrtuar dhe votuar sipas proçedurave ligjore, kësaj rregulloreje të Këshillit Bashkiak dhe është i regjistruar në Proçesverbalin e Mbledhjes pa të cilin ai nuk sjell asnjë pasojë juridike (ligji 44/2015 KPA, neni 98/5), procesverbal i firmosur nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit të Mbledhjes dhe Sekretari, është zbardhur, shpallur dhe ka hyrë në fuqi në përputhje me ligjin dhe këtë rregullore të Këshillit Bashkiak.

Neni 124

Shpallja dhe hyrja në fuqi e akteve

1. Aktet e Këshillit shpallen brenda 10 ditëve *(Këshilli mund të përcaktojë më pak se 10)* nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to (ligji 139/2015 neni 55/6.
2. Shpalljen dhe publikimin e akteve të Këshillit bëhet Sekretari me ndihmën e specialistit të Sekretariatit. (ligji 139/2015, neni 57/2/ç).
3. Në rast Mbledhjeje Emergjence, ku merren vendime për veprim në situata emergjente si fatkeqësi natyrore, mungesë në masë të madhe të rendit dhe qetësisë publike në komunitet, apo raste të tjera të specifikuara me ligj, sipas specifikimit të bërë në tekstin e vendimit të Këshillit, aktete Këshillit shpallet në këndin e njoftimeve të ndodhur jashtë godinës së Bashkisë dhe në media audiovizive vendore, dhe hyjnë në fuqi menjëherë.

Neni 125

Dergimi i akteve të miratura tek Prefekti

Këshilli nëpermjet Sekretarit, brenda 10 ditëve (Këshilli mund të vendosi më pak ditë) nga data e shpalljes së akteve, depoziton në regjistrin e zyrën së Prefektit të gjitha aktet me karakter normative të nxjerra nga Këshilli për arsye të verifikim nga ana e Prefektit të ligjshmërisë së akteve (ligji 107/2016 "Per Prefektin", neni 16/b).Në çdo rast aktet dorezohen dorazisht nga specialisti i arkiv/protokollit të Sekrtariatit tek zyra e Protokollit e Prefektit nga ku merr konfrimimin për dorezimine akteve.

Neni 126

Anullimi shfuqizimi apo ndryshimi i akteve

1. Këshilli Bashkiak mund të anulojë apo shfuqizojë një aktit te nxjerrë prej Tij, duke ndërprerë fuqinë juridike të akteve të anulluara apo shfuqizuara. Anulimi i një akti ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen.
2. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.
3. Propozimi për anulimi dhe shfuqizimin e pjesshëm apo të tërësishëm të një akti të Këshillit, e propozon Kryetari i Bashkisë, Kryesia e Këshillit, një Grup Politik Këshilltarësh, një numër jo me pak së 5 Këshilltarë, çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të Bashkisë. Propozimi, kur nuk paraqitet nga Kryetari i

Bashkisë, i përcillet Kryetarit të Bashkisë, nëpërmjet Kryetari të Këshillit, për tu shprehur me sqarime për pasojat juridike dhe financiare të ndryshimit të propozuar. Sqarimet e Kryetarit të Bashkisë i paraqiten Komisionit të Këshillit dhe mbledhjes së Këshillit nga punonjesit e autorizuar të Bashkisë.

Neni 126

Salla e mbledhjeve të Këshillit dhe pjesët e rezervuara

1. Mbledhjet e Këshillit Bashkiak zhvillohen në sallën e Këshillit Bashkiak, në të cilën janë rezervuar hapësirat për Kryetarin dhe Kryesinë e Këshillit, Grupet Politike të Këshilltarëve, , Kryetarin dhe Administratën e Bashkisë, publikun dhe organet e informacionit publik.
2. Salla e Mbledhjes përbëhet nga mjedisi ku rrinë Këshilltarët, Kryetari dhe Administrata e Bashkisë, dhe mjedisi ky rri publiku dhe media.
3. Kryetari i Këshillit, Zv/kryetari dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak vendosen në një tavolinë përballë Këshillit. Kryetari i Bashkise vendoset në një tavolinë më vete, së bashku me zëvendësit e tij. Administrata e Bashkisë vendoset pas Këshilltarëve.
4. Asnjë person i huaj nuk mund të qëndrojë në pjesën e sallës të rezervuar për Këshillin, me përjashtim të punonjësve të shërbimit.
5. Përfaqësuesit e mediave qëndrojnë në zonën e rezervuar për ta dhe nuk u lejohen që gjatë zhvillimit të Mbledhjes së Këshillit ato të vendosen para tyre dhe ndërmjet Këshilltarëve.
6. Diten që zhvillohet Mbledhja e Këshillit Bashkiak dhe për gjithë kohën e zhvillimit të saj jashtë ndërtesës ku është salla e Këshillit ku dhe ku zhvillohet mbledhja, vendoset Flamuri Kombëtar dhe Flamuri i Bashkisë.
7. Këshilltarët, Kryetari i Bashkisë dhe të ftuarit nga Administrata e Bashkisë mund të flasin nga vendi ose në foltore.

KREU XI.

Administrimi i mbledhjeve dhe punëve të këshillit

Neni 127

Proçesverbali i Mbledhjes

1. Mbledhjet e Këshillit pasqyrohen në Procesverbalin e Mbledhjes (ligji 139/2015, neni53/8) Këshill Bashkiak përdor sistemin audio për regjsitrimin e Mbledhjes së Këshillit. Regjistrimet Mbledhjes së Këshillit bëhet nga specialisti i ngarkuar nga administrata e bashkisë. Zbardhja e procesverbalit të mbledhjeve bëhet për cdo çështje të rendit të ditës së mbledhjes. Në cdo rast zbardhja e procesverbalit bëhet sipas të drejtës së marrjes së fjalës të dhënë nga Kryetari i Këshillit/ drejtuesi i mbledhjes.

2. Në rast ku nuk është e mundur perdorimi i sistemi audio për regjstrimin e mbledhjes, proçes-verbali i Mbledhjes mbahet nga specialistja e protokollit pranë Sekretariatit dhe në mungesë të saj një person tjetër i caktuar nga stafi i Bashkisë

Neni 128

Procesverbalin i Mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Në proçes verbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak fiksohet:

1. Data e mbajtjes së mbledhjes.
2. Ora e fillimit të mbledhjes.
3. Vendi i mbajtjes së mbledhjes.
4. Lloji i mbledhjes (e rregullt, jashtë radhe, emergjente, vazhduese),
5. E hapur/e mbyllur.
6. Emërtimi dhe ora e fillimit dhe mbarimit të shqyrtimit të çdo pike të rendit të ditës.
7. Emërtimin e Mocionit- emri i Këshilltarit që prezanton mocionit.
8. Vendimi/et e marra nga Këshilli (shprehja sic eshte cituar nga kryesuesi i mbledhjes).
9. Votat, Pro, Kundra dhe Abstenim, për çdo çështje për të cilën është votuar dhe marrë një vendim.
10. Vendimet për sanksionet e ndërmarra ndaj Këshilltarëve.
11. Firmat e Komisionit të Verifikimit të Procesverbalit të Mbledhjes

Neni 129

Perfshirja ne procesverbal e votave "kunder

1. Çdo Këshilltar mund të kërkojne që të shënohet në proçesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Këshilli.
2. Këshilltarët, të cilët kanë votuar kundër një vendimi dhe kanë kërkuar shënimin e këtij fakti në proçesverbal, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përjashtohen nga çdo përgjegjësi që mund të rrjedhë nga ky vendim.
3. Në rastet kur vendimet do t'i dërgohen një organi më të lartë të administratës, këto vendime do të shoqerohen me deklarimet e votave të Këshilltarëve.
4. Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme/Përkohshme dhe Mikse regjistrohen në proçesverbalin e këtyre mbledhjeve i cili mbahet nga Sekretari i komisionit dhe në mungesë të tij një person tjetër i caktuar nga Komisioni. Në fund të mbledhjes proçesverbali i mbledhjes firmoset nga secili Kryetar/ Kryesuesi i Komisionit të Përhershëm/ Përkohshëm/Miks dhe Sekretari/ person tjetër i caktuar. Çdo Komision ka librin e vet të proçesverbalit.

5. Procesverbali mbahet në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve i cili ka të shkruar në kapakun e tij "Libri i Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkiak Elbasan. Kryetari lejon, me shkresë të firmosur prej tij, përdorimin e një libri të dytë me të njëjtat specifika si i pari. Sekretari është përgjegjës për përgatitjen e Librit të Procesverbalit të Mbledhjeve. Çdo Këshill i ri fillon një libër të ri për mbajtjen e procesverbalit.
6. Administrimi i dokumentacionit të çdo mbledhjeje zyrtare të Këshillit bëhet nga specialisti i sekretariatit.
7. I gjithë dokumentacioni që i paraqitet për shqyrtim Këshillit me regjistrimet video dhe/apo audio të për çdo mbledhje të Këshillit dorëzohen, brenda 5 ditësh nga përfundimi i mbledhjes së bashku me dosjen përkatëse të ndara në dosje të veçanta për çdo pikë të rendit të ditës me procesverbalet përkatëse me shkrim dore dhe të zbardhura. Dorëzimi bëhet në zyrën e arshivës së Bashkisë nëpërmjet një shkrese zyrtare nga specialistja e protokollit duke marrë me shkrim dokumentin dorëzues me nr protokolli,datë dhe firmë.

KREU XII

Marredheniet e Këshillit Bashkiak me të tretët me Kryetarin dhe administratën e Bashkisë

Neni 130
Kryetari i Bashkisë

1. Merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për Këshillin Bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga Këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë. Gjatë punës përgatitore për përgatitjen e materialeve, cdo këshilltar ka të drejtën e informimit mbi procedurat e ndjekura.
2. Raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësive administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga Këshilli.
3. Raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e Bashkisë. Gjatë raportimit, nëse e gjykon të nevojshme, Këshilli mund të thërrasë dhe punonjës të administratës.
4. Kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesa të Bashkësisë. Në cdo rast, kryetari i bashkisë argumenton me shkrim kthimin për rishqyrtim të vendimeve të Këshillit. Këshilli Bashkiak mund të vendosë zhvillimin e një mledhjeje me debat për cështjen. Në rastin e kthimit të vendimit të Këshillit nga Kryetari i Bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve.
5. Me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisë detyrohet të raportojë për cështje të vecanta, përveç atyre të parashikuara në ligj. Në fillim të raportimit, Këshilli Bashkiak vendos për mënyrën e zhvillimit të mbledhjes, me debat ose jo, kohën e debatit, ndarjen e kohës për grupet politike të këshilltarëve. Gjatë këtyre mbledhjeve, me

kërkesë të Kryetarit të Bashkisë apo dhe të këshilltarëve bashkiakë, mund të marrin pjesë dhe të raportojnë dhe punonjësit e administratës së Bashkisë.

6. Kur një Këshilltar/ë ka pyetje për Kryetarin e Bashkisë, përgjigjet e të cilave kërkojnë të dhëna dhe informacion paraprake, ato i dërgohen me shkrim Sekretarit i cili më pas ai dërgon Kryetarit jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune para mbledhjes ku do t'i jepet përgjigje pyetjeve, në të kundërt Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të kërkojë kohë për përgjigjet, por jo më shumë se mbledhja tjetër e radhës e Këshillit. Sekretari përfshin në rendin e ditës, si pikë më vete, sesionin e përgjigjeve të Kryetarit të Bashkisë.
7. Këshilltari që drejton pyetjet për Kryetarin e Bashkisë ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim apo me gojë, gjë të cilën e specifikon në kërkesën e paraqitur. Para se Kryetari i Bashkisë t'i përgjigjet pyetjeve, Këshilltari që ka bërë pyetjet ka të drejtë të shpjegojë arsyet pse i ka bërë pyetjet. Kryetari i Bashkisë nuk ka detyrim t'i përgjigjet pyetjeve, pavarësisht se kjo është futur në rendin e ditës, nëse Këshilltari/ët nuk është/ janë i/të pranishëm.
8. Gjatë seancës së përgjigjes së pyetjeve nga Kryetari i Bashkisë, Kryesuesi nuk lejon debat. Mbas dhënies së përgjigjeve Këshilltari që ka bërë pyetjet ka të drejtën e replikës dhe vlerësimin e përgjigjeve, gjë e cila nuk zgjat më shumë se dy (2) minuta.
9. Në rastet kur në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit janë çeshtje apo projekt vendimeve për: miratimin e buxhetit e të paketës fiskale të Bashkisë, për shit-blerje apo dhënje me qera te pronave, miratim të planeve strategjike të bashkisë etj , çeshtje te instalimit te biznese të medha me ndikim në Bashki, çeshtje të menaxhimit të territorit Këshilli pranon shqyrtimin e këtyre çeshtjeve apo projekt vendimeve vetëm nëse ato prezantohen nga Kryetari i Bashkisë, në të kundërt shqyrtimi i çeshtjeve apo projekt vendimeve shtyhet për mbledhjen tjetër. Këshilli shqyrton çeshtjet e mësipërme në mbledhjen e ardhshme të rregullt edhe pa praninë e Kryetarit, dhe në këtë rast projekt propozimi mbrohet nga ekzekutivi përkatës i hierarkisë më të lartë.
10. Në rastet kur Kryetari i Bashkisë kthen për rishqyrtim në mbledhjen e Këshillit vendimet e Këshillit, pasi vëren se ato cenojnë interesa të bashkësisë, Këshilli rishqyrton vendimin në mbledhjen e parë pas paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Bashkisë
11. Kryetari i Bashkisë depoziton nëpërmjet arshivës tek Sekretari i Këshilli jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes, materialet e Këshillit dhe sipas rendit të ditës, projektvendimet, relacionet dhe dokumentacionin shoqërues.
12. Kryetari Bashkisë paraqet çdo vit një raport me shkrim për Këshillin duke pasqyruar veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet Këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës. (ligji 139/2015, neni 44). Këshilli Bashkiak e merr në shqyrtim raportin e paraqitur nga Kryetari jo me vonë së data 30 Prill.
13. Kryetari i Bashkisë thërret për pjesëmarrje dhe ballafaqim në Këshillin Bashkiak drejtorët dhe drejtuesit e njësive administrative për të dhënë shpjegime teknike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit.

Neni 131

Takimet e Këshillit me Kryetarin e Bashkisë

Këshilli mbanë takime strategjike e këshilluese me Kryetarin e Bashkisë disa herë herë ne vit në lidhje me:

1. Politikat e zhvillimit të Bashkisë dhe çështjet financiare e të buxhetit., dhe kryesisht për:
   a. prioritetet strategjike të zhvillimit të Bashkisë dhe të zhvillimit eknomik
   b. politikën fiskale vendore
   c. programin buxhetor afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor
   d. huamarrjen vendore
   e. përdorimin dhe përfitimin e pronave bashkiake
   f. qëndrueshmërinë e sistemit të menaxhimit financiar të bashkisë
2. Çështje të marrëdhënieve të Këshillit më Kryetarin dhe Administraten e Bashkisë
3. Çështje të zbatimi të akteve dhe vendimeve të Këshillit
4. Çështje të cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike
5. Çështje të tjera në interes të Bashkisë dhe të bashkëpunimin mes Këshillit dhe Ekzekutivit të Bashkisë.
6. Në këto takimi marrin pjesë Kryetari i Këshillit, zëvendëskryetarët e Këshillit, Sekretari i Këshillit dhe dy kryetarët e Grupeve më të mëdha Politike të Këshilltarëve, dhe sipas rastit Kryetarët e Komisioneve të Përhershme të Këshillit të cilët ftohen në takim nga Kryetari i Këshillit.
7. Këshilli, nëpërmjet Sekretarit, depoziton me shkrim pranë zyrës së Kryetarit të Bashkisë çështjet për diskutim që propozon Këshilli, jo më vonë së 5 ditë nga data e takimit.

Neni 132

Llogaridhënia e Kryetari të Bashkisë

1. Këshilli dhe çdo Komision i Përhershëm ka të drejtë të therrasë Kryetarin e Bashkisë dhe ti drejtojë pyetje Kryetari apo punonjësit të Bashkisë të autorizua prej Tij, si dhe drejtuesve të institucioneve/ ndërmarrjeve/agjecive në varësi të Bashksisë për çeshtje që kanë të bëjnë me strategjitë, vendimet apo veprimiet e tyre, pyetje të cilat i drejtohen në Mbledhjen e Këshillit apo të Komisioneve të Përhershëm.
2. Kryetari raporton një herë në vit përpara Këshillit, në muajin Tetor, për situatën social ekonomike të Bashkisë si dhe për zbatimit të vendimeve të Këshillit për të cilat ai/ajo dhe ekzekutivi i Bashkisë dhe institucionet/ndërmarrjet/agjencitë në varesi të Bashksië janë përgjegjës. Formati i këtij raporti diskutohet me Kryetarin e Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Neni 133

Marrëdhëniet me administratën e Bashkisë

1. Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë, nga administrata e Bashkisë apo njësitë administrative, çdo dokumentacion i lidhur me Bashkinë dhe njësinë administrative.
2. Në bashkëpunim me koordinatorin e Bashkisë për njoftimin dhe konsultimin publik, Sekretari i Këshillit organizon dhe bashkërendon punën për konsultimin publik, njoftimet apo dëgjesat publike me qytetarët.
3. Këshilli mbanë takime këshillimore më drejtorë e drejtorive të Bashkisë.
4. Këshilltarët mbajnë seanca sqaruese me menaxheret e lartë të Drejtorive të Bashkisë për ankesat e komunitetit, problemet me zbatimin e politikave.
5. Këshilltarë mbajnë seanca sqaruese me Administratorët e NjA për nevojat kërkesat dhe ankesat e komunitetit, problemet me zbatimin e politikave.
6. Drejtori i Drejtorise juridike të Bashkisë është i detyruar të jetë prezent në mbledhjen e Këshillit dhe të japë shpjegime juridike për çështjet që shqyrton Këshilli, përsa kohë Këshilli nuk vendos ndryshe.

Marrëdhëniet me Autoritetet jashë Bashkisë

Neni 134

Marrëdhëniet me institucioneve të qeverisjes qendrore

Marrëdhëniet ndërmjet Këshillit Bashkiak dhe institucioneve të qeverisjes qendrore bazohen në parimet e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta (ligji 139/2015, neni 10).

Neni 135

Komunikimi dhe informimi i Këshillit me organevet e qeverisjes qendrore

Këshillit Bashkiak, për fushën e tyre të përgjegjësisë, informon me shkrim organet e qeverisjes qendrore për çdo çështje që u kërkohet informacion. Organet e qeverisjes qendrore, kur kërkohet Këshillit Bashkiak, japin informacion, sipas afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi (ligji 139/2015, neni 11).

Neni 136

Marrëdhënjet me Deputete e Qarkut

1. Deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe analizat që organizohen nga Këshilli (ligji nr. 8550, datë 18.11.1999 "Per Statusin e Deputetit", neni 6 pika 1).
   Sekretari në fillim të çdo muaji i vënë dispozicion deputetëve të qarkut, pranë zyrave të tyre, kalendarin e mbledhjeve, duke përfshirë ndryshimet e mundshme që mund t'i bëhen atij (ligji nr. 8550 /1999, neni 6 pika 2).
2. Kryetari dhe Sekretari i Këshilliti i sigurojnë deputetëve të Qarkut të gjitha shpjegime dhe informacionet për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së deputetit dhe janë të detyruar t'i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës në zyrën e protokollit të Bashkisë (ligji nr. 8550 /1999, neni 8).
3. Kryetari dhe Sekretari i Këshilliti i sigurojnë deputetit pjesëmarrje në mbledhjet kur në to shqyrtohen probleme të ngritura prej deputetit dhe që lidhen me Qarkun ku deputeti është zgjedhur
4. Këshilli është i detyruat të marrë në shqyrtim kërkesat, ankesat dhe propozimet e bëra nga zgjedhësit, të cilat i paraqiten atyre nëpërmjet deputetit. Këshilli, brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së tyre, detyrohen të njoftojnë deputetin për mënyrën e trajtimit apo zgjidhjes së tyre. (ligji nr. 8550 /1999, neni 10).
5. Këshilli është i detyruar të shqyrtojnë në mbledhjen e tij më të afërt të radhës propozimin me shkrim të bërë nga Deputetit për rishikimin ose shfuqizimin e një akt normativ të miratuar nga Këshilli, e të cilin Deputeti e gjykon se është i është i kontestueshëm. Në këtë rast Këshilli brenda 15 ditëve nga data e mbledhjes që shqyrton propozimne Deputetit, e njofton atë me shkrim për përfundimin e shqyrtimit. Njoftimi i dërgohet nga Sekretari në adresën që citohen në shkresën e dërguat nga Deputeti (ligji nr. 8550 /1999, neni 11).

Neni 137

Marrëdhënjet me Prefektin e Qarkut

1. Këshilli, nëpërmjet Sekretariatit i mundëson Prefektit të Qarkut verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normative. Specialisti i Sekretariatit të Këshillit depoziton me regjistrim në zyrën e protokollit te Prefektit të Qarkut të gjitha aktet me karakter normative të miratuara nga Këshilli, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre (Ligji nr. 107/2016 "Për prefektin", nenei 16/2/a)

2. Këshilli, nëpërmjet Sekretarit, i mundëson Prefektit të Qarkut, apo të dërguarit të tij, verifikimin në zyrat e Bashkisë të ligjshmërisë së akteve **me karakter normativ**, (Ligji nr. 107/2016, neni 16), jo më vonë se dy ditë nga marrja e njoftim me shkrim nga Prefekti, për verifikim.

3. Në rastet kur Prefekti është shprehur me shkresë për papajtushmëri ligjore të akteve të Këshillit, Sekretari njofton brenda ditës dhe në pamundesi jo më vonë se brenda dy ditëve

Kryetarin e Këshillit, Kryetarin e Bashkisë, agjencinë e cila është ngarkuar për zbatimin e aktit. Këshill jo më vonë se në mbledhjen e radhës shqyrton kërkesën e Prefektit për rishqyrtimin e aktit dhe shprehet me vendim.

4. Këshilli mund të thërrasë një mbledhje jashtë radhe për të shqyrtuar shprehjen e papajtushmëri ligjore të aktit të Këshillit, nëse kjo kërkohet nga Kryetari i Bashkisë apo vendoset nga Konferenca e Kryetarëve, kjo e fundit e thirruar nga Kryetari i Këshillit.

5. Kryetari i Këshilli mund ti kërkojë Prefekit takim këshillues mes juristit të Këshillit dhe drejtusit të sektorit juridik të Prefektit në lidhje me bazueshmërinë ligjore të një projektakti që është depozituar për shqyrtim në Këshill për te parandaluar shprehje e papajtushmërinë ligjore të Prefektit.

Neni 138

Marredheniet me KQZ

Në rastin e mbarimit të mandatit të një Këshilltari, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit 139/2015 Kryetari ose Sekretari i Këshillit njofton KQZ me shkresë zyrtare, vendin vakant dhe emrin e personit të larguar si dhe vendimin e Këshillit Bashkiak për mbarimin e mandatit të Këshilltarit.

PJESA II

Kushtet e punës dhe siguria e veprimtarisë së Këshillit

Neni 139

Kushtet e punës për organet e Këshillit Bashkiak

1. Salla e Këshillit Bashkiak ka standarte që mundëson uljen e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë, stafit të Këshillit, stafit të Bashkisë të ftuar, medias dhe publikut. Salla e Këshillit është e pajisur me sistem audioviziv për rregjistrimin e mbledhjes së Këshillit, dhe me monitor elektronik për shpalljen e rezultateve të votimit në Këshill.

2. Kryetari, dhe Sekretari kanë secili një zyrë më vete.

3. Këshilltarëve u sigurohen kushte të mira pune gjatë mbajtjes së Mbledhjes së Këshillit dhe atyre të Komisioneve të Përhershme, ngrohje në dimër dhe kondicionim në verë.

Neni 140

Shërbimi i sigurisë në sallën e mbledhjeve të Këshillit

1. Për të siguruar rendin dhe qetësinë në mjediset e sallës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, funksionon shërbimi i sigurisë, i cili në sallën e zhvillimit mbledhjeve të Këshillit Bashkiak

është i paarmatosur. Shërbimi pajiset me uniformë të veçantë dhe mjete teknike për plotësimin e detyrave të tij. Kryetari i Bashkisë i vë në dispozicion Këshillit Bashkiak 3 punonjës të policisë bashkiake në çdo mbledhje të Këshillit për garantimin e ruajtjes dhe sigurisë në sallën e mbledhjes.

2. Punonjësit e shërbimit të sigurisë veprojnë në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak vetëm me urdhër të Kryetarit të Këshillit ose të drejtuesit të mbledhjes.

3. Shërbimi i sigurisë në sallën e Këshillit Bashkiak ofrohet nga Policia Bashkiake

4. Në çdo raste Kryetari i Këshillit ose drejtuesi i mbledhjes së Këshillit ka të drejtë të njoftojë policinë e Shtetit, nëpërmjet Sekretarit të Këshillit Bashkiak, në rastet kur përsona nga publiku, nga ekzekutivi i Bashkisë apo Këshilltarë bllokojnë dhunshmë punimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak apo përbëjnë rrezik për sigurinë fizike të Këshilltarëve dhe të pranishmve në mbledhje.

PJESA III

KREU XIII.

Zgjedhja e strukturave komunitare

Neni 141
Perpilimi i procedurave

1. Këshilli bashkiak me shumicë votash miraton Rregullorene organizimit e të funksionimit të këshillave komunitarë të lagjeve dhe marrëdhëniet që ato kanë me bashkinë dhe strukturat e saj.

2. Në qytete, në çdo lagje (ligji 139/2015, neni 68/1) krijohet një këshill komunitar. Këshilli bashkiak mund të vendosë që në një lagje të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apo më shumë lagjeve. Ky vendim merret vetëm pas konsultimit përkatës me komunitetin.

3. Me ndihmën e administratës së Bashkisë, organizohen dhe zgjedhjet në çdo lagje për këshillin komunitar. Përpara zgjedhjeve, Këshilli Bashkiak dhe administrata eBbashkisë informon banorët e lagjes për rolin e këshillit komunitar. Rregullorja përkatëse e miratuar nga këshilli, përmban rregulla të hollësishme mbi këshillat komunitarë, ndërlidhësin komunitar, zgjedhjet, organizimin dhe funksionimin e tyre.

4. Këshilli komunitar: vlerëson, rishikon dhe rekomandon një veprim, politikë ose plan të bërë nga Këshilli Bashkiak, Kryetari i Bashkisë, apo çdo agjenci, komision ose bord i Bashkisë, për çdo çështje që ndikojnë komunitetin dhe territorin e lagjes; ndihmon Këshillin dhe Kryetarin e Bashkisë në përcaktimin e nevojave prioritare për lagjen; rishikon buxhetin e

bashksië dhe bë rekomandime në lidhje me zërat e buxhetit që i ndikojnë përmirësimit të jetës në komunitet dhe zhvillimit të territorit të lagjes; si dhe merr përsipër të menaxhojnë projektet siç mund të bien dakord ose të kontraktohen.

Neni 142

Zgjedhja e Kryesise se Fshatrave

1. Zgjedhjet e kryesisë së fshatit bëhen një herë në katër vjet, pas zgjedhjeve për Këshillin Bashkiak dhe jo më vonë se tre muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në rast mosrespektimi të këtij afati, deri në zgjedhjen e kryesisë së fshatit, kryetari i Bashkisë emëron përkohësisht kryetarin e fshatit.

2. Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga Këshilli Bashkiak .

3. Numri i anëtarëve të kryesisë së fshatit përcaktohet nga Këshilli Bashkiak në bazë të numrit të banorëve të fshatit dhe lagjeve përbërëse të tij, pas konsultimit me komunitetin e fshatit.

4. Procesi i zgjedhjes dhe veprimtaria e kryesisë së fshatit mbikëqyren nga Këshilli Bashkiak , përmes një komiteti të ngritur posacërisht që reflekton dhe raportet politike brenda Këshillit.

Neni 143

Struktura te tjera komunitare

1. Këshilli Bashkiak, me vendim, mund të ngrejë dhe struktura të tjera komunitare mbi baza vullnetare si borde, komitete, grupe ekspertësh në dobi të cështjeve të përashkëta të komunitetit.
2. Këshilli Bashkiak mund të vendosë që një pjesë të vendeve të borde apo komitet ti përcaktojë Kryetari i Bashkisë.
3. Anëtarët e bordeve dhe komitete ofrojë këshilla, reagime, propozime dhe vërejtje për çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin shoqërore, ekonomik, mjedisor, kulturore e teknologjik.
4. Këshilli publikon një formular aplikimi per qytetaret qe te aplikojne per anëtare të bordit apo komitetit. Një qytetar apo një përfaqësues i një organizate mund të marrë pjesë vetëm në një bord, komitet, panel brenda nje viti.
5. Sekretari i Këshillit ngren dhe mirëmban regjistrin e emërimeve në bordet dhe komitete të qytetarëve, si dhe verifikon dhe njofton Kryetarin e Keshillit për mbarimit e mandatit të bordit apo komunitetit, apo mandatin e anëtarit të bordit apo komitetit. Sekretari shpall ne faqen e internetiti zyrtare të Këshillit dhe në vendet e tjera të përcaktura për shpallje të njfotimeve të Këshillit, vendet bosh në borde dhe komitetet dhe fton qytetarët të aplikoje per plotësimin e tyre.

6. Çdo bord apo komitet i miratuar nga Këshilli ka ndërfaqen e vete në faqen e internetit zyrtare të Bashkisë. Mbledhjet e bordit, komitetit, paneli jane te hapura për publikun. Njoftimi per mbledhjen dhe rendi i puneve bëhet publik në nderfaqen e internetit të bordit, komitetit, paneli dhe në mbledhjen e bordit, komitetit, panelit merr pjesë sëpaku një anetar i Keshillit, anëtar i komite qe mbulon fushen e aktivitetit të bordie, komitetit.

PJESA IV

RREGULLORJA E KËSHILLIT

Zbatueshmëria, interpretimi dhe ndryshimi i rregullores

Neni 144

Zbatushmëria e Rregullores

1. Kryetari i Këshillit, dhe në mungesë të tij Zëvendëskryetari, është përgjegjës për zbatimit të kësaj rregulloreje gjatë mbajtjes së mbledhjes së Këshillit si dhe për çështjet specifike për të cilat ai është përgjegjës sipas neneve të kësaj rregulloreje.
2. Sekretari i Këshillit mbikëqyr respektimin e rregullores së funksionimit të Këshillit (ligji 139 neni 57 gërma dh) dhe ndërhyn menjëherë pranë Kryetarit të Këshillit kur vëren shkelje të ligjit dhe të rregullores.

Neni 145

Interpretimi i Rregullores

1. Kur ngrihen pretendime gjatë zhvillimit të mbledhjes së Këshillit lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje, është kompetencë e Kryesuesit për të vendosur për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi
2. Kur ngrihen pretendime për interpetimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje gjatë zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve, kryetari i komisionit vendos për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.
3. Për rastet e tjera është kompetencë e Kryetarit ose Sekretarit të Këshillit për të bërë interpretimin e neneve të kësaj Rregulloreje. Kërkesa për interpretim nga ky Këshill mund të bëhet nga çdo Këshilltar.
4. Kryetari i Këshillit, një kryetar Grupi Këshilltarësh, një Komision i Përhershëm ose 10 Këshilltarë mund të kërkojnë që çështja e interpretimit për një rast të veçantë t'i paraqitet Këshillit në mbledhjen e radhes për të marrë vendim.
5. Ne çdo rast një këshilltarë apo nje grup Këshilltarës mund mund ti drejtohen për interpretim të kesaj rregulloreje Komisionit të mandateve dhe Rregullores.

Neni 146

Ndryshimi i Rregullores

Çdo Këshilltar ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në kësaj Rregullore. Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedurart e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e projekt-akteve. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohsen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit.

KREU XVII. Miratimi dhe hyrja në fuqi e Rregullores

Neni 147

Miratimi i Rregullores

Kjo rregullore miratohet pas votimit në Këshillin Bashkiak Elbasan me shumicën e të gjithë anëtareve të T'ij.

Neni 148

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore u miratua në mbledhjen e datës 26.02.2020 me vendim Nr 22 datë 26.02.2020 nga Këshilli Bashkiak Elbasan, dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1003/1 Prot. Datë 02.03.2020

VENDIM

NR. 23 DATË 26.02.2020

MBI

"Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2019"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 26.02.2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **"Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2019",** bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore",

VENDOSI :

1. Të miratoje "Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë të vitit 2019" (janar-dhjetor 2019), për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETARI
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

D.Buxhetit : M.Beluli
D.P.P.A.B.F: Q.Tusha
D.P. Sh. O: E.Kenuti
D.P. Sh. O: B.Çabiri
D.P.Sh..I : S. Mehmeti
Drejt.Juridike: O.Deliallisi
Zv. Kryetari : I.Sina

RAPORTI I MONITORIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2019
(progresiv- 4 Muj.III-të)

BASHKIA ELBASAN

Shkurt 2020

Përmbajtja:

I. Buxheti i Bashkisë për vitin 2019 (periudha janar- dhjetor);

II. Realizimi i të ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për periudhën janar-dhjetor, 2019;

III. Realizimi i buxhetit të 4-mujorit të III-të, (vjetor) 2019;

F1. Funksioni "Shërbime të përgjithshme publike";
F2. Funksioni "Shërbime të huamarrjes vendore";
F3. Funksioni "Rendi dhe siguria publike";
F4. Funksioni "Çështje ekonomike";
F5. Funksioni "Mbrojtja e mjedisit";
F6. Funksioni "Strehimi dhe komoditetet e komunitetit";
F7. Funksioni "Shëndetësia";
F8. Funksioni "Argëtimi, kultura dhe feja";
F9. Funksioni "Arsimi";
F10. Funksioni "Mbrojtja Sociale";

116

I. Buxheti i Bashkisë për vitin 2019.

Detajimi i buxhetit për vitin 2019 është bërë bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", ligjin 99/2018, datë 03.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2018 " si dhe VKB nr. 162, datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkise Elbasan per vitin 2019" dhe nr.26, datë 21.03.2019 "Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve, si dhe transferim fonde në buxhetin e vitit 2019".

Programi Buxhetor i vitit 2019 parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore me qëllim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale; përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; mirëmbajtjen e tregjeve të reja; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit; mbrojtjen e tokave bujqesore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë; mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Zbatimi i Buxhetit të vitit 2019 është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës dhe mbrotjen e mjedisit duke e kthyer Elbasanin në një qendër të përparuar social -ekonomike.

Ky dokument ka përcaktuar 34 programe dhe një seri funksionesh dhe aktivitetesh respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit që i mbështet këto projekte.

Bashkia Elbasan, administron dhe menaxhon fondet, sipas 34 programeve të miratuara, si më poshtë:

1. Programi "Planifikim, Menaxhim & Administrim"
2. Programi "Çështjet financiare dhe fiskale";
3. Programi "Shërbimet e Gjendjes Civile";
4. Programi "Pagesa për shërbimin e borxhit të brëndshëm";
5. Programi "Shërbime të Policisë Vendore";
6. Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile";
7. Programi "Mbeshtetje per zhvillimin ekonomik";
8. Programi "Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi";
9. Programi "Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore…";
10. Programi "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit";
11. Programi "Administrimi i pyjeve dhe kullotave";
12. Programi "Infrastruktura Rrugore Vendore ";

13. Programi "Transporti publik";
14. Programi "Menaxhimi i mbetjeve";
15. Programi "Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve";
16. Programi "Programe te mbrojtjes së mjedisit";
17. Programi "Ndërgjegjësimi mjedisor";
18. Programi "Planifikimi urban vendor";
19. Programi "Strehimi";
20. Programi "Shërbimet publike vendore";
21. Programi "Furnizimi me ujë";
22. Programi "Ndriçim rrugësh";
23. Programi "Shërbimet e kujdesit parësor";
24. Programi "Sport dhe argëtim";
25. Programi "Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore";
26. Programi "Arsimi bazë (përfshirë parashkollor ";
27. Programi "Arsimi mesëm përgjithshëm";
28. Programi "Arsimi mesëm profesional";
29. Programi "Kujdesi social për personat e sëmure & aftësi të kufizuar";
30. Programi "Sigurimi shoqëror (të moshuarit)";
31. Programi "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët";
32. Programi "Strehimi social";
33. Programi "Zgjedhje te pergjithshme dhe vendore";
34. Programi "Fondi rezerve dhe kontigjenca";

Burimet e financimit te buxhetit të Bashkisë për vitin 2019, vijnë nga dy drejtime :

Nga **burimet e veta vendore**, ku perfshihen të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donancione, dhe të ardhura të trashëguara.

Nga **burimet qendrore**, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja (sektoriale), transferuar Bashkisë, transferta të kushtëzuara dhe investime nga FZHSH.

II. Realizimi i te ardhurave te Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2019.

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, te ardhurat te tjera dhe te ardhurat nga funksionet specifike, si sherbimi pyjor, ujitja dhe kullimi, etj. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjatë periudhës janar –gusht 2019, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

118

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efiçencë të aseteve të veta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të proçedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.

Objektivat sipas programit të kryetarit të bashkisë, kryesisht të fokusuara në lehtësimin maksimal fiskal, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave sa më pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpermjet "Zyrave me Një Ndalesë" dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshem të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Politikat për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevoje, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqesore, mundësia e arkëtimit në këste, etj. janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e të ardhurave nga viti në vit.

Këto politika të lehtesive fiskale kundrejt përmirësimit të shërbimit janë shoqëruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes.

Të ardhurat e veta u realizuan në proçes dhe bashkëpunim me gjithë administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i këtij procesi bashkëpunues do mundësojë më tej sigurimin e të ardhurave për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

Problematika në lidhje me planin e të ardhurave qëndron në taksën e infrastrukturës. Planifikimi i të ardhurave nga kjo taksë është bërë duke marre në konsideratë përfundimin e PDv-ve, pas miratimit të të cilave, brenda vitit 2019, pritej fillimi i ndërtimeve të reja, në zbatim të planit të përgjithshëm vendor të qytetit. Pengesat dhe vonesat në hartimin e PDV-ve çuan në mosrealizimin e planit të të ardhurave nga taksa e infrastrrukturës për vitin 2019. Po kështu mungojne të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale, për arsye që nuk varen nga administrata e bashkisë.

III. Kategorizimi i të ardhurave

- Taksat vendore:
  - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
  - Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
  - Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier
  - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
  - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5 milion deri ne 8 milion,

- Taksat e ndara
  - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë,
  - Taksa vjetore e mjeteve të përdorura,
  - Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
  - Të ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale

- Tarifat vendore
  - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
  - Tarifa për ndriçimin publik
  - Tarifa për gjelbrimin
  - Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Elbasan
  - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
  - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
  - Tarifa për zënien e hapësirave publike
  - Tarifa nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.

- Të ardhura të tjera:
  - Të ardhura nga gjoba
  - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e aseteve dhe e shërbimeve etj.

- Të ardhura nga huaja

Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë, për vitin 2019 (në mijë lekë)

Nr.	Të ardhurat nga burimet e veta vendore	Plan 2019	Realizimi janar-dhjetor 2019	Realizimi vjetor %
1	Të ardhurat nga taksat vendore	607,909	302,320	50%
2	Të ardhura nga taksat e ndara	85,600	69,035	81%
3	Te ardhurat nga tarifat vendore	371,043	295,950	80%
4	Te ardhura te tjera	277,829	118,409	43%
5	Te ardhura nga donacionet (jash limiti)	0	15,993	
	TOTALI	**1,342,381**	**801,707**	**60%**

Te ardhurat sipas kategorive per periudhen janar- dhjetor 2019



	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht
Te ardhura	31,357	40,147	60,281	98,668	68,425	68,227	135,140	58,279

shtator	tetor	nentor	dhjetor
53,074	52,021	53,573	66,522



Niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin prill dhe korrik me afrimin e afatit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi, si dhe ndjekjes së masave shtrënguese ndaj subjekteve debitore.
Falë fokusimit për zgjerim të mëtejshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitore, etj., arketimi i të ardhurave ka ardhur në rritje.

Realizimi i të ardhurave për periudhën janar- dhjetor 2019.

Në mijë lekë

Nr	TE ARDHURA	PLAN VJETOR 2019	Fakti janar-dhjetor 2019	Krahasimi ne % me planin vjetor 2019
A	**TE ARDH.VENDORE (I+II+III+IV+V)**	**1,342,381**	**785,714**	**59%**
I	**TAKSA VENDORE**	**607,909**	**302,320**	**50%**
1	Taksa biznesi vogel	235	50	21%
2	Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV	8,575	8,443	98%
3	Taksa mbi ndertesat	189,118	154,373	82%
4	Taksa mbi token bujqesore	30,000	17,900	60%
5	Taksa mbi truallin	27,893	22,720	81%
6	Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	11,513	9,157	80%
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	339,000	88,953	26%
8	Taksa e tabeles	1,575	724	46%
	TAKSAT E NDARA	**85,600**	**69,035**	**81%**
9	Taksa mbi kalimin e pronesise	10,500	5,891	56%
10	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	55,000	60,039	101%
11	Renta minerare	100	3,105	
12	Tatimi mbi te ardhurat personale	20,000	0	0%
II	**TE ARDHURA NGA TARIFAT**	**371,043**	**295,950**	**80%**
1	Tarife per zenien e hapes.publike	58,543	31,751	54%
3	" pastrimi	140,000	142,363	102%
4	" gjelberimi	31,989	27,722	87%
5	" ndricimi	39,976	35,614	89%
6	" reklame	19,000	6,282	33%
7	" veterinare	3,335	1,277	38%
8	" gjuetie	5	0	0%
9	" parkim automjete	17,500	6,890	39%
10	" embleme bashkie	103	114	110%
11	" regjistrimi	39	3	7%
12	" leje, certifikate transporti	1,954	1,899	97%
13	" autorizim tregetim karburanti	3,273	6,120	187%
14	" leshimin e vertetimeve	2,344	2,324	99%
15	" dokumenta ankandi	20	2	10%
16	" autoriz., zgjatje orari ,etj	1,100	265	24%
17	" formulare te pastrehe	32	19	59%
18	" sherbimi karrotresh	320	51	16%
19	" leje perdorimi per objekte biznesi	14,000	701	5%
20	" leje perdorimi per banim	1,890	805	43%
21	" certifikim relievi	800	672	84%
22	" deklarim paraprak	1,000	1,130	113%

122

23	" trajt.fasades ndertesave	1,200	1,278	106%
24	" leje shfrytezimi	100	0	0%
25	" shqyrtim dok.leje ndertimi	1,660	2,140	129%
26	" kantier ndertimi per objekt mbi 4 kat	2,500	6,005	240%
27	" leshimin e dok.nga arkiva	260	165	63%
28	" rrjetin e tubacion.ujrave bardha	5,000	4,395	88%
29	" rrjetin e tubacion.ujrave zeza	2,000	566	28%
30	" sherbimi per rrjetin kabllor	4,000	996	25%
31	" uji pijshem	600	58	9%
32	" autorizim lende djegese	500	0	0%
33	" ndotjes mjedisit	16,000	14,343	90%
III	**TE ARDHURA JO-TATIMORE**	**192,225**	**51,437**	**27%**
1	Qera paisje	43	0	0%
2	Qera objekti	1,366	1,594	117%
3	Qera trualli	105	0	0%
4	Qera trualli (operatore telefonike)	2,311	896	39%
5	Qera toke bujqesore	400	317	79%
6	Gjoba ndertimi	10,000	987	10%
7	Gjoba biznesi	9,000	5,041	56%
8	Te ardhura nga legalizimet	124,000	42,394	34%
9	Te ardhura nga shitja e aseteve (FK)	45,000	0	0%
10	Privatizim banese		208	
IV	**TE ARDHURA INSTITUCIONET**	**72,604**	**50,048**	**69%**
1	**Qendra Ekonomike e Arsimit**	**56,996**	**35,602**	**62%**
	te ardhura nga Cerdhet	11,088	5,896	53%
	te ardhura nga kopeshtet	36,960	20,673	56%
	Te ardhura nga qerate	8,948	9,033	101%
2	**Te ardhura Sport Klubi**	**1,008**	**841**	**83%**
	Qera objekti	1,008	841	83%
3	**Qendra e Artit**	**900**	**1,404**	**156%**
	Te ardhura nga biletat	670	1,124	167%
	Te ardhura okupim salle	230	280	122%
4	**Qendra e Trashegimise Kulturore**	**100**	**75**	**75%**
	Te ardhura Trashegimia Kulturore	100	75	75%
	Te ardhura Biblioteka	0	0	0
5	**Agjensia e Sherbimeve Publike**	**6,100**	**4,703**	**77%**
	Te ardhura sherbimet publike	100	74	74%
	Te ardhura M.Varreza	6,000	4,629	77%
6	**Te ardhura nga Banesat Sociale me Qira**	**7,500**	**7,423**	**99%**
	Te ardhura nga qirate	7,500	7,423	99%
V	**TE ARDHURA FUNKSIONET SPECIFIKE**	**13,000**	**16,924**	**130%**
1	Te ardhura nga Sherbimi Pyjor	10,000	13,694	137%
2	Te ardhura Ujitja dhe Kullimi	3,000	3,230	107%
B	**TE ARDHURA JASHT LIMITIT**		**15,993**	
1	Taksa e akteve dhe pulles (gj.civile agj.tatimor)		627	
2	Grant nga Keshilli I Qarkut		7,430	
3	Donacione		3,906	
4	Demshperblim nga Sigal		4,030	
	TOTALI I TE ARDHURAVE :	**1,342,381**	**801,707**	**60%**

Zërat kryesorë të cilët janë me tejkalim në krahasim me planin vjetor janë të ardhurat nga taksat e ndara, ku përmendim taksën vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura dhe rentën minerare.

Nga tarifat përmëndim : tarifën e pastrimit, autorizim tregëtim karburanti, tarifat vendore për urbanistikën, te ardhurat nga shërbimi pyjor, ujitja dhe kullimi, etj.

Zërat ndikues me mosrealizim të ndjeshëm janë taksa e ndikimit në infrastrukturë, si rezultat i mungesës së PDV-ve, të cilat janë ne fazën e hartimit dhe më pas miratimit të tyre, taksa mbi truallin dhe mbi tokën bujqësore, për arsye të mungesës së informacionit nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën me taksapaguesin, tatimi mbi te ardhurat personale, ligjërisht mblidhet nga qeverisja qendrore dhe kalon për llogari të pushtetit vendor, taksa e tabelës, gjobat e ndërtimit, të ardhurat nga Legalizimet, etj., informacion të cilin e merrni nga tabela e mësipërme.

III. Realizimi i buxhetit për 4-mujorin e III-të të vitit 2019 (vjetor).

Realizimi i buxhetit të 4-mujorit të III-të 2019 është bërë duke respektuar ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar , Udhëzimin Plotësues i Ministrise se Financave Nr. 1, datë 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", ligjin 99/2018, datë 03.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", si dhe VKB nr. 162, datë 24.12.2018 "Për miratimin e buxhetit të Bashkise Elbasan per vitin 2019" dhe VKB nr.26, datë 21.03.2019 "Shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe e shpenzimeve në buxhetin e vitit 2019".

Shpenzimet e buxhetit për periudhen janar- dhjetor 2019, nga te gjitha burimet e financimit, arritën në 3 775 601 mijë lekë, me një nivel realizimi prej 81 %.

Realizimi i buxhetit sipas programeve buxhetore :

000/lekë

Nr Prog.	PROGRAMI	Plan vjetor 2019	Fakt vjetor 2019	Realizim 8 MUJ. ne %
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	418,932	357,009	85%
01120	Çështjet financiare dhe fiskale	78,350	73,332	94%
01170	Shërbimi i gjendjes civile	18,618	17,519	94%
01710	Shërbimi i borxhit	121,098	104,806	87%
03140	Shërbime të Policisë Vendore	31,212	26,445	85%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	47,393	37,023	78%
04130	Mbeshtetje per zhvillimin ekonomik	1,676	1,628	97%

04160	Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	7,177	0	0%
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi,sig.ushqimore	19,360	11,996	62%
04240	Menaxhimi infrastrukturës ujitjes dhe kullimit	162,867	132,253	81%
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	52,799	28,242	53%
04520	Infrastruktura rrugore vendore	541,937	203,624	38%
04570	Transporti Publik	37,900	27,296	72%
05100	Menaxhimi I mbetjeve	126,708	108,746	86%
05200	Menaxhimi i ujrave të zeza	21,422	17,769	83%
05320	Programe te mbrojtjes se mjedisit	1,382	1,097	79%
06140	Planifikimi Urban Vendor	204	202	99%
06190	Strehimi	8,152	8,044	99%
06220	Infrastruktura rajonale vendore	132,513	132,513	100%
06260	Sherbime publike vendore	270,851	195,903	72%
06330	Furnizimi me uje	4,022	0	0%
06440	Ndriçim rrugësh	117,302	101,897	87%
07220	Sherbimet e kujdesit paresor	3,151	2,873	91%
08130	Sport dhe argetim	52,568	48,354	92%
08220	Eventet artistike dhe kulturore	114,745	70,892	62%
08230	Projekte Kulturore	1,000	0	0%
09120	Arsimi baze&parashkollor	520,629	391,080	75%
09230	Arsimi i mesem pergjithshem + konvikte	103,686	67,564	65%
09240	Arsimi mesem profesional	30,660	28,199	92%
10140	Kujdesi social per personat e semure dhe PAK	3,400	2,713	80%
10220	Sigurimi Shoqeror	12,034	9,453	78%
10430	Kujdesi social per familje dhe femije	1,565,793	1,552,639	99%
10661	Strehimi social	6,530	5,405	83%
10910	Emergjenca Civile	3,066	3,066	100%
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	6,271	6,019	96%
04980	Fondi rezerve & Kontigjenca	10,100	0	0%
			0	
	TOTALI	**4,655,508**	**3,775,601**	**81%**

Realizimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik.

Në mijë lekë

Emertimi	Plan Vjetor 2019	Fakt Vjetor 2019	Realizimi (vjetor) ne %
Paga dhe Sigurime (600-601)	1,035,977	981,148	95 %
Shpenz.Operative (602-651-166)	844,278	613,743	73 %
Transferta (604-606-609)	1,603,640	1,556,387	97 %
Investime	1,171,613	624,323	53 %
Totali :	**4,655,508**	**3,775,601**	**81%**



Peshën më të madhe të realizimit në përqindje e zënë transfertat në masën 97 % ku përfshihen ndihmat ekonomike, pagesa e personave me aftësi ndryshe, financuar këto nga transferta e kushtëzuar, si dhe raste të përdorimit të fondit të veçantë, në vlera të papërfillshme duke e krahasuar me totalin e transfertave.

Një zë i rëndësishëm jane shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime), të cilat janë realizuar në masën 95 %, ku përveç pagave të administratës bëjnë pjesë edhe pagat e punonjësve të arsimit parashkollor (edukatoret e kopeshteve), punonjësit e konvikteve, punonjësit mbështetës të arsimit parashkollor dhe të mesëm, shërbimi zjarrfikës, e të tjera, sipas funksioneve të cilat iu deleguan Bashkive pas reformës territoriale.

Bazuar në shpenzimet faktike të katërmujorit të tretë (progresive, vjetor 2019):

Shpenzimet për paga zënë 26 % të totalit te shpenzimeve dhe jane realizuar 60 % me burim financimi transferten e pakushtezuar dhe e ardhurat e veta, 37 % me transferte specifike dhe 3% me transfertë të kushtëzuar.

Shpenzimet operative zene 16 % te totalit te shpenzimeve dhe jane realizuar 93 % me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta dhe 5% me transfertë specifike, 1,7% me transfertë të kushtëzuar dhe fondet jasht limiti (donacione, financim i Këshilli të Qarkut) zënë me pak se 0,5 % të totalit.

Shpenzimet për transferime zënë 41 % të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 2 % me transfertë të pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta dhe 98 % me burim financimi transfertën e kushtëzuar.

Shpenzimet për investime zënë 17 % të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 55 % me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta dhe 45 % me transfertë të kushtëzuar (FZHSH). Ndërsa investimet nga transferta specifike dhe fondet jasht limiti, (donacione, financim i Këshilli të Qarkut), fakt zënë një përqindje të papërfillshme të totalit.



Realizimi I shpenzimeve për 4 -Mujorin III-të 2019 (nga të gjitha burimet e fondeve)

ne mije leke

0	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta		Shpenzime Kapitale		Total buxheti	
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Planifikim, Menax. & Admin.	01110	256,032	254,992	102,767	67,866	29,447	13,990	30,686	20,161	418,932	357,009
2	Çështjet financiare dhe fiskale	01120	70,850	69,100	7,500	4,232	0	0	0	0	78,350	73,332
3	Shërbimi i borxhit	01710	0	0	121,098	104,806	0	0	0	0	121,098	104,806
4	Shërbime të Policisë Vendore	03140	29,194	24,591	1,988	1,824	30	30	0	0	31,212	26,445
5	Mbrojtja nga zjarri dhe mb.civile	03280	28,444	28,328	4,516	4,453	13,221	4,118	1,212	124	47,393	37,023
6	Shërbimi i tregjeve.akred.inspek.	04160	0	0	0	0	0	0	7,177	0	7,177	0
7	Shërbimet bujq., inspekt,sig.ushq	04220	0	0	0	0	0	0	19,360	11,996	19,360	11,996
8	Menaxhimi infr.Ujitjes& Kullimit	04240	11,350	8,379	12,923	12,029	0	0	138,594	111,845	162,867	132,253
9	Administrimi i pyjeve +kullotave	04260	25,411	20,791	20,713	776	40	40	6,635	6,635	52,799	28,242
10	Infrastruktura rrugore vendore	04520	49,778	47,377	23,631	16,047	5,952	192	462,576	140,008	541,937	203,624
11	Transporti Publik	04570	18,570	18,544	19,330	8,752	0	0	0	0	37,900	27,296
12	Menaxhimi I mbetjeve	05100	9,857	8,600	111,151	94,446	0	0	5,700	5,700	126,708	108,746
13	Menaxhimi i ujrave të zeza	05200	0	0	0	0	0	0	21,422	17,769	21,422	17,769
14	Programe te mbrojtjes se mjedisit	05320	0	0	1,282	1,097	0	0	100	0	1,382	1,097
15	Planifikimi Urban Vendor	06140	0	0	0	0	0	0	204	202	204	202
16	Sherbime publike vendore	06260	47,750	41,805	98,470	55,019	180	180	124,451	98,899	270,851	195,903
17	Furnizimi me uje	06330	0	0	0	0	0	0	4,022	0	4,022	0
18	Ndriçim rrugësh	06440	4,930	4,902	95,969	88,204	0	0	16,403	8,791	117,302	101,897
19	Sherbimet e kujdesit paresor	07220	560	395	300	188	0	0	2,291	2,290	3,151	2,873
20	Sport dhe argetim	08130	26,795	25,739	20,118	16,970	5,605	5,595	50	50	52,568	48,354
21	Trasheg.kult.eventet artist.&kult.	08220	43,363	41,838	31,255	23,496	247	247	39,880	5,311	114,745	70,892
22	Arsimi baze&parashkollor	09120	291,507	269,941	102,101	64,295	390	330	126,631	56,514	520,629	391,080
23	Arsimi mesem pergj. + konvikte	09230	43,064	39,976	34,070	26,856	90	90	26,462	642	103,686	67,564
24	Arsimi mesem profesional	09240	0	0	6,971	6,971	23,689	21,228	0	0	30,660	28,199
25	Kujd. social pers,semure & PAK	10140	0	0	0	0	3,400	2,713	0	0	3,400	2,713
26	Sigurimi Shoqëror	10220	6,461	6,052	5,306	3,136	0	0	267	265	12,034	9,453
27	Kujdesi social per familje&femije	10430	44,639	43,690	20,162	10,438	1,499,583	1,497,161	1,409	1,350	1,565,793	1,552,639
28	Strehimi Social	10661	4,450	3,727	200	83	1,680	1,595	200	0	6,530	5,405
29	Sherbime te gjendjes civile	01170	15,800	15,483	1,682	1,010	97	97	1,039	929	18,618	17,519
30	Mbeshtetje per zhvill. ekonomik	04130	1,590	1,568	86	60	0	0	0	0	1,676	1,628
31	Strehimi	06190	0	0	0	0	5,823	5,715	2,329	2,329	8,152	8,044
32	Infrastruktura rajonale vendore	06220	0	0	0	0	0	0	132,513	132,513	132,513	132,513
33	Zgjedhje te pergjitshme & lokale	01620	5,582	5,330	689	689	0	0	0	0	6,271	6,019
34	Fondi rezerve & Kontigjenca	04980	0	0	0	0	10,100	0	0	0	10,100	0
35	Emergjencat civile	10910	0	0	0	0	3,066	3,066	0	0	3,066	3,066
36	Projekte kulturore	08230	0	0	0	0	1,000	0	0	0	1,000	0
	Gjithsej :		**1,035,977**	**981,148**	**844,278**	**613,743**	**1,603,640**	**1,556,387**	**1,171,613**	**624,323**	**4,655,508**	**3,775,601**

Shpenzime nga transferta e pakushtëzuar + të ardhura per 4 - mujorin III –të 2019

në mijë lekë

	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta		Shpenzime Kapitale		Totali buxhetit	
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Planifikim, Menax. & Admin.	01110	256,032	254,992	102,767	67,866	29,447	13,990	30,686	20,161	418,932	357,009
2	Çështjet financiare dhe fiskale	01120	70,850	69,100	7,500	4,232	0	0	0	0	78,350	73,332
3	Shërbimi i borxhit	01710	0	0	121,098	104,806	0	0	0	0	121,098	104,806
4	Shërbime të Policisë Vendore	03140	29,194	24,591	1,988	1,824	30	30	0	0	31,212	26,445
5	Mbrojtja nga zjarri dhe mb.civile	03280	0	0	35	0	13,161	4,058	1,092	4	14,288	4,062
6	Shërbimi tregjeve,akred.inspekt.	04160	0	0	0	0	0	0	7,177	0	7,177	0
7	Shërbimet bujq. inspekt,sig.ushq	04220	0	0	0	0	0	0	19,360	11,996	19,360	11,996
8	Menaxh. infr.Ujitjes& Kullimit	04240	7,002	4,056	0	0	0	0	26,640	7,847	33,642	11,903
9	Administrimi i pyjeve +kullotave	04260	15,920	11,300	18,766	0	40	40	6,635	6,635	41,361	17,975
10	Infrastruktura rrugore vendore	04520	34,653	33,240	21,330	13,937	5,827	67	462,576	140,008	524,386	187,252
11	Transporti Publik	04570	18,570	18,544	19,330	8,752	0	0	0	0	37,900	27,296
12	Menaxhimi I mbetjeve	05100	9,857	8,600	111,151	94,446	0	0	5,700	5,700	126,708	108,746
13	Menaxhimi i ujrave të zeza	05200	0	0	0	0	0	0	21,422	17,769	21,422	17,769
14	Programe te mbrojtjes mjedisit	04320	0	0	1,282	1,097	0	0	100	0	1,382	1,097
15	Planifikimi Urban Vendor	06140	0	0	0	0	0	0	204	202	204	202
16	Sherbime publike vendore	06260	47,750	41,805	98,450	54,999	180	180	124,451	98,899	270,831	195,883
17	Furnizimi me uje	06330	0	0	0	0	0	0	4,022	0	4,022	0
18	Ndriçim rrugësh	06440	4,930	4,902	95,969	88,204	0	0	16,403	8,791	117,302	101,897
19	Sherbimet e kujdesit paresor	07220	560	395	300	188	0	0	2,291	2,290	3,151	2,873
20	Sport dhe argetim	08130	26,795	25,739	20,118	16,970	5,605	5,595	50	50	52,568	48,354
21	Trasheg.kult.eventet artist.&kult.	08220	43,363	41,838	28,693	20,998	247	247	39,880	5,311	112,183	68,394
22	Arsimi baze&parashkollor	09120	22,521	19,509	98,793	61,985	30	30	77,684	14,165	199,028	95,689
23	Arsimi mesem pergj. + konvikte	09230	0	0	22,074	16,355	0	0	0	0	22,074	16,355
24	Kujdesi social per personat e semure dhe PAK	10140	0	0	0	0	3,400	2,713	0	0	3,400	2,713
25	Sigurimi Shoqeror	10220	4,155	4,001	5,306	3,136	0	0	267	265	9,728	7,402
26	Kujdesi social familje&femije	10430	23,636	22,687	20,139	10,415	5,298	3,672	1,409	1,350	50,482	38,124
27	Strehimi Social	10661	4,450	3,727	200	83	1,680	1,595	200	0	6,530	5,405
28	Fondi rezerve & Kontigjenca	04980	0	0	0	0	10,100	0	0	0	10,100	0
	Gjithsej :		**620,238**	**589,026**	**795,289**	**570,293**	**75,045**	**32,217**	**848,249**	**341,443**	**2,338,821**	**1,532,979**

Shpenzime nga transferta specifike për 12 - mujorin e vitit 2019

në mijë lekë

Programi / Njesite Shpenzuese		Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta		Shpenzime Kapitale		Totali i buxhetit	
			Plan	Fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojt.civile	03280	28,444	28,328	4,481	4,453	60	60	120	120	33,105	32,961
2	Ujitja dhe kullimi	04240	4,348	4,323	12,923	12,029	0	0	8,376	420	25,647	16,772
3	Administrimi i pyjeve	04260	9,491	9,491	1,947	776	0	0	0	0	11,438	10,267
4	Infrastruktura vendore rrugore	04520	15,125	14,137	2,301	2,110	125	125	0	0	17,551	16,372
5	Arsimi parashkollor dhe baze	09120	268,986	250,432	0	0	360	300	0	0	269,346	250,732
6	Arsimi Mesem pergjith.dhe konviktet	09230	43,064	39,976	11,996	10,501	90	90	26,462	642	81,612	51,209
7	Mbrojtja sociale	10430	21,003	21,003	23	23	105	105	0	0	21,131	21,131
	Gjithsej :		**390,461**	**367,690**	**33,671**	**29,892**	**740**	**680**	**34,958**	**1182**	**459,830**	**399,444**

Shpenzime nga transferta e kushtëzuar për 12 - mujorin e vitit 2019

në mijë lekë

nr	Institucioni	Programi	Shpenzime personeli		Sshpenz operative		Transferta		Investime		Totali buxhetit	
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Bashkia Elbasan(QKR)	04130	1,590	1,568	86	60	0	0	0	0	1,676	1,628
2	Gjendje civile	01170	15,800	15,483	669	669	97	97	0	0	16,566	16,249
3	Ujitja dhe Kullimi	04240	0	0	0	0	0	0	103,578	103,578	103,578	103,578
4	Strehimi	06190	0	0	0	0	5,823	5,715	2,329	2,329	8,152	8,044
5	Infrastrukt. rajonale vendore	06220	0	0	0	0	0	0	132,513	132,513	132,513	132,513
6	Projekte Kulturore	08230	0	0	0	0	1,000	0	0	0	1,000	0
7	Arsimi bazë	09120	0	0	3,309	2,310	0	0	48,946	42,349	52,255	44,659
8	Arsimi mesëm profesional	09240	0	0	6,971	6,971	23,689	21,228	0	0	30,660	28,199
9	Ndihma ekonomike +PAK	10430	0	0	0	0	1,491,990	1,491,641	0	0	1,491,990	1,491,641
	Viktimat e dhunes	10430	0	0	0	0	2,190	1,743	0	0	2,190	1,743
10	Emergjencat civile	10910	0	0	0	0	3,066	3,066	0	0	3,066	3,066
11	Zgjedhjet vendore	01620	5,582	5,330	689	689	0	0	0	0	6,271	6,019
	Totali :		**22,972**	**22,381**	**11,724**	**10,699**	**1,527,855**	**1,523,490**	**287,366**	**280,769**	**1,849,917**	**1,837,339**

Shpenzime nga të ardhurat jasht limitit për 12 - mujorin e vitit 2019

në mijë lekë

nr	Institucioni	Programi	Shpenzime personeli		Shpenz operative		Transferta		Investime		Totali buxhetit	
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Sherbime publike vendore	06260	0	0	20	20	0	0	0	0	20	20
2	Trasheg.kult.eventet artistike	08220	0	0	2,562	2,498	0	0	0	0	2,562	2,498
3	Gjendje civile	01170	0	0	1,013	341	0	0	1,039	929	2,052	1,270
4	Sigurimi Shoqeror	10220	2,306	2,051	0	0	0	0			2,306	2,051
	Totali :		**2,306**	**2,051**	**3,595**	**2,859**	**0**	**0**	**1,039**	**929**	**6,940**	**5,839**

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta vendore.

Këto burime të ardhurash, zënë peshën kryesore në buxhetin e bashkise dhe përbëjne 58% te totalit te buxhetit. Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjatë vitit 2019, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Totali i shpenzimeve buxhetore të realizuara me burimet e veta është 66%, pagat janë realizuar në masën 95%, shpenzimet operative 72%, transferimet në masën 43% dhe investimet në masën 40%.

000/leke

Emertimi	Plani Total	Fakti Total	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	620,238	589,026	95%
Shpenz.Operative	795,289	570,293	72%
Transferime	75,045	32,217	43%
Investime	848,249	341,443	40%
Totali	**2,338,821**	**1,532,979**	**66%**



Fondi rezervë në buxhetin fillestar të vitit 2019 është planifikuar në shumën 10,000 mijë lekë, ndërsa fondi kontigjencës 8,000 mijë lekë. Gjatë tremujorit të tretë, në muajin tetor, fondi rezerve është transferuar për rritjen e shpenzimeve për ndriçimin rrugor, në shumën 7,900 mijë lekë. Kjo për shkak të lidhjes së kontratave të reja në rrugët e rikonstruktuara, ku mund të përmëndim investimet në Njësitë Administrative Labinot Katund, Shirgjan, Gjergjan, Llixhë, Bradashesh, Papër, Funar, Labinot Fushë, etj.

Fondi i emergjencave civile, në buxhetin fillestar të vitit 2019 është planifikuar në shumën 24,000 mijë lekë dhe gjatë vitit 2019 është përdorur në shumën 2 934 mijë lekë, me vendime të Këshillit Bashkiak për dëmtime banesash, shkaktuar nga fatkeqsi natyrore si rrëshqitje të tokës, erëra të forta, si dhe për dëmtime nga rënia e zjarrit, në shumën 3 000 mijë lekë transferuar për Bashkinë Korçë, me vendim të Këshillit Bashkiak në muajin qershor për shkak të tërmetit në zonën e Korçës, si dhe 10 671 mijë lekë janë transferuar në muajin dhjetor për investime "Punime emergjente për riparimin e argjinaturës anësore të përroit të Zaranikës". Gjithjej, gjatë vitit 2019 fondi i emergjencave civile është prekur për shumën 16 788 mijë lekë.

133

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën specifike

Në vitin 2019 Bashkia vazhdon të kryejë funksionet e transferuara me burim financimi transfertën sektoriale (specifike). Funksionet që u transferuan në Bashki jane:

Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.

Në transfertën specifike të vitit 2019, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Për Arsimin parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjës në qendrën kulturore të fëmijëve) i janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 252 punonjës të transferuar. Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (parashollor dhe Qendra kulturore e fëmijëve) janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 116 punonjës të transferuar. Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin e mesëm, janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 57 punonjës të transferuar.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)
Në transfertën specifike te vitit 2019, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Në këto fond bëjnë pjese fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Numri i punonjësve eshte 31.

Rrugët rurale
Në transfertën specifike të vitit 2019, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Fondet e alokuara nga kjo transfertë janë të pamjaftueshme për të financuar të gjithë zërat e shpenzimeve të domosdoshëm për këtë funksion. Në këto kushte Bashkia Elbasan ka financuar nga të ardhurat e veta për të siguruar mbarëvajtjen e këtij shërbimi.

Administrimi i pyjeve
Në transfertën specifike te vitit 2019, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond perfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin numri i punonjësve është 15.
Bashkia Elbasan ne strukturën organizative të saj, ka krijuar Drejtorinë e Pyjeve, Bujqësisë, Veterinarise dhe Mjedisit, në të cilën bën pjesë sektori i pyjeve, i cili merret me administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve.

Ujitja dhe Kullimi
Në transfertën specifike të vitit 2019, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond perfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2019 numri i punonjësve është 5. Ky shërbim është i atashuar në Agjensinë e Shërbimeve Publike, Sektori i Kullimit dhe Vaditjes. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka Ujitja dhe Kullimi, Bashkia Elbasan ka financuar nga fondet e veta si në shpenzime personeli, nëpërmjet punëtorëve sezonale, ashtu dhe në investime, për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tokës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2019, Bashkisë Elbasan i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë ishin të përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime.

Qendrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën specifike të vitit 2019 te Bashkisë Elbasan i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative për Qendren Sociale "Balashe" Elbasan. Edhe në këtë rast Bashkia Elbasan ka financuar nga fondet e veta në shpenzime personeli, operative dhe investime.

Gjithashtu në këtë qendër kryejnë aktivitetin e tyre "Qendra Rome" dhe "Shtepia e të Moshuarve", të cilat Bashkia Elbasan i financon nga fondet e veta.

Në totalin e shpenzimeve me burim financimi transfertën specifike, realizmi në krahasim me planin vjetor është rreth 87%. Janë realizuar pagat me 94%, shpenzimet operative me 89 %, transfertat 72 % dhe investimet 3%.

Emerti	Plani Total	Fakti Total	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	390,461	367,690	94%
Shpenz.Operative	33,671	29,892	89%
Transferime	740	680	72%
Investime	34,958	1,182	3%
Totali :	**459,830**	**399,444**	**87%**



Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e kushtëzuar

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për përsonat me aftësi ndryshe, që në fakt zënë 81 % të totalit të transfertës së kushtëzuar në shumën 1,491,641 mijë lekë, bursat e nxënësve, shpenzime për zgjedhjet vendore, etj.

Gjithashtu, pjesë e transfertës së kushtëzuar janë edhe investimet në arsimin 9-vjecar, strehimin e komunitetit Rom, ujitjen dhe kullimin si dhe në infrastrukturën rajonale vendore, nëpërmjet investimeve nga FZHSH, gjithsej në shumën 280,769 mijë lekë.

Në mijë lekë

Emertimi	Plan total	Fakti 4-M
QKR	1,676	1,628
Gjendja Civile	16,566	16,249
Trajtim ushqimor (bursat e nxenesve)	33,969	30,509
Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare "Jorgj Dilo"	21,733	21,733
Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare "Bardhyl Popa"	27,213	20,616
"Permiresimi I kushteve te komunitetit Rom"	2,329	2,329
Bonus trehimi	5,823	5,715
Invaliditet+Paaftesia+Nd.Ekon	1,491,990	1,491,641
Viktimat e dhunes	2,190	1,743
Zgjedhjet vendore	6,271	6,019
Sistemim perroi i "Zaranikes"	103,578	103,578
Rikonstruksion i rrugës "Kraste e madhe"	25,440	25,440
"Rikualifikim urban i Parkut "Rinia"	107,073	107,073
Emergjenca civile	3,066	3 ,066
Projekte kulturore	1,000	0
Totali :	**1,849,917**	**1,837,339**

Në totalin e shpenzimeve me burim financimi transfertën e kushtëzuar realizimi për vitin 2019, krahasuar me planin vjetor është 99% ose 1,837,339 mijë lekë. Shpenzimet për paga janë realizuar në masën 97%, në zërin shpenzime operative 91 %, transferimet ku bëjnë pjesë paaftësia dhe ndihma ekonomike në masën 98% dhe investimet në masën 98%.

Shpenzime nga transferta e kushtëzuar

000/leke

Emertimi	Plani Total	Fakti Total	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	22,972	22,381	97%
Shpenz.Operative	11,724	10,699	91%
Transferime	1,527,855	1,523,490	98%
Investime	287,366	280,769	98%
Totali	**1,849,917**	**1,837,339**	**99%**



Siç shikohet edhe nga të dhënat në tabelën e mësipërme, "Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Jorgj Dilo", "Sistemim përroi i "Zaranikës", "Rikonstruksion i rrugës "Krastë e madhe" dhe "Rikualifikim urban i Parkut "Rinia", financim i Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet FZHSH-së, janë realizuar në masën 100%, ndërsa objekti "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare "Bardhyl Popa" në masën 76%, pasi realizimi fakt varet nga ecuria e punimeve dhe afatet e kontratës.

Shpenzime (investime) me të ardhuat nga huaja.

Një zë të vecantë në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të Bashkisë Elbasan zë huaja për shpronësime dhe investime në infrastrukturën rrugore, bazuar në marrëveshjen datë 29.09.2010, marrëveshjen e interceptimit nr.2544/1, datë 29.09.2010 dhe në aneks-marrëveshjen nr.751/1, datë 26.05.2014, lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe BKT.
Shuma totale e huasë së miratuar, pas rishikimit, sipas aneks –marrëveshjes, është 711 milion lekë. Gjatë vitit 2019 kemi patur 1,476 mijë lekë disbursime të reja.
Shuma e disbursuar gjithsej është 621 milion lekë, e cila është përdorur për shpronësime dhe pjesërisht për investime në infrastrukturën rrugore. Mbeten për disbursim 90 milion lekë, të cilat janë pjesë e buxhetit të miratuar për vitin 2020.
Nga shuma e huasë së disbursuar Bashkia Elbasan ka shlyer rregullisht kështet e shërbimit të borxhit (principal +interes), çdo muaj, bazuar në planin e pagesave të bankës.

Të dhena mbi haumarrjen e Bashkisë Elbasan.

Ne mije leke

	Shuma	Sherbimi i borxhit te paguar deri me 31.12.2019			Sherbimi i borxhit per tu paguar deri ne maturim		
		principal	interesa	**gjithsej**	principal	interesa	**gjithsej**
Hua e disbursuar	620,773	256,555	152,733	**409,288**	364,219	46,947	**411,166**
Hua pa disbursuar	90,353						
Gjithsej :	**711,126**						

Në lidhje me investimet me të ardhurat dhe transfertën e pakushtëzuar :

Sipas detajimit të buxhetit dhe depozitimit në sistemin e Thesarit, janë planifikuar 168,653 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar, 103,359 mijë lek nga te ardhurat e trashëguara nga viti 2018, 483,676 mijë lekë nga të ardhurat e vitit 2019 dhe 92,561 mijë lekë të ardhura nga huaja, gjithsej 848, 249 mijë lekë.

Siç e shikojme kemi 32 % të totalit të investimeve të cilat financohen me transfertë të pakushtëzuar dhe të ardhura të trashëguara, të cilat janë burime fondesh të garantuara. Realizimi 53% (vjetori) i zërit të investimeve ka të bëjë me investimet (shpronesimet) nga huaja të cilat nuk janë realizuar për mungesë të dokumentacionit për shpronësim si dhe lidhet me kohën e domosdoshme që kërkohet (afatet) për zbatimin e kontratave të investimeve.

Më poshtë po përmendim disa nga programet më kryesore në zërat e buxhetit.

138

Programi i Administratës Vendore (Planifikim Menaxhim, Administrim)

Programi i administratës vendore përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e tjera të punës, veçanërisht në vazhdimësinë e zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në të gjitha nivelet e institucionit për të mundësuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrit ligjor në funksion.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Cftja

Konceptoi:

Specialisti i Kadastrës: P. Bardhi

P/Sektorin e Admin._ Menaxhimit: J. Bodurri

Drejtori i SHPBVM: Sh. Çullhaj

Drejtoria Juridike: O. Deliallisi

Zv/ Kryetari: I. Sina

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 1028/1 Prot.

Elbasan, më 02.03.2020

Vendim

Nr 29 Datë 26/02/2020
Për miratimin e kontratës së grantit

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 26/02/2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë per kontratën e grantit dhënë nga ambasada e Japonisë në Tiranë, në kuadër të projektit "Për përmirësimin e parqeve dhe zonave të gjelberta në Bashkinë Elbasan" për blerjen e mjeteve si ekskavatorë dhe makinë prerëse bari, me propozim te Kryetarit te Bashkise, bazuar ne ligjin 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" nenet 8,9,54 te tij,

Vendosi

1- Të miratojë kontratën e grantit prej 74606 (shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtë) euro. ndërmjet Ambasadës së Japonisë dhe Bashkisë Elbasan, për Agjensinë e Shërbimeve Publike, sipas tekstit bashkangjitur këtij vendimi.
2- Ngarkohen Kryetari dhe administrate e Bashkise dhe Agjensia e Shërbimeve Publike, me zbatimin e këtij vendimi.
3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Drejt. A.Sh.P. N. Sinani
Drejt. Buxhetit M. Belúli
Drejt.Juridike O. Deliallisi
Av. Qytetit A. Hoxha

Sek. K. Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari
Hektor Ciftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb:ëëë.elbasani.gov.al*

336
27.2.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1030/1 **Prot.**

Elbasan, më 27.02.2020

VENDIM

Nr. 30 ***datë*** 26 ***.02.2020***

"Për krijimin e Muzeut të Arsimit"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.02.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Qendra e Trashëgimisë Kulturore *"Për krijimin e Muzeut të Arsimit"*, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr.27/2018 "Për trashegiminë kulturore dhe muzetë";

VENDOSI:

1. Të miratojë, në parim, krijimin e Muzeut të Arsimit pranë Qendrës së Trashëgimisë Kulturore, si institucion në varësi të Bashkisë Elbasan.

2. Detyra kryesore funksionale e këtij institucioni do të jetë sigurimi i ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të dokumentave arsimore, që konsiderohen trashëgimi kulturore, si dhe të krijojë kushtet për aksesimin e tyre nga publiku.

3. Veprimtaria dhe organizimi administrativ i këtij institucioni do të bëhet në përputhje me proçedurën ligjore të përcaktuar në ligjin nr.27/2018 "Për trashegiminë kulturore dhe muzetë";

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Qendra e Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sporteve në Bashki.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Ciftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Qendra e Trashëgimisë Kulturore: *S. Belegu*

Drejtore e Drejt. Juridike: *O. Deliallisi*

Zv/ kryetar: *A. Kovaçi*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1026/1 Prot. Elbasan, më 02.03.2020

VENDIM

Nr. 31 datë 26.02.2020

"Mbi të drejtën e shpërndarjes së botimit "Elbasani në dokumentet osmane të Arkivit të Stambollit" nga Qendra e Trashëgimisë Kulturore"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.02.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Qendra e Trashëgimisë Kulturore *"Mbi të drejtën e shpërndarjes së botimit "Elbasani në dokumentet osmane të Arkivit të Stambollit" nga Qendra e Trashëgimisë Kulturore"*, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr.10296 datë 08.7.2010 "Për menaxhimin finanaciar dhe kontrollin" (i ndryshuar) dhe në Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar),;

V E N D O S I:

1. Të miratojë shpërndarjen e botimit "Elbasani në dokumentet osmane të Arkivit të Stambollit", për personalitete dhe ambasadorë të huaj, agjenci turistike vendase dhe të huaja, Bibliotekës së qytetit, shoqatave kulturore etj,, sipas planit të shpërndarjes bashëlidhur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra e Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sporteve në Bashki, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Konceptoi:
Qendra e Trashëgimisë Kulturore: *S. Belegu*
Drejtoria e TKTS: *F. Musai*
Drejtoria e Buxhetit: *M. Beluli*
Drejtoria e Financës: *A. Merkja*
Drejtore e Drejt. Juridike: *O. Deliallisi*
Zv/ kryetar: *A. Kovaçi*

TABELA E SHPËRNDARJES SË KOPJEVE TË BOTIMIT "ELBASANI NË DOKUMENTAT OSMANE TË ARKIVIT TË STAMBOLLIT"

Sasia e kopjeve të librit të botuar	300
Sasia e kopjeve të librit, që do t'i shpërndahen Bibliotekës së qytetit të Elbasanit "Q. Baholli"	5
Sasia e kopjeve të librit, që do t'i shpërndahen Bibliotekës Kombëtare	5
Sasia e kopjeve të librit, parashikuar për t'iu shpërndarë personaliteteve, agjencive turistike vendase dhe të huaja, shoqatave kulturore, bibliotekave të shkollave etj.	290

524

01.04.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1565 Prot Elbasan më 31 /03/ 2020

VENDIM
Nr. 32 datë 31 /03/2020

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHKURT 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **SHKURT 2020** gjithsej 102 familje me një fond prej 296.136 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Ciftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN Nr. 179

523

01/04/2020

2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1566 Prot Elbasan më 31 /03/2020

VENDIM

Nr 33 datë 31 /03/2020.

Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë, për muajin SHKURT 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHKURT 82 familje me fond 270.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Sh. K. Soc Komunit Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Financës A.Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Ciftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

522

01.04.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 156 **Prot.** **Datë** 31 **.03. 2020**

VENDIM

NR. 34 **DATË** 31 **. 03. 2020**

MBI

"Transferim mallrash nga Qendra Ekonomike e Arsimit në Qendrën Sociale "Balashe".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___ . 03. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Për transferim mallrash nga Qendra Ekonomike e Arsimit në Qendrën Sociale "Balashe", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe VKM nr.243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqsisë natyrore"

VENDOSI :

1. Transferimin pranë Qendrës Sociale "Balashe", për tu përdorur nga kjo e fundit për vaktet e përgatitura me të cilat furnizohen çdo ditë personat në nevoj që trajtohen në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr.243, datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqsisë natyrore".
   Vlera e përgjithshme e artikujve që do të tranferohen është 711,499 lekë.

2. Qendra Ekonomike e Arsimit, në transferimet e ardhshme të buxhetit, do të kompesohet për fondin e përdorur nga kuotat ushqimore për likujdimin e faturave të mallrave ushqimorë të transferuar sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Qendra Sociale "Balashe".

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimitnga Prefekti.

SEKRETAR
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Hektor Ciftja

Dr.Buxhetit : M.Beluli
Dr. Pergj.: Q.Tusha
Dr.Juridike: O.Deliallisi
Dr.i QEA: Y.Kasa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
QËNDRA EKONOMIKE E ARSIMIT

Elbasan më 31 .03. 2020

Lista e produkteve ushqimore do transferohet

emertimi	njesia	sasia	çmimi	vlera/leke	Datë/Skadimi
Oriz	kg	1000	216	216,000.00	Aug-20
Djath	kg	10.9	506.4	5,519.76	
Gjalp	kg	16.2	576	9,331.20	
Qumesht	litra	1681	156	262,236.00	15/6/2020
Biskota per Bebe	kg	36	384	13,824.00	24/6/2020
Korosant	cop	1266	28.8	36,460.80	14/4/2020
Konflekse	kg	39	300	11,700.00	7/6/2020
Mish Viçi	kg	162.4	788.4	128,036.16	
Fileto-Pule	kg	27.3	540	14,742.00	
Mish Pule	kg	32.6	348	11,344.80	
Thjerreza	kg	6	384	2,304.00	2/5/2020
Totali :				**711,498.72**	

DREJTOR I KOMANDUAR I QEA
Ylber KASA

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

572
15.04.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1604/1 Prot Elbasan më 14/04/2020

VENDIM

Nr 37 datë 14/04/2020.

Mbi përdorimin e fondit të emërgjencës civile për dhënien e ndihmës ekonomike te dyfishuar nga fondi i të ardhurave të Bashkisë, për muajin SHKURT 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë", VKM nr 254, 27.03.2020 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri në 14 milione leke, ndihmës ekonomike dhe pagesës së të ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqesisë natyrore, tëshpallur si pasojë e COVID-19", si dhe Urdhërit Nr 92/4 datë27.03.2020 "Për përfitimin e masës së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë si pasojë e epidemisësë shkaktuar nga infeksioni covid-19"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHKURT 81 familje me fond 268.420 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Për financimin sipas pikës 1 të këtij vendimi do të përdoret fondi i emergjencës civile për shumën 269 mijë lekë.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Sh. K. Soc Komunit Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxheti M. Beluli

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Ciftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

573
15.04.2020

2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1685/2 **Prot.** **Datë** 14 **.04. 2020**

VENDIM

NR. 38 **DATË** 14 **. 04. 2020**

MBI

"Transferim fonde nga granti, për bonusin e strehimit".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___. 04. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **"Transferim fonde nga granti, për bonusin e strehimit",** bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimin nr.2, datë 20.01.2020 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020", vKB nr.201, datë 24.12.2019 mbi "Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020", vKB nr.171, datë 04.12.2019 "Mbi miratimin e listës emerore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje, për vitin 2020, në qytetin e Elbasanit" , si dhe shkresën nr.5462, datë 12.03.2020 të Ministrisë së Finacave dhe Ekomomisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e fondit 4,173,548 lekë, financim i Bashkise Elbasan për plotësimin e shumës së sobvencionimit të qirasë, bazuar në listën e familjeve përfituese për vitin 2020 (janar – dhjetor), miratuar me vKB, nr.171, datë 04.1202019. (Bashkëfinancim i Ministrisë së Financave dhe Bashkisë Elbasan).

2. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2020, për financimin e pikës 1 të këtij vendimi, si më poshtë :

   Paksohet :
   - 4,174 mijë lekë, programi 06330, kap 01, artikulli 231, institucioni ASHP, objekti :
     "Ndërtim puse shpimi+investime për marrje ujë të pijshëm, në fshatrat Griqan i Sipërm, Gur i Zi, Mollagjesh dhe Letan",

   Shtohet :
   - 4,174 mijë lekë, programi 10661, kapitulli 01, artikulli 606, institucioni Bashkia.

3

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit dhe Drejtoria e Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Hektor Ciftja

Dr.Buxhetit : M.Beluli

Dr. DAPS : A.Suli

Dr. Pergj.: Q.Tusha

Dr.Juridike: O.Deliallisi

574
15.04.2020

2

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1688/1 **Prot.** **Datë** 14 **.04. 2020**

V E N D I M

Nr. 38 **Datë** 14 **. 04.2020**

"Mbi Miratimin në parim i mbështetjes financiare për investime ne programin social "Rikonstruksion banesash", në bashkëfinancim me MFE "

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.04. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan *"Mbi Miratimin në parim i mbështetjes financiare për investime ne programin social "Rikonstruksion banesash", në bashkëfinancim me MFE"*bazuar në ligjin nr.139/2015"Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social VKM nr. 454, datë 3.7.2019, VKM nr. 458, datë 3.7.2019, Bashkia Elbasan po aplikon pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për projektet e investimit mbi "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2020.

V E N D O S I:

1. Miraton në parim financimin në masën 20% të programit social "Rikonstruksion banesash", në bashkëfinancim me MFE për vitin 2020.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës dhe Sektori Projekteve.

3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETARI
Klajdi Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

Konceptoi: *R. Thanasi*
Drejtoria A.P.S.: *A. Suli*
Drejtoria Buxhetit: *M. Behluli*
Drejtoria Financës: *A. Merkja*
Drejtoria e P.P.A.A.B.F: *Q. Tusha*
Zv/Kryetari: *I. Sina*

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr "Qemal Stafa",Tel. +355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

599
30.04.2020

6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1862/1 Prot

Elbasan më 30 /04/2020

VENDIM

Nr 41 datë 30/04/2020.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Mars 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin MARS 82 familje me fond 270.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Sh. K. Soc Komunit Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Financës A.Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Ciftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1863 Prot

Elbasan më 30/04/ 2020

VENDIM
Nr. 42 datë 30/04/2020

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin MARS 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **MARS 2020** gjithsej 122 familje me një fond prej 378.800 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

621

30.04.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr.1861/1 Prot

Elbasan më 30 /04/ 2020.

VENDIM

Nr 43 datë 30 /04/2020.

Mbi miratimin e "Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 të Bashkisë Elbasan".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/04/2020 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 24, 28/1 dhe ligjin nr. 121/2016 datë 24.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqërore" neni 36 ,

VENDOSI

1.Të miratojë "**Planin Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019- 2022 të Bashkisë Elbasan**".

2 Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, Drejtoria e Buxhetit si dhe Drejtoria e Financës.

1. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

.

Dr.Sh. K. Soc Komunit Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi
Drejtori Buxheti M. Beluli
Drejtori Financës A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hektor Ciftja

REPUBLIKA SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

602

30.04.2020

4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1864/1 **prot.** **Elbasan më** 30/04/**2020**

VENDIM

Nr. 44 datë 30/04/2020

"Për Ndryshim Strukture dhe Transferim Fondesh ".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës...../...../2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore e Bashkisë për kalimin e sektorit të Agronomisë nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisor në Agjensinë e Shërbimeve Publike, me kërkesë të Agjensisë së Shërbimeve Publike; bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 54 të tij, ligjin 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" neni 40;

Vendosi

1- Sektori i Agronomisë nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisor të kalojë në Agjensinë e Shërbimeve Publike.

2- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve publike të jetë 258 punonjës.

3. Transferimin e fondeve nga të ardhurat, për periudhën maj- dhjetor 2020, si më poshtë :

Paksohet :

Prog	**Kap.**	**Art.**	**Shuma/lekë**	**Njësia Shpenzuese**
04220	5	600	4,350,000	Bashkia
04220	5	601	700,000	Bashkia
		Gjithsej :	**5,050,000**	

Shtohet :

Prog	**Kap.**	**Art.**	**Shuma/lekë**	**Njësia Shpenzuese**
04220	5	600	4,350,000	ASHP
04220	5	601	700,000	ASHP
		Gjithsej :	**5,050,000**	

Plan Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019 - 2022

Bashkia Elbasan

Përmbajtja

Shkurtime **3**
I. Hyrje **6**
II. Kuadri ligjor dhe politik **8**
III. Metodologjia ROMACTED, procesi dhe aktorët e përfshirë **11**
IV. Analiza Situacionale Vendore **14**
Administrata **15**
V. Pakicat Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Elbasan dhe Vlerësimi i Nevojave **17**
Arsimi **20**
Shëndetësia **22**
Punësimi **22**
Mbrojtja Sociale **23**
Strehimi dhe infrastruktura urbane **25**
Regjistrimi civil **27**
VI. Vizioni dhe Objektivat e Planit Vendor **28**
VII. Plani i Masave **29**
VIII. Burime Financiare **48**
IX. Monitorimi dhe Vlerësimi **50**
X. Shtojca **53**
Vlerësimi i Kapaciteteve të Bashkisë dhe Institucioneve të tjera në Nivel Vendor për Bashkinë Elbasan **53**
Kostimi i zbatimit të planit të veprimit sipas objektivave /aktiviteteve 2019-2022 ..... **57**

Lista e Tabelave dhe Figurave

Tabela 1. Hapat e procesit për hartimin e planit të veprimit për integrimin e romëve, 2019.....11
Tabela 2. Investime të përfunduara në vitin 2018, Bashkia Elbasan.....15
Tabela 3. Problemet dhe Nevoja për Ndryshim sipas gjetjeve në Fokus Grup të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Elbasan.....19
Tabela 4. Mbi frekuentimin e sistemit parashkollor dhe arsimit të detyrueshëm, në Bashkinë Elbasan (2018).....21
Tabela 5. Të dhëna mbi punësimin e romëve dhe egjiptianëve, Elbasan 2018.....23
Tabela 6. Të dhëna mbi NE dhe programin e mbrojtjes sociale, Bashkia Elbasan (2018 dhe 2019).....24
Tabela 7. Përmirësimi i banesave dhe projekte të integrimit urban për periudhën 2016-2019 (në Lekë).....25
Tabela 8. Regjistrimi i romëve dhe egjiptianëve, Bashkia Elbasan.....27
Tabela 9. Buxheti sipas objektivave strategjik për periudhën 2019-2022.....49
Tabela 10. Shpenzimet sipas burimeve të financimit.....49

Figura 1. Burimeve parësore dhe dytësore të të dhënave të përdorura.....12

Shkurtime

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DRAFP	Drejtoria Rajonale e Arsimit e Formimit ProfesionalDRAKPA Drejtoria Rajonale e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisë.
DSHP	Drejtoria e Shëndetit Publik
DSHS	Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar
CAG	Grupi i Veprimit të Komunitetit
IRCA	Instituti i Kulturës Rome
KiE	Këshilli i Evropës
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
NAPIRE	Plani Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve
NE	Ndihma Ekonomike
NJA	Njësi Admnistrative
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
NJVKSHE	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Elbasan
PAK	Persona me Aftësi Ndryshe (të kufizuar)
PV	Plan Veprimi
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
RAT	Reforma Territoriale Administrative
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
ZA	Zyra Arsimore

[Fjalë falenderuese nga Kryetari i Bashkisë]



I. Hyrje

Reforma e decentralizimit dhe qeverisjes vendore dhe reforma territoriale administrative shtroi sfida të reja për bashkitë e reja në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë. Një nga sfidat është përmirësimi i menaxhimit të të gjitha burimeve vendore për një zhvillim ekonomik dhe social të qëndrueshem. Gjithashtu me rëndësi të veçantë janë edhe forcimi i planifikimit strategjik, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, rritja e pjesëmarrjes qytetare (e të gjitha komuniteteve) në proceset e vendim-marrjes lokale si dhe monitorimi I zbatimit të politikave dhe programeve në nivel lokal mbi bazën e principit të mos-diskriminimit dhe angazhimit civil.

Qeverisja vendore është rezultat i ndërveprimeve, marrëdhenieve midis sektorëve dhe aktorëve të ndryshëm (, sektori publik, sektori privat dhe shoqëria civile), dhe përfshin vendime, negociata dhe marrëdhënie fuqie të ndryshme midis palëve të interesuara për të vendosur kush bën çfarë, kur dhe si planifikohen, menaxhohen dhe rregullohen shërbimet brenda një sistemi politik dhe social[1]. Qeverisja e mirë përfshin kapacitetin e qeverisjes për të menaxhuar me efikasitet burimet e veta dhe për të zbatuar politika të përshtatëshme, si dhe ekzistencën e një kontrolli demokratik mbi agjentët e ngarkuar nga autoriteti[2].

Planet lokale të zhvillimit janë një instrument zhvillimi për bashkitë për të përmirësuar aspekte të qeverisjes vendore në kuadër të zbatimit të politikave të zhvillimit, bazuar në vlerësimin e nevojave, mundëson shpërnadrjen e prioritizuar të burimeve të vlefshme, lejon identifikimin e hendekut financiar për të negocuar me aktorë të tjerë dhe agjenci donatore në mbështetje të projekteve të zhvillimit në nivel vendor, si dhe mundëson monitorimin e rregullt të zbatimit të masave dhe aktiviteteve.

Plani për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në nivel vendor për Bashkinë Elbasan është një zhvillim progresiv i Planit Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, si dhe Planit për Mbrojtjen Sociale 2017-2022 të miratuar nga Bashkia Elbasan,i cili synon zbatimin e masave për lehtësimin e integrimit të komunitetit, si dhe zhvillimin progresiv të tij, në vijim të angazhimit politik të Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak dhe në frymën e bashkëpunimit me projektin ROMACTED[3]. Gjithashtu, mbrojtja e të drejtave të njeriut përfshirë agjendën rome dhe politikat jodiskriminuese është një nga pesë prioritetet e agjendës së integrimit evropian të Shqipërisë, që përfshin "masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese"[4].
Principet kryesore të Planit për Integrimin e R&E në nivel vendor udhëhiqen nga: (i) nxitja e përfshirjes sociale (ii) reagim ndaj situatave të vështira social-ekonomike dhe emergjente për pakicat rome dhe egjiptiane, (iii) respektimit të diferencave midis pakicave rome dhe egjiptiane, (iv) përfshirjen e komuniteteve në identifikimin e nevojave dhe hartimin e masave (v) forcimin e

[1] Udhëzues për të matur Qeverisjen Vendore
[2] Qeverisja e mirë (Banka Botërore)
[3] Në këtë kuadër është nënshkruar edhe një memorandum mirëkuptimi midis palëve.
[4] Bashkimi Evropian, *Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014*http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf, f. 19.

bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve: bashkisë dhe institucioneve qendrore, organizatave të shoqërise civile, aktivistëve dhe grupeve komunitare.

Masat e Planit per Integrimin e R&E në nivel vendor për Bashkinë Elbasan janë grupuar në 6 fusha prioritare: regjistrimi civil, arsimi, punësimi dhe zhvillimi i aftësive, shëndetësia, strehimi dhe integrimi urban, dhe mbrojtja sociale.

II. Kuadri ligjor dhe politik

Në Shqipëri, kuadri ligjor që garanton respektimin e të drejtave të minoriteteve është i mirë zhvilluar duke filluar me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për të vazhduar me konventat ndërkombëtare dhe ligje, ku ndër të tjera përfshihen: Deklarata Universale të të Drejtave të Njeriut (Kombet e Bashkuara, 1948[5]), Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966), të ratifikuar në vitin 1991, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1976 (1991), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës dhe Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare[6], Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1980 (1996), Konventa për Nxitjen e Punësimit dhe Mbrojtjen nga Papunësia (nr.168 të ILO-s), 1988 (2006), Konventa kundër Diskriminimit në Arsim (1960), Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (ligji nr. 10071/2009), etj.

Me miratimin dhe ratifikimin e konventave ndërkombëtare, pas viteve '90 qeveritë shqiptare kanë hartuar dhe miratuar ligje (dhe akte nën-ligjore) si dhe politika të tjera[7] të cilat kanë krijuar premisat për një mjedis më mundësues për integrimin e pakicave në vend. Nga ana tjetër, edhe procesi i integrimit evropian i cili nuk përfaqëson vetëm një mundësi për vendin, por edhe një sfidë për sa i përket realizimit të reformave strukturore drejt statusit shtet anëtar i Bashkimit Evropian, ndikon në shtyrjen përpara edhe të procesve integruese për pakicat.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020 dhe politikat sektoriale Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA), Strategjia për Mbrojtjen Sociale janë fokusuar në (i) *përmirësimin e përfshirjes sociale dhe aksesit në shërbimet bazë* për personat dhe grupet e margjinalizuara, (ii) *ofrimin e programeve të specializuara, që lehtësojnë aksesin në tregun* e punës dhe rrisin mundësitë e punësimit, (iii) *ofrimin e mundësive për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm* për personat, që kanë kaluar moshën e arsimit të detyrueshëm dhe që nuk e kanë përfunduar atë, (iv) *Shtrirja e shërbimeve psik*ologjike, veçanërisht në shkollat ku

[5] Miratuar në vitin 1955

[6] Ligji Nr. 8496 / 1999

[7] Ligje specifike të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt apo indirekt përfshijnë: ligji "Për avokatin e popullit" (8454/1999), ligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (9887/2008), ligji "Për barazinë gjinore" (9970/2008), Kodi zgjedhor (2008), ligji "Për ndihmën juridike" (10039/2008), ligji "Për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit" (2010), ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e minoriteteve", i ndryshuar (Ligji Nr. 96/2017), VKM-ja "Për arsimimin e komuniteteve minoritare në gjuhën e tyre amtare", i ndryshuar, ligji për strehimin social (Ligji nr.22/2018), etj. Po kështu një sërë vendimesh të KM dhe dokumentesh politikë në këtë kuadër përfshijnë: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) "Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet", i ndryshuar (VKM 726/12 Dhjetor 20187), Plani Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, i ndryshuar, Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom, Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) dhe Dekada e Përfshirjes së Romëve, 2010 – 2015, PKV për Integrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, 2016-2020.

ka fëmijë romë dhe egjiptianë dhe nxënës, që rrezikojnë të braktisin shkollën, (v) *Lehtësimi i aksesit të grupeve vulnerabël në shërbimet shëndetësore* përmes sigurimit të shërbimeve të shëndetit publik, ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik dhe i paketave të informacionit, si dhe i programeve specifike për aksesin në sistemin shëndetësor, ofrimi i mbështetjes nga punonjësit socialë dhe shërbimet e duhura shëndetësore, (vi) *Krijimi i sistemeve të integruara të shërbimit në nivel rajonal/vendor,* sipas standardeve të kujdesit për të gjitha grupet vulnerabël nëpërmjet përmirësimit të mekanizmave kombëtarë dhe vendorë për identifikimin dhe vlerësimin e nevojës për shërbimet e kujdesit social në përputhje me procedurat standarde të veprimit dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar me kërkesat ndërkombëtare.

Masat e Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020) janë projektuar në gjashtë fusha prioritare: regjistrimi civil, arsimi dhe dialogu ndërkulturor, punësimi dhe zhvillimi i aftësive, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale. Mbrojtja e të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët, dhe politikat antidiskriminuese është një nga pesë prioritetet kyçe të agjendës për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Parimet kryesore të PKV-së për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve janë elemente si: (i) nxitja e përfshirjes sociale, (ii) masat për përgjigjen ndaj situatave të emergjencës, (iii) respektimi i dallimeve midis dhe brenda këtyre komuniteteve, (iv) garantimi i përfshirjes së këtyre komuniteteve në projektimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike, (v) nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve (qeverisja qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, OSHC-të dhe komunitetet).

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015-2020), Reforma Territoriale Administrative (2015), Ligji për vetëqeverisjen vendore[8], Ligji për financat publike vendore[9] krijuan bazën dhe hapësirën për reformimin e mëtejshëm të njësive të qeverisjes vendore dhe riorganizimin administrativ të bashkive mbi bazën e ndarjes së re territorale. Synimet strategjike janë të lidhur me: (i) rritjen e eficiencës së strukturave të qeverisjes vendore, (ii) forcimin e financave vendore dhe decentralizimin fiscal, (iii) zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm dhe (iv) qeverisjen e mirë në nivel vendor. Ligje të tjera të rëndësishme janë edhe Ligji 119/2014 Për të Drejtën e Informimit dhe Ligji 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Me transferimin e disa funksioneve nga qeveria në NJQV në vitin 2016, janë rritur kompetencat e bashkive lidhur me funksionin e përfshirjes sociale[10].

[8]Ligji 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore
[9] Ligji 68/2017 Për Financat Vendore
[10]Shënim: Funksioni nuk është transferuar plotësisht në NJQV

Në Shqipëri, Qeverisja e Mirë ka të bëjë me zhvillimin e përgjegjshëm të çështjeve publike dhe menaxhimin e burimeve publike të cilat janë përfshirë në 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë[11] të Këshillit të Evropës. Këto 12 parime janë të përfshira në Strategjinë për Inovacionin dhe Qeverisjen e Mirë, miratuar me vendim të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në vitin 2008. Ato mbulojnë çështje të tilla si sjellja etike, sundimi i ligjit, efikasiteti dhe efektiviteti, transparenca, menaxhimi i shëndoshë financiar dhe llogaridhënia.

Në Shqipëri, aktivitetet e Këshillit të Evropes[12] përqendrohen kryesisht në trajtimin e pengesave që mbajnë në vend të drejtat e pakicave, pavarësisht ecurisë në raport me angazhimet ligjore. Synimi i Këshillit të Evropës[13] në lidhje me mbrojtjen e pakicave kombëtare është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllim realizimin e parimeve dhe idealeve që përbëjnë trashëgiminë e tyre të përbashkët duke gjykuar se një prej metodave për arritjen e këtij qëllimi është ruajtja dhe realizimi i mëtejshem i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Bazuar në këto konsiderata, Shqipëria dhe shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë miratuar "Deklaratën e Strasburgut"[14] e cila ka për qëllim fuqizimin dhe promovimin e pjesëmarrjes efektive të pakicave rome në jetën shoqërore, politike dhe qytetare, duke përfshirë pjesemarrjen aktive të këtyre pakicave në proceset vendimmarrës dhe përfshirjen sociale. Projekti "Forcimi i strukturave të Qeverisjes Vendore" i zbatuar nga zyra e Këshillit të Evropës Tiranë, në tre faza 2014-2019, ka ofruar mbështetje dhe ekspertizë në disa drejtime lidhur me forcimin e kapaciteteve të administratës vendore, dhe institucioneve qendrore si DAP, ASPA, etj.

Një nga synimet e programit ROMACTED, i cili është vijueshmëri e programeve ROMED 2 dhe ROMACT, është hartimi i Planit të Veprimit në nivel lokal në shtatë bashki të përzgjedhura[15] nëpërmjet 4 hapave kryesore: Përgatitja e procesit; Vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi i tyre; Hartimi i planit të përbashkët të veprimit; Financimi, zbatimi dhe monitorimi. Këto hapa, zbatimi i tyre dhe rezultatet e arrituara për Bashkinë Elbasan paraqiten në seksionet në vijim të këtij dokumenti.

[11] 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë dhe Etika Europiane e Qeverisjes se Përsosur (ELoGE)
[12] Neni 4.2.4 Romët dhe Egjiptianët
13 Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
14 Deklarata e Strasburgut mbi Romët
15 Bashkia Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Përmet, Pogradec dhe Roskovec

III. Metodologjia ROMACTED, procesi dhe aktorët e përfshirë

Metodologjia dhe procesi i përshkuar për hartimin e këtij plani veprimi është konceptuar dhe zbatuar nën një frymë të përgjithshme gjithëpërfshirëse. Kjo është mundësuar duke siguruar që çdo përpjekje e ndërmarrë në këtë kuadër të udhëhiqej nga parimet e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe integrimit. Në punën me komunitete vulnerable në përgjithësi, dhe në rastin konkret me komunitetet rome dhe egjiptiane, besohet se fuqizimi apo mundësia për fuqizim i çdo individi është thelbësore për fuqizimin dhe integrimin e gjithë komunitetit. Në këtë prizëm, adresimi i nevojave dhe problematikave përmes një modeli integrues, ku jetët e njerëzve dhe nevojat e tyre shihen, vlerësohen dhe asistohen nga një këndvështrim multidisiplinar dhe shumëplanësh, kanë qenë në themel të përqasjes sonë.

Ndryshimet, përmirësimet dhe arritjet mund të jenë të qëndrueshëm veçse përmes një strategjie të tillë, ku përqasja e integruar nënkupton nevojën për koordinim dhe sinergji në fusha si arsimi, punësimi, përkujdesi shëndetësor, strehimi dhe shërbimet shoqërore. Për arritje të qëndrueshme, gjatë të gjitha përpjekjeve të ndërmarra u inkurajuan dhe zbatuan procese me pjesëmarrje. Pjesëmarrja e komuniteteve në të gjitha proceset i bën ato jo vetëm më të hapura, transparente dhe ndërvepruese, por shton shanset e suksesit dhe i bën proceset dhe rezultatet që vijnë prej tyre më të pranueshme të zbatueshme nga komunitetet e synuara. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të komunitetit rom dhe egjiptian në çdo hap të konceptimit të këtij plani, siguroi ndër të tjera, që edhe të dhënat dhe evidencat e mbledhura për të ushqyer hartimin e këtij plani të ishin të përditësuara dhe relevante. Ato e përforcuan më tej ndjesinë e pronësisë dhe përgjegjshmërisë për planin dhe zbatimin e tij. Më konkretisht, procesi për hartimin e planit për integrimin e romëve në nivel vendor kaloi përmes katër hapave kyç, të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1. Hapat e procesit për hartimin e planit të veprimit për integrimin e romëve, 2019

Hapi 1. Përgatitja e Procesit dhe Angazhimi	**Hapi 2: Vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi i tyre**
Detyrat e realizuara ishin: a) Identifikimi i aktorëve – përgjatë të cilit iu dha përgjigje pyetjeve "Kush do të përfshihet?" "Pse? Ç'kontribute sjell?" b) Garantimi i angazhimit politik – mundësoi identifikimin e aktorëve të vullnetshëm dhe çoi më tej dejt angazhimit të tyre politik për realizimin e procesit. c) Ngritja dhe mbështjetja teknike për grupet dhe nën-grupet e punës për hartimin e planit.	Vlerësimi i nevojave të komunitetit kaloi përmes: a) Mbledhjes së të dhënave – këtu u përcaktuan burimet e të dhënave, teknikat për mledhejn e tyre, si dhe indikatorëve/treguesve përkatës. b) Identifikimi dhe prioritizimi i problemeve dhe nevojave – me pjesëmarrjen e komuniteteve u identifikuan problematikat dhe nevojat e tyre si dhe u caktua se çfarë është më prioritare dhe e menjëhershme për adresim në kushtet e burime dhe kohës së kufizuar. c) Vlerësimi i kapaciteteve institucionale – ku iu dha përgjigje pyetjeve "Kush mund të bëjë çfarë për adresimin e problematikave/nevojave të identifikuara?".
Hapi 3: Hartimi dhe Miratimi i një Plani Veprimi të Përbashkët	**Hapi 4: Financimi, zbatimi dhe monitorimi i PV**
Hapi i tretë mundësoi hartimin dhe miratimin e	Hapi i katërt ndërtoi rrugën drejt një plani të

planit të përbashkët të veprimit dhe përfshiu reflektim dhe adresim të të mëposhtmeve: a) Reflektim – çfarë dimë nga procesi i vlerësimit të nevojave dhe prioritizimit të tyre? b) Ku synojmë të arrijmë? ç'ndryshime duam të sjellim? c) Si? – aktivitete afatshkurtra & afatmesme. d) Integrimi i cështjeve rome në planin lokal – Si? Integrimi si pjesë e së tërës. Planet Sociale. e) Aktivitete/ndërhyrje/projekte konkrete – çfarë? Kush? Kur?	zbatueshëm, duke përfshirë çështje si financimi dhe monitorimi i tij. Gjatë këtij hapi iu dha përgjigje pyetjeve të mëposhtme: a) Sa % e financimit të Planit Vendor do të mbulohet nga buxheti NJVQV? A parashikohen financime nga Buxheti i Shtetit? Donatorët? b) A ka hendek financiar? Cilat janë burimet potenciale për financimin e projekteve të reja? c) Sa % e shpenzimeve të Planit Vendor janë të planifikuara në PBA 2019-2021? d) A kemi aktivitete/projekte të reja? Sa % të shpenzimeve zënë ato? Si planifikohet financimi i tyre? e) A është hendeku financiar pjesë e kërkesave buxhetore shtesë dhe bisedimeve me donatorët të ndryshëm?

Me qëllim vlerësimin e nevojave dhe informimin e proceseve vendimmarrëse lidhur me planin përmes të dhënave dhe evidencave u hartua dhe u zbatua një udhëzues për mbledhjen e të dhëna parësore dhe dytësore. Ato përfshinë burime të ndryshme, të përmbledhura në skemën ilustruese më poshtë.



Figura 1. Burimeve parësore dhe dytësore të të dhënave të përdorura

Më konkretisht, për mbledhjen e të dhënave parësore përmes teknikave me pjesëmarrjen e komunitetit, u përdorën ushtrimet e hartëzimit të nevojave dhe burimeve, intervista individuale dhe diskutime në grupe (të shoqëruara me vizita dhe vëzhgime në terren), ushtrime për zbërthimin e problematikave si "Matrica e problemit" dhe "Pema e problemit". Të dhëna parësore u mblodhën edhe nga Bashkia, veçanërisht në raport me kapacitetet e saj në funksion të planit për integrimin e romëve.

Me qëllim njohjen e thelluar të situatës konkrete në Bashkinë e Elbasanit, identifikimin e problemeve më kritike për pakicat rome dhe egjiptiane dhe prioritizimin e masave fillimisht shërbeu workshopi me lehtësuesit vendorë dhe anëtarë të grupit institucional të punës më 22 Shkurt 2019 në Tiranë, dhe më tej takimi me grupin e punës dhe nëpunës publikë të Bashkisë më 28 Shkurt 2019, si dhe takimi me komunitetin rom dhe egjiptian më 28 Shkurt 2019.

Në funksion të mbledhjes së të dhënave, u përdorën disa instrumenta si 'analiza e rrjedhës së shkaqeve', pema e problemeve dhe krijimi i hartës së nevojave si dhe pyetsorë për vleresimin e kapaciteteve institucionale të Bashkisë dhe institucioneve të tjera vendore në fushat relevante dhe prioritare të shërbimeve publike jetike për dy komunitetet. Gjithashtu, puna për mbledhjen e të dhënave dhe analizës së situatës, përveç takimeve me fokus grupet dhe specialistët e shërbimeve sociale e të planifikimit të buxhetit u bazua në një konsultim me dokumentat strategjikë të miratuar nga Bashkia si planet e zhvillimit, PPV, buxheti për 2019, planin buxhetor afatmesëm (PBA).

IV. Analiza Situacionale Vendore

Bashkia Elbasan mbas reformës territoriale dhe administrative (RAT) ka një popullsi prej 141,714 banorë[16], ndërsa sipas Regjistrit Civil popullsia llogaritet në nivelin e 212,628 banorëve[17]. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 872.03 km^2 dhe përbëhet nga 12 njësi administrative[18]. Për të rritur aksesin dhe cilësine e shërbimeve, janë ngritur zyrat me një ndalesë në të gjitha NJA-të ku ofrohen rreth 100 shërbime. Nëpunesit vendore kanë marrë pjesë në programe të ndryshme trajnimi si legjislacionin për nëpunësin civil, të drejtat e njeriut, gratë dhe drejtimi (leadership) të cilat janë ofruar nga ASPA dhe programe të donatorëve: UNDP, GIZ, Save the Children, OSFA, etj.

Treguesi i varfërisë së rajonit është në nivelin e 11,3% krahasuar me 14,3% që është niveli mesatar kombëtar[19]. Sektorë potencialë të zhvillimit ekonomik janë industria e përpunimit të metaleve, prodhimi i materialeve të ndërtimit (çimento, etj), shërbimet, transporti dhe bujqësia. Industria, sektori i shërbimeve, ndërtimi e bujqësia janë sektorët kryesorë për ekonomine e rajonit. Sektori mineral (miniera e hekur-nikelit) është një tjetër potencial për zhvillimin e ekonomise lokale.

Në Bashkinë Elbasan operojnë më shumë se 11,000 entitete biznesi, nga të cilat 308 janë kompani me 10-49 punonjës, dhe rreth 70 kompani me më shumë se 50 punonjës[20]. Në vitin 2018 janë krijuar dhe operojnë 70 biznese të mëdhenj dhe 1870 biznese të vogla të hapura rishtas[21].

Në territorin e Bashkisë Elbasan kalon rruga kombëtare pjesë e korridorit të VIII-të, si dhe linja hekurudhore Tiranë – Pogradec. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore gjatë viteve të fundit, ka rritur nivelin mesatar të lëvizëshmërisë (trafikut) me 6.6%[22]. Pavarësisht progresit, investime të tjera janë të nevojshme për zhvillimin e infrastrukturës rrugore të zonave rurale dhe përmirësimin e standardeve të rrugëve. Rreth 36.5% është niveli i rrjetit rrugor urban ekzistues në territorin e bashkisë, i cili është në përputhje me standardet ligjore të ndërtimit të rrugëve, ndërsa vetëm 6.6% i rrjetit rrugor rural ekzistues sipas standardeve[23]. Ndërkohë, 99% e te gjithë fshatrave të bashkisë (116 gjithsej) janë të lidhura me qendrën e Bashkisë, e cila ka kryer inventarizimin e rrjetit rrugor ekzistues dhe ka hartuar projekte me impakt për zhvillimin e territorit.

---

[16] Sipas Census te vitit 2011
[17] http://elbasani.gov.al/sq-al/Qyteti/Pages/levizjademografike.aspx
[18] www.elbasani.gov.al
[19] Burimi: INSTAT – Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës
[20] Burimi: Dhoma e Tregtisë, Raport mbi studimin e punësimit të rinjve (Save the Chidren, 2016)
[21] Burimi: Bashkia Elbasan
[22] Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
[23] Burimi: Treguesit e performancës së Bashkive në kuadër të projektit "Bashkitë për Evropë".

Në vitet e fundit (2017-20018) kanë përfunduar disa projekte zhvillimi në infrastrukturë dhe mjedis (menaxhimi i mbetjeve) si: ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan; studim, projektim, zbatim i punimeve në aksin rrugor Elbasan – Gjinar; inceneratori i Elbasanit, etj.

Tabela 2. Investime të përfunduara në vitin 2018, Bashkia Elbasan

Autoriteti	Emri i projektit	Plan në SIFQ	Realizimi në % deri në 31.12.2018
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve	Rikonstruksion i Ujësjellësit të lagjes " 28 Nëntori" dhe " Skënderbeu " në qytetin e Elbasanit	N/A	100%
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Riveshje sistemim asfaltim rruga Elbasan-Banjë, Loti 1&3	N/A	100%
Aparati Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	Rikonstruksion shkolla e AMP "Ali Myftiu", Elbasan	N/A	100%

Burimi: MFE

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në vitin 2018 janë rritur me 7.2% krahasuar me vitin 2017 dhe kanë qenë në nivelin 642,180,000 lekë.

Administrata

Këshilli Bashkiak si organ vendimmarrës kolegjial dhe përfaqësues i Bashkisë përbehet nga 51 anëtarë, nërsa numri total i nëpunësve vendorë të Bashkisë është 458. Bashkia Elbasan është pjesë e programit të transparencës; rreth 24 takime në procesin e hartimit të Buxhetit për vitin 2019, të cilat janë organizuar nga Bashkia / Drejtoria e Politikave Strategjike, Inovacionit dhe Medias në koordinim me drejtoritë e tjera në vitin 2018 (shkalla e pjesëmarrjes rreth 4456 qytetarë[24]). Bashkia publikon në faqen e internetit buxhetin e saj. Përmes tij ajo ka mbështetur organizata jo-fitimprurëse nëpërmjet dhënies së granteve, në vitin 2018 për zbatimin e 4 projekteve me impakt social në territorin administrativ të saj[25].

Në nivel vendor janë miratur pesë dokumenta të politikave si: Plan i Përgjithshëm Vendor (PPV), Strategjia e Zhvillimit, Plani për Mbrojtjen Sociale, 2017-2022, Plani i Vepirmit për Barazinë Gjinore (2018-2020), Plani Strategjik Anti-korrupsion. Më shumë se 30 fisha të projekteve të reja janë hartuar për t'u financuar nga fondi i zhvillimit të Rajoneve dhe projekte me financim të huaj[26], në fusha të tilla si: rehabilitimi i rrugëve, ura dhe energji, ndërtimi të

[24]Burim: Bashkia Elbasan
[25] Fond prej 1,700,000 ALL
[26] Burimi: http://elbasani.gov.al/sq-al/Bashkia/Pages/projekteprioritare.aspx

tregjeve për grumbullimin / përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, rehabilitim të zonës industriale (zona e metalurgjikut), menaxhim të zonave të lumit Shkumbin e Zaranikë, rehabilitim të parkut të qytetit (në proces), rehabilitim të fushës së mbetjeve, etj.

Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar (DSHSK) si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik e Strategjik është një strukturë e rëndësishme e Bashkisë,e cila përbëhet nga disa zyra (sektorë) kryesorë: Sektori i mbrojtjes së fëmijëve dhe barazisë gjinore, Sektori i shtresavë në nevojë dhe moshës së tretë, Sektori i mbrojtjes sociale, PAK dhe Ndihmës ekonomike si dhe nga dy njësi: "Njësia e Vleresimit të Nevojavë të Referimit të Rasteve" dhe "Njësia e Operatorëve Socialë për Asistencën Shtëpiake". Për hartimin e matricës së shërbimeve dhe vlerësimit dhe statistikave në nivel vendor, rol të rëndësishëm luan edhe Drejtoria e Politikave Strategjike, Inovacionit dhe Medias në Bashkinë e Elbasanit, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit ka mundësuar sigurimin e konsultimeve në procesin e planifikimit te buxhetit dhe buxhetimit gjinor me pjesëmarrje për 2015-2018 në lagjen "5 Maj" dhe zona të tjera:

- Rikonstuksion dhe ndërtim të banesave të pakicave rome dhe egjiptiane.
- Vazhdimi i ndërtimit të KUZ-se në lagjen: "5 Maj" (tek Teqja).
- Ndërtim KUZ pranë shkollës "Sul Domi ", KUZ në Harmas dhe KUZ tek Ara e Prasit (Rr."Arif Dardha")
- Ndërtimii KUZ tek lagja e romëve, Rrapishtë

Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndihmës Ekonomike është 26 (7 nëpunës më shumë krahasuar me vitin 2017), si dhe 18 administratorë socialë të trajnuar për përdorimin e kurrikulave të reja për lehtësimin e aksesit në shërbime për romët dhe egjiptianët. Bashkia ka nënshkruar dy Memorandume të Mirëkuptimit me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) që ofrojnë shërbime në komunitet në vitin 2018.

Stafi i drejtorisë së shërbimit social ka përfituar nga programe trajnimi në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve për implementimin e sistemit të ri të ndihmës ekonomike (NE) gjatë viteve 2017-2018, trajnime për shërbimet e integruara, të drejtat e njeriut, menaxhimi dhe përditësimi i sistemit ROMALB. Nëntë (9) nëpunës vendorë janë trajnuar në lidhje me politikat kombëtare dhe masat e planifikuara për mbrojtjen sociale e statistikat sociale sipas standardeve të BE-së, në vitin 2018. Fondi vendor i planifikuar për shpenzime të kujdesit social kundrejt buxhetit të Bashkisë ka qenë 9.6% pëgjatë këtij viti.

Bashkia Elbasan ka demonstruar vullnet politik për hartimin e planit vendor për integrimin e romëve dhe egjiptianëve me mbështetje të BE/KiE në kuadër të projektit ROMACTED, 2018-2020.

V. Pakicat Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Elbasan dhe Vlerësimi i Nevojave

Në Shqipëri, *romët dhe egjiptianët* janë komunitetet më në nevojë, niveli i varfërisë së këtyre pakicave është dy herë më i lartë krahasuar me shumicën e popullsisë.

Bashkia Elbasan është një nga bashkitë me përqendrim të lartë të pakicave rome dhe egjiptiane, krahasuar me qytete të tjera. Në Bashkinë Elbasan jetojnë rreth 8,460 romë dhe egjiptianë, nga të cilët 2,800 romë dhe 5,660 egjiptianë (ose rreth 1846 familje). Mosha mesatare e pakicës egjiptiane në Elbasan është 5 vjet më e re krahasuar me moshën mesatare të popullsisë së përgjithshme referuar censusit të 2011. Ndërsa përsa i përket gjinisë janë më shumë meshkuj, në masën 50.9% karahasuar me femrat që janë 49.1%[27].Komuniteti Egjiptian ka një shpërmdarje më të gjerë krahasuar me komunitetin rom, por zonat me përqëndrim më të madh janë në lagjiet: Beqir Dardha, Dyli Haxhire, Skënderbej, 5 Maji. 331 familje jetojnë në NJA: 147 familje në NJA Bradashesh, 138 familje në NJA Shushicë, 41 familje në NJA Papër, 3 familje në NJA Gjinar,2 familje në NJA Labinot Mal.

Pakica egjiptiane në Bashkinë Elbasan është e shpërndarë në të gjitha lagjet e qytetit, ndërsa pakica rome është vendosur në dy zona kryesore: *zona Rrapishtë* ku jetojnë rreth 400 familje (ose rreth 2800 individë)*; zona afër stadiumit* ku jetojnë rreth 100 familje (570 individë).

Fëmijët rome dhe egjiptianë ndjekin të njejtin program edukimi si fëmijët e maxhorancës së popullatës dhe infrastruktura e shkollave është përgjithësisht e mirë. Niveli i frekuentimit të shkollës nga fëmijet e grup-moshës 6 – 15 vjeç ka qënë rreth 261 fëmijë (nga të cilët 106 vajza) në vitin shkollor 2017-2018; 36 raste të braktisjes së shkollës janë evidentuar në vitin 2018 nga të cilët 11 fëmijë rom[28]. Niveli i ulët i frekuentimit të shkollës lidhet me disa faktorë si vështirësitë ekonomike të familjeve rome, kulturën dhe stilin e jetesës (si mungesa e një tradite të ndjekjes së shkollës në familje, jeta nomade, martesat e hershme etj).

Nuk ka raste të segregimit në shkolla, fëmijët romë dhe egjiptianë frekuentojnë të njëjta kopshte dhe shkolla së bashku me fëmijët nga maxhoranca e popullsisë. Në Bashkinë Elbasan nuk ndeshen probleme lidhur me regjistrimin civil, ka patur vetem raste të pakta të cilat menaxhohen nga shërbimet e bashkisë në bashkëpunim me aktorët e tjerë vendorë. Fëmijët romë dhe egjiptianë ndjekin të njejtin program edukimi, por nuk ka të dhëna cilësore mbi arritjet

[27]Burimi: Studim mbi rregjistrimin e popullsise Egjiptiane, 2016 Levizja Rinore Egjiptiane dhe Rome
[28]Burimi: Vëzhgim bazë të komunitetit rom në tetë bashki përfshirë Bashkinë Elbasan (KiE, 2017)

akademike (psh. kalueshmwria apo nota mesatare). Bashkia merr pjesë në bordet e institucionit arsimor dhe në takime me prindërit në shkolla ku zbatohet nisma "Bëjmë detyrat në shkollë".

Problem madhor është niveli i lartë i papunësisë. Si rrjedhojë e mungesës së përgjithshme të punësimit në Shqipëri, rreth 90% e romëve të rritur kanë vështirë të gjejnë një punë, kurse referuar studimit të vitit 2016[29], vetëm 13.9% e personave të rritur egjiptianë rezultuan të punësuar në tregun formal të punës[30]. Në Bashkinë Elbasan, rreth 1098 persona romë dhe egjiptianë kanë një të ardhur nga punësimi kryesisht në tregun informal, në zanate të traditës së tyre, si përpunimi i hekurit, grumbullimi i materialeve të ricikueshme, tregtimi i veshjeve të përdorura, punime me dorë, dhe disa zanate të tjera. Niveli ekonomik i familjeve rome është më i ulët se pjesa tjetër e popullsisë dhe pakicave të tjera.

Të dhënat e skemës së NE në bashki tregojnë se përqindja e familjeve rome përfituese të ndihmës ekonomike është më e lartë se ajo e familjeve të tjera jo-rome. Faktorët që ndikojnë varfërinë e tyre ekonomike janë: numri i lartë i anëtarëve të familjes, shkalla e lartë e papunësisë, sektorët e punësimit ose të vetëpunësimit të romëve nuk krijojnë të ardhura të mjaftueshme, mënyra e jetesës etj. Me gjithë politikat lehtësuese për t'i krijuar kushte për marrjen e një profesioni, kufizimet arsimore të romëve çojnë edhe në kufizime për të përfituar nga skemat nxitëse të punësimit[31]. Për vitin 2018, vetëm 9% e numrit të përgjithshëm të rinjve që kanë frekuentuar kurset e formimit profesional në Elbasan kanë qënë romë.

Në vitin 2018, rreth 107 romë dhe egjiptianë (79 romë dhe 28 egjiptianë) kanë qënë të përfshirë në punë komunitare, nga të cilët 67 gra dhe 40 burra[32]; rreth 344 romë dhe egjiptianë kanë përfituar nga shërbimet e ofruara nga organizata jo fitimprurëse të licencuara nga MSHMS në përputhje me programet e miratuara dhe Memorandumet e Mirëkuptimit me qeverisjen vendore.

Numri i punëkërkuesve të papunë, që mbulohen nga fondi i bashkisë në kuadër të skemës së NE ka qënë 120 për vitin 2018. Punësimi i një personi rom ose egjiptian në zyren e punës ose në Bashki do të lehtësonte ndërmjetësimin midis punëkerkuesit, zyrës së shërbimit dhe bizneseve lokale.

Në Bashkinë Elbasan, ka rreth 6 vite që bashkia është angazhuar me ndërtimin dhe shpërndarjen e banesave sociale, ashtu si edhe me realizimin e disa projekte rikonstruksioni të banesave ekzistuese. Ndonëse Bashkia Elbasan ka lobuar pranë donatorëve për bashkëfinancim në plotësimin e disa nevojave specifike të pakicave rome dhe egjiptiane, si CRCA, GTZ, Roma

---

[30] [30]Burimi:Studimi mbi popullsinë Egjiptiane, 2016, Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome, Ambasada Suedeze dhe Civil Rights Defenders

[31]Burimi: Plani Për Mbrojtjen Sociale (2017-2022), Bashkia Elbasan

[32] Burimi: Bashkia Elbasan, sistemi ROMALB (2018)

Education Fund, Agjencinë e Zhvillimit të Rajoneve, ekziston hendek i konsiderueshëm midis nevojave të pakicave rome dhe egjiptiane dhe burimeve financiare të Bashkisë.

Tabela 3. Problemet dhe Nevoja për Ndryshim sipas gjetjeve në Fokus Grup të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Elbasan

Probleme	Nevoja / Ide për ndryshime
o Ka anëtarë të pakicave pa karta identiteti o Punësimi i pjesëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane në nivele të ulta o Braktisja e shkollës pa përmbushur arsimin 9-vjeçar. o Qendra e formimit profesional është larg vendbanimit të pakicave. o Vendet për të tregtuar rrobat e përdorura janë të pamjaftueshme. o Fëmijët e pakicave nuk kanë hapësira argëtimi. o Mungojnë kanalizimet në disa zona të lagjes « 5 Maj – Rrapishtë », asfaltimi dhe ndriçimi i lagjes "5 Maj-Rrapisht". o Banesa në kushte të vështira. o Rreth 180 familje egjiptiane jetojnë në basesa të dobta që kanë nevoje për rikonstruksion. o Mbi 50% e familjeve në kushte me 2 ose më shumë kurora në njëjtën banesë. o Probleme me blerjen e ilaçeve për shkak të pamundësisë financiare. o KUZ tek shkolla Hamit Mullisi o Lindjet në moshë të hershme o Migrimi	o Punësim sezonal në projektet infrastrukturore që zbaton Bashkia Elbasan dhe punësimi në programet e Zyrës së Punës. o Integrimi urban i zonës Rrapishtë. o Ndërgjegjësim i komunitetit nga institucionet dhe OJF-të. o Ritja e buxhetit të Bashkisë Elbasan dedikuar programit të Bonusit të Strehimit, në mënyrë që të subvencionohen në pagesën e qerasë më shumë familje. o Miratimi i buxhetit të Bashkisë Elbasan për programin e "Përmirësimit të banesave ekzistuese" në mënyrë që 20% e buxhetit të këtij programi që mbulohet nga bashkia qëtë jetë I mjaftueshëm për më shumë se 50 familje në vit. o Krijimi i fondit social të banesave, në zbatim të ligjit të ri të strehimit. o Të përshpejtohet procesi i legalizimit të banesave të pakicave rome dhe egjiptiane që janë në tejkalim të afateve ligjore. o Mbështetje nga Bashkia për të mundësuar transportin e të interesuarve për kurse të formimit profesional pranë DRAFP, Elbasan. o Hapja e një tregu të ri. o Ndërtimi i një parku lodrash pranë Lagjes "5 Maj – Rrapishtë". o Përmirëesimi i sistemit të kanalizimeve së zonës së banimit në Lagjen 5 – Rrapishtë. o Përmirësimi i kushteve të banimit (banesat e komunitetit rom). Krijimi i një ambjenti të gjelber dhe kendi lojrash për fëmijët. o Hapja e një salle interneti. o Mbështetje financiare për aktivitetet që zhvillohen nga qendra komunitare. o Kurse dhe trajnime për stafin e qendrës. o Ofrimi i një vakti ushqimor për fëmijët.

Vlerësimet e nevojave sipas fushave prioritare

Arsimi

Romët dhe egjiptianët në Shqipëri gëzojnë statusin e pakicave kombëtare dhe si të tilla ato duhet të gëzojnë edhe të drejtat që u lindin në fushën e arsimit. Fëmijët romë dhe egjiptianë kanë përqindje të ulët të regjistrimit në shkollë dhe përfundimit të shkollës krahasuar me mesataren kombëtare. Rreth 40,3% e romëve dhe 12,7% e egjiptianëve janë analfabetë, ndërsa mesatarja kombëtare është vetëm 1,6%[33]. Një nga qëllimet strategjike të PKVIRE 2016-2020 është që romët dhe egjiptianët të gëzojnë akses dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.

Një numër i madh nxënësish romë braktisin arsimin e detyruar si pasojë e mungesës së mbështetjes së nevojshme në shkollë, për shkak të nevojës për të ndihmuar familjen me të ardhura, por edhe si pasojë e diskriminimit.[34] Mjaft familje rome që përballen me përjashtimin social, besojnë se vajza e tyre do të jetë më e mbrojtur nëse e braktis shkollën në vitet e para të adoleshencës dhe përgatitet për të krijuar familjen e saj[35].

Bashkia Elbasan ka 109 kopshte me kapacitet prej 4451 fëmijë, nga të cilat 16 kopshte publike në qytet, 13 klasa përgatitore, 73 kopshte në njësi administrative të cilat janë lokalizuara brenda dhe jashtë godinave të shkollave, si dhe 8 kopshte private. Shkalla e rregjistrimit të fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në kopshte është 26% kundrejt numrit total të fëmijëve në Bashkinë Elbasan në vitin 2018. Rreth 84 fëmijë romë dhe egjiptianë të grup-moshës 3-5 vjeç kanë ndjekur kopshtet dhe sistemin parashkollor në vitin 2018[36].

Në territorin e Bashkisë Elbasan funksionojnë gjithsej 91 shkolla 9-vjeçare publike dhe jopublike, nga të cilat vetëm 5 shkolla frekuentohen nga një numër i konsiderueshem fëmijësh romë dhe egjiptianë. Infrastruktura shkollore është përgjithësisht sipas standardeve, përveç rastit të shkollës "Hamit Mullisi" e cila ka nevojë për rikonstruksion total. Ndërkohë projekte të reja janë në fazë përgatitje për 6 shkolla 9-vjeçare ne disa njësi administrative, një shkollë profesionale dhe dy shkolla në qytet. Bazuar në të dhënat e "Vëzhgim bazë të KiE, 2017", rreth 261 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç kanë frekuentuar rregullisht shkollën, nga të cilët 106 vajza në vitin shkollor 2017-2018; 36 raste të braktisjes së shkollës janë evidentuar në vitin 2018, nga të cilët 11 fëmijë rom.

[33]Burim: Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Raportii Monitorimit (2017)
[34] Sipas studimit të OSFA-s, 4% e fëmijëve të moshës 6-17 vjeç janë të angazhuar në punë të ndryshme.
[35]Sipas anketës social-ekonomike të vitit 2011, 31% e vajzave rome dhe 13,6% e vajzave egjiptiane midis moshës 13 - 17 vjeç ishin të martuara.
[36]Burimi: Bashkia Elbasan

Tabela 4. Mbi frekuentimin e sistemit parashkollor dhe arsimit të detyrueshëm, në Bashkinë Elbasan (2018)

	Gjithsej	Vajza	Djem	Romë	Egjiptianë
Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin rregullisht çerdhet	3	1	2	-	-
Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të përjashtuar nga tarifat për ndjekjen e arsimit parashkollor	64	37	39	76	0
Numri i fëmijëve romë dhe Egjiptianë të mbështetur nga mësues dhe ndihmës per detyrat e shtëpisë (për vitin shkollor 2017-2018)	266	N/A	N/A	91	175
Numri i nxënësve dhe studentëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë bursa në nivele të ndryshme arsimore (mbi 18 vjeç)	52	8	44	0	52
Numri i grave rome dhe egjiptiane që punojnë në pozicione ndihmëse në arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrueshëm	8	8	-	1	7

Burimi: Bashkia Elbasan

Bashkia në bashkëpunim me DAR ka ndërmarrë 3 fushata ndërgjegjësimi ndaj prindërve për përfshirjen e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor. Fondi i investimit vendor për ndërtimin ose rikonstruksionin e kopshteve dhe çerdheve ekzistuese ka qënë 0.1% e buxhetit vendor për vitin 2018 (2 milion lekë); fondi vendor për të siguruar përfshirjen në regjistrimin dhe ndjekjen e shkollës të arsimit bazë nga fëmijë të grupeve të marxhinalizuara (rome dhe egjiptiane) ka qënë rreth 0.1% e buxhetit vendor për sektorin e arsimit;; fondi i investimit vendor për ndërtimin e shkollave të reja dhe rikonstruksionin e shkollave ekzistuese ka qënë 1.7% e buxhetit vendor.

Gjatë viteve të fundit, Bashkia raporton se janë ndërmarrë disa masa lehtësuese nga qeveria si përfshirja e teksteve shkollore dhe transporti falas për fëmijët që ndjekin arsimin e detyrueshëm, vizitat në shtëpi, ndihmën me detyrat e shtëpisë, mësimin e gjuhës dhe seminare për prindërit. Megjithatë, kjo nuk u raportua nga përfaqësues të pakicave rome dhe egjiptiane gjatë procesit tëvlerësimit të nevojave. .

Shëndetësia

Përceptimet e pakicave rome dhe egjiptiane janë se shërbimi shëndetësor dhe aksesueshmëria e këtyre komuniteteve në këto shërbime është përgjithësisht e mirë. Elbasani ka 53 Qendra Shëndetësore, nga të cilat 4 janë në qytet dhe 49 në zonat e tjera administrative. Numri i punonjësve të shëndetësisë të qëndrave dhe spitalit publik është 581. Bashkia Elbasan nuk ka qendra shëndetësore të cilat të jenë në një distancë më të madhe se 5 km nga zonat me përqëndrim të lartë të komunitetit rom dhe egjiptian.

Pothuajse të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë jane vaksinuar me të paktën tre dozat bazë (vaksinat deri në gjashtë muajt e parë të lindjes), por problem mbetet vaksinimi jo i rregullt i tyre me keto vaksina në periudhat pasuese[37].

Punësimi

Varfëria mund të shprehet si një akses i pamjaftueshëm dhe formë deprivimi nga shërbimet, burimet dhe mjetet e vlefshme për shumicën e popullatës, ose si pamundësi per të përfituar maksimalisht nga sherbimet publike. Dy kanë qenë masat kryesore të ndërmarra nga qeveria për integrimin e romeve dhe egjiptianeve në jetën ekonomike të vendit: (i) integrimi i pakicave rome dhe egjiptiane në tregun e punës nëpërmjet formimit profesional dhe programeve aktive të punësimit , (ii) nxitja dhe mbështetja për krijimin e bizneseve të reja, nxitjes së vetë-punësimit dhe formalizimit të punës.

Në nivel kombëtar, rreth 880 romë dhe egjiptianë janë punësuar nga zyrat e punës në vitin 2017, përfshirë individët që kanë qenë pjesë e programeve të nxitjës së punësimit, si dhe nëpërmjet ndërmjetësimit[38]; 83 studentë R&E janë këshilluar për të lehtësuar hyrjen dhe integrimin në tregun e punës.

Sipas statistikave në nivel bashkie rezultojne rreth 1098 romë dhe egjiptianë të punësuar, nga të cilët 314 janë gra. Ndërkohë, OSHC-të dhe përfaqësues të këtyre komuniteteve nuk i konfirmojnë këto shifra. Numri i të papunëve që marrin ndihmë ekonomike të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional ka qënë 140 në vitin 2018[39]. Numri i hapësirave të caktuara tregtare të përdorura nga romët dhe egjiptianët është tre (3) në Bashkinë Elbasan. Përgjithësisht, pretendohet se pakicat rome dhe egjiptiane nuk kanë interesim të vazhdueshëm dhe periodik për aksesuar shërbimet e punësimit që ofrohen pranë

[37]Burim: Plani i Veprimit te Mbrojtjes Sociale të Bashkisë Elbasan, 2016-2020
[38]Burimi: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Raporti i Monitorimit (2018)
[39] Burimi:Bashkia Elbasan

Zyrave të Punës dhe për të kuptuar përfitimet që rrjedhin nga regjistrimi si punëkërkues i papunë në programet e nxitjes së punësimit apo për orientim drejt kurseve të formimit profesional. Kjo bie ndesh me procesin dhe kushtet për përfitimin e NE që kërkon shprehjen e vazhdueshme të interesit për punësim.

Tabela 5. Të dhëna mbi punësimin e romëve dhe egjiptianëve, Elbasan 2018

	Gjithsej	Gra	Burra	Romë	Egjiptianë
Punëkërkues të regjistruar në zyrat e punës	864	N/A	N/A	466	398
Numri i personave të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	66	N/A	N/A	N/A	N/A
Numri i personave të regjistruar si punëkërkues të papunë dhe të punësuar nëpërmjet Shërbimit të Punësimit (DRSHKP, Elbasan)	44	N/A	N/A	N/A	N/A

Burimi: Drejtoria Rajonale e Punësimit Elbasan

Numri i të rinjve romë që frekuentojnë kurset e formimit profesional është i ulët, nga 34 të rinj (12 femra) të regjistruar në shërbimin e arsimit të formimit profesional[40] për vitin 2018, janë vetëm 3 të rinj romë (ose 9%). Kurset e ndjekura pranë qendrës rajonale të formimit profesional në Elbasan kanë qenë për profesione të tilla si: ndërtim, saldim, berber, parukeri, rrobaqepsi, kujdes ndaj moshës së tretë, guzhinier, mekanike-auto. Statistikat e DRAFP në Elbasan evidentojnë që 29% e të rinjve janë skualifikuar, 29% kanë përfunduar me sukses kurset e formimit profesional dhe janë certifikuar, ndërsa të tjerët janë në ndjekje të kurseve.

Mbrojtja Sociale

Organizimi i shërbimit social në nivelin vendor realizohet mbi bazën e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, 2015 -2020[41] dhe parimeve kryesore si e drejta civile, barazia dhe mosdiskriminimi, mbrojtja për grupe të veçanta, përfshirë fëmijët bazuar në nevojat e tyre, e drejta e jetës dhe zhvillimit, pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve, përfshirja dhe

[40]DRAFP, Elbasan

[41]Tre shtyllat kryesore të strategjisë jane (i) Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dheindividëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, përmirësimin e shenjëstrimit të tyre, rritjen etransparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndihmës Ekonomike, si dhe lidhjen me shërbime të integruara dhe skemat e punësimit, me qëllim integrimin social të tyre, (ii) Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, nëpërmjet vlerësimit biopsiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në cash me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike, (iii) Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet Mbrojtjes Sociale, si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes se plotë dhe efektive në shoqëri.

integrimi mbi bazën e respektimi i të drejtave dhe nevojave të njeriut, sigurimi i partneritetit me institucionet qëndrore, komunitetet dhe organizatat e shoqërisë civile dhe sigurimi i standardeve kombëtare të shërbimit.

Në Bashkinë Elbasan është kryer vlerësimi i nevojave për shërbime sociale dhe i kapaciteteve të institucioneve vendore për të adresuar parime thelbësore duke ju referuar nevojave dhe specifikave lokale të Bashkisë Elbasan, si pjesë e hartimit të Planit Vendor për Mbrojtjen Sociale, 2017-2022.Numri i ekipeve të lëvizshme të Drejtorisë të Kujdesit Social dhe Komunitar në monitorimin dhe vlerësimin e nevojave në terren është gjashtë (6).

Në Elbasan funksionojnë 11 qendra që ofrojnë shërbime të kujdesit social përfshirë një qendër për fëmijët me autizëm të cilat ofrojnë shërbime për katër kategori të cenueshme: fëmijët, mosha e tretë, PAK dhe pakicat. Rreth 315 persona kanë përfituar nga shërbimet e qendrave të kujdesit social në vitin 2018, prej të cilëve 200 fëmiëe, 85 të moshuar dhe 30 PAK[42], ndërsa numri i qendrave komunitare që ofrojnë shërbime të integruara të kujdesit social janë 2. Në vitin 2018, rreth 187 persona kanë përfituar nga këto dy qendra të integruara, 127 romë dhe 60 egjiptianë (134 gra, 53 burra).

Rreth 6,536 persona me aftesi të kufizuar (PAK) kanë përfitur nga skema e mbrojtjes sociale (ose 780 persona më shumë se viti 2017); 12 të moshuar janë strehuar në shërbimin rezidencial.

Tabela 6. Të dhëna mbi NE dhe programin e mbrojtjes sociale, Bashkia Elbasan (2018 dhe 2019)

	Gjithsej	Gra	Burra	Romë	Egjiptianë
Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë ndihmë ekonomike (2019)	631	-	-	158	473
Numri i individëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë ndihmë ekonomike (2019)	2262	986	1276	608	1654
Numri familjeve rome dhe egjiptiane që kanë përfituar bonusin për shpërblimin e lindjes (2018)	13			7	6
Numri i familjeve të përfshira në skemën e NE që përfitojnë edhe nga shërbime të tjera falë referimit nga administratori social (2018)	215	-	-	106	109
Numri i romëve dhe egjiptianëve në rrezik të informuar rreth rreziqeve të trafikimit të qenieve njerëzore, shërbimeve të disponueshme për viktimat e mënyrave për promovimin e riintegrimit të tyre (2018)	217	136	81	125	92
Numri i organizatave rome dhe egjiptiane të licencuara dhe/ose që kanë	5	-	-	4	1

[42]Burim: Bashkia / Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar (Mars 2019)

Memorandum Mirëkuptimi me NJQV për ofrimin e shërbimeve në komunitet (2018)					

Burimi: Bashkia Elbasan, sistemi ROMALB

Familjet më të varfra që nuk përmbushin kriteret e skemës së NE janë subjekt i vendimmarrjes së Bashkisë për t'u përkrahur në kuadër të fondit prej 6% të skemës së NE. Punonjesit socialë të Sektorit të NE kryejnë vizita në terrën për familjet/individët që kanë dalë nga skema, përfshirë romë dhe egjiptianë dhe ofrojnë asistencë në plotësimin e formularit dhe dokumentacionit gjatë procesit të aplikimit.

Qendra komunitare

Qendra komunitare në zonën e Rapishtës, ofron shërbime asistence për 45 fëmijë në përgatitjen e detyrave si dhe për fëmijë që e kanë braktisur shkollen. Këta të fundit janë pjesë e aktiviteve ndërgjegjësuese, kulturore dhe artistike, veprimtarive sportive, për edukimin qytetar dhe shëndetësor. Rreth 61 fëmijë të grup-moshës 3- 6 vjeç frekuentojnë kopshtin, qw funksionon nw tw njwjtwn strukturw me Qendrwn Komunitare. Gjatë 3 viteve të fundit, qendra komunitare nuk ka pasur donatorë dhe asistencë [43].

Strehimi dhe infrastruktura urbane

Bashkia Elbasan ka burime njerëzore për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve për përmirësimin e banesave si dhe për projekte zhvillimi të infrastrukturës urbane. Ajo ka përgatitur disa studime fizibiliteti dhe fisha projekti, por burimet financiare të Bashkisë janë të kufizuara dhe nuk plotësojnë nevojat për përmirësimin e banesave të identifikuara si problematike si dhe ndërtimin e banesave sociale. Ligji për strehimin social[44] përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe shpërndarjes së banesave sociale. Sipas ligjit, Bashkia duhet të financojë 20% të fondit të nevojshëm për projekte rehabilitimi/rikonstruksioni dhe ndërtimin e banesave sociale si bashkëfinancim në aplikime pranë MFE, në kuadër të programeve për strehimin social.

Tabela 7. Përmirësimi i banesave dhe projekte të integrimit urban për periudhën 2016-2019 (në Lekë)

Projekti	Fondi	Viti	Burimi i financimit	Statusi	Numri i familjeve përfituese
Përmirësimi i kushteve të banimit të romëve	30,427,631	2019	Qeveria / FSHZH	??	N/A

[43]Burimi: Qendra Komunitare ne zonën e Rrapishtës
[44] Ligji për Strehimin Social Nr. 22/2018

Ndërtimi i KUZ-ve tek lagja Rrapishtë/L.6	4,185,422	2018	Qeveria	Përfunduar	400 familje rome
Sistemim asfaltim i rrugës Nusret Kokobobo dhe i shesheve të pallateve nr. 60, 61, 62 63/1, 64/3, lagjja Emin Matraxhiu, Elbasan/ L.1	42,340,034	N/A	Qeveria	Përfunduar	N/A
Sistemim-Asfaltim rruga "Ahmet Hastopalli dhe sheshet e pallateve" , Lagja "Beqir Dardha / L.1	20,637,016	N/A	Bashkia	Përfunduar	N/A
Ndërtimi i rrugës "Sule Domi" (vazhdim), nga lokali Rexhep Kukës deri tek ura e sektorit, Lagja "5 Maji"/L.6	10,017,200	N/A	Bashkia	Përfunduar	N/A
Vazhdim i ndertimit te KUZ-se në lagjen: "5 Maj" (tek Teqja)/L.6	7,980,000	N/A	Bashkia	Përfunduar	N/A
Ndërtim i 4 mjediseve sportive në shkollat e qytetit Elbasan: Shkollat: Sul Harri, Adem Krasniqi, Naim Frasheri dhe Abdyl Paralloi.	9,957,081	N/A	Bashkia	Përfunduar	Përfitues edhe nga pakicat rome dhe egjiptiane
Zbatimi i katër projekteve me impakt social	1,700,000	2018-2019	UNDP/Bashkia/OSHC	Në proces	N/A

Në kuadër të programit të strehimit social nëpermjet financimit të bonusit të qerase kanë përfituar gjithsej 24 familje rome dhe egjiptiane, nga të cilat 7 familje rome dhe 17 familje egjiptiane në vitin 2018.

Problematikë e vështirë janë kushtet e banesave të familjeve që jetojnë në zonën e *Rrapishtës* ku jetojnë 400 familje rome. Ndonëse Bashkia ka realizuar në vitet e fundit një ndërhyrje për përmiresimin e disa banesave, mbetet problematike cilesia e dobët e banesave, infrastruktura e ujësjellës-kanalizimeve, infrastruktura rrugore dhe ndricimi i rrugëve. Rreth 289 familje rome kanë aplikuar për legalizimin e pronës (procesi është në vijim), 23 familje rome jetojnë në banesa të pa legalizuara[45].

Në Njësinë Administrative Bradashesh: rreth 50 familje kanë probleme me marrjen e dokumentit të pronësisë. Këto familje jetojnë në pallatet e ndërtuara nga ish-punëtorët e Kombinatit Metalurgjik (vitet 1980).

Në Lagjen "Dyli Haxhire", Rruga "Ilir Shehu" jetojnë mbi 100 familje të komunitetit egjiptian, ku 50 familje përballen me mungesën e furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm në pjesën e sipërme të rrugës. Gjithashtu, ka probleme me rrugën kryesore e cila është e amortizuar, pa asfalt dhe ndricim, si dhe vonesa në procesin e legalizimit të pronës.

Në lagjen "Skënderbej", tek stacioni i trenit jetojnë mbi 100 familje të komunitetit egjiptian që jetojën në banesa me probleme, infrastrukturë e dobët e zonës së banimit, dhe me probleme të furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e verës.

Regjistrimi civil

Problem i përbashkët në shkallë vendi është mungesa e statistikave të sakta (të dhënat janë indikative) për sa kohë pranohet që kemi fëmijë romë të paregjistruar në gjendje civile dhe për sa kohë nuk ekziston një listë e plotë për fëmijët romë 3-5 vjeç. Në Bashkinë Elbasan raportohet se 25% e romëve nuk kanë dokumenta të identitetit[46].

Tabela 8. Regjistrimi i romëve dhe egjiptianëve, Bashkia Elbasan

	Gjithsej	Vjaza/Gra	Djem/Burra	Romë	Egjiptianë
Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të lindur dhe të identifikuar si të paregjistruar	76	37	39	76	0
Numri i personave të cilëve nuk u përputhet vendbanimi sipas zyrës së gjendjes civile me banimin real	0	-	-	-	-

[45]Burimi: Vëzhgim i KiE në tetë bashki (2017)
[46] Burimi: KiE, Vëzhgim bazë për romët dhe egjiptianët (2017)

VI. Vizioni dhe Objektivat e Planit Vendor

Vizioni: Rritja e aksesit në shërbimet publike nëpërmjet heqjes së vazhdueshme të barrierave për romët dhe egjiptianët gjatë katër viteve të ardhëshme, do të sjellë një shëndet më të mirë, një arsimim më të plotë, rritje së mirëqenies nëpërmjet punësimit formal e si pasojë integrimit të plotë të pakicave rome dhe egjiptiane.

Qëllimet Strategjike:

- Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët.

Synimi: Në fund të vitit 2020, 100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civile.

- Romët dhe egjiptianët të gëzojnë akses dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.

Synimi: Në fund të vitit 2020, 70% më shumë djem dhe vajza të kpakicave rome dhe egjiptiane arrijnë të përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit dhe 100% përfundojnë arsiminparashkollor.

- Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve.

Synimi: 80% më shumë gra dhe burra romë dhe egjiptianë të cilët marrin pjesë në AFP dhe programet aktive të punësimit do të integrohen në tregun e punës deri në fund te vit20.

- Garantimi i një kujdesi mjekësor të aksesueshëm, të përballueshëm dhe të barabartë për romët dhe egjiptianët.

Synimi: 100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë mundësi të përdorin shërbimet bazë shëndetësore deri në fund të vitit 2020.

- Përmirësimi i kushteve të strehimit për romët dhe egjiptianët.

Synimi: 80% e familjeve rome dhe egjiptiane, të cilët kanë iniciuar procedurat e legalizimit, i kanë përfunduar ato me sukses deri në fund të vitit 2020.

- Rritja e aksesit në programet e mbrojtjes sociale për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane.

Synimi: 30% më shumë e anëtarëve *të pakicave rome dhe egjiptiane do të jenë të përfshirë në programet e mbrojtjes sociale deri në fund të vitit 2020.*

VII. Plani i Masave

Fusha e ndërhyrjes: Akses i Barabartë në Regjistrimin Civil dhe në Drejtësi						
Objektivi specifik: Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe Treguesi i Objektivit: Përqindja e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civi fund të vitit 2020.						
Masa/Aktiviteti	**Aktorët**	**Treguesit e rezultateve**	**Burimet e të dhënave**	**Afatet**	**Fondet/Financimi**	**Monitorimi**
1.1.1 Dhënia e ndihmës për marrjen e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit	Zyra e Gjendjes Civile (ZGJC), NJMF dhe organe të tjera relevante	Baza e referimit – viti 2018. Indikator të matshem Çdo vit.	Raport i paraqitur nga ZGJC në Bashki	Çdo 6-mujor	2,400,000	Drejtoria e S Social (DSH Bashki
1.1.2 Raportimi pranë zyrave të gjendjes civile i fëmijëve të paregjistruar, përfshirë ata që janë lindur brenda dhe jashtë institucioneve shëndetësore	Zyra e Gjendjes Civile, NJMF dhe organe të tjera relevante, Dega e Policisë së Shtetit	Indikator të matshem Çdo vit.	Raport i paraqitur nga ZGJC në Bashki	Çdo 6-mujor	320,000	Drejtoria e S Social (DSH Bashki
1.1.3 Regjistrimi dhe zgjidhja, përmes zyrave të gjendjes civile, i rasteve të individëve të paregjistruar, të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm.	ZGJC	Baza e referimit (2018, 76 raste të fëmijeve romë të pa regjistruar	Raport i paraqitur nga ZGJC në Bashki	Çdo 6-mujor	1,869,600	Drejtoria e S Social (DSH Bashki
1.1.4 Hartimi dhe shpërndarja e paketave të informacionit mbi kriteret, dokumentacionin e nevojshëm dhe burimet e mbështetjes për romët dhe egjiptianët në lidhje me regjistrimin civil dhe transferimin e vendbanimit	ZGJC/DSHS	Numri i romëve dhe egjiptianëve të informuar rreth procedurave të regjistrimit civil dhe ndryshimit të vendbanimit, Ndarja sipas: etnicitetit.	Raport i paraqitur nga ZGJC/ DSHS në Bashki	Çdo 6-mujor	242,880	Drejtoria e S Social (DSH Bashki
1.1.5 Dhënia e bonusit për shpërblimin e lindjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në rast regjistrimi brenda afatit ligjor.	Zyra e GJC, DSHS	Numri familjeve rome dhe egjitpiane që kanë përfituar bonusin për shpërblimin e lindjes. Ndarja sipas etnisë.	Raport i paraqitur nga ZGJC/ DSHS në Bashki	Çdo 6-mujor	24,000,000	Drejtoria e S Social (DSH Bashki
Objektivi 2: Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi si dhe referimin, mbrojtjen dhe rii						

Fusha e ndërhyrjes: Akses i Barabartë në Regjistrimin Civil dhe në Drejtësi

Objektivi specifik: Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe

Treguesi i Objektivit: Përqindja e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civi fund të vitit 2020.

Masa/Aktiviteti	Aktorët	Treguesit e rezultateve	Burimet e të dhënave	Afatet	Fondet/Financimi	Monitorimi
rasteve të trafikuara.						

Treguesi i objektivit: Deri në fund të vitit 2020, 100% e anetarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të jenë përfshirë në aktivitete ndërgjegjësuse mbi mënyrat e trafikimit të qënieve njerëzore si dhe 100% e rasteve të trafikuara do të janë marrë në mbrojtje dhe me shërbimet e riintegrimit të tyre në shoqëri.

1.2.1. Përmirësimi i funksionimit të mekanizmit ekzistues për shkëmbimin e informacionit nga institucione të ndryshme, (duke përfshirë informacionin dhe të dhënat e disagreguara mbi viktimat e pakicave rome dhe egjiptiane)	DSHS, grupet e menaxhimit te rasteve	Numri i viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të identifikuara të trafikimit, që janë referuar dhe kanë marrë ndihmë (M/F)	Bashkia/sistemi SIVET (sistemi I informacionit për viktimat e trafikimit)	Çdo 6-mujor	384,000	Drejtoria e S Social (DSH Bashki

Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor

Objektivi specifik2.1: 100% e fëmijëve (djem dhe vazja) të pakicave rome dhe egjiptiane **të përfundojnë arsimin e detyrueshë arsimin parashkollor në fund të vitit 2022.**

Treguesi 1: Përqindja e fëmijëve, djem dhe vazja, të pakicave rome dhe egjiptiane që arrijnë të përfundojnë arsimin e detyrueshëm arsimin parashkollor në fund të vitit 2022.

Treguesi 2: % e institucioneve arsimore që frekuentohen nga djem dhe vajza rome dhe egjiptiane që promovojnë dialogun ndërkul atë të mirëkuptimit të përbashkët nëpërmjet zhvillimit të komuniteteve mbi bazë shkolle, deri në fund të vitit 2020.

Masa/Aktiviteti	Aktorët	Treguesit e rezultateve	Burimet e të dhënave	Afatet	Fondet/Financimi	Monitor
2.1.1 Regjistrimi i të gjithë fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrueshëm	Zyra Arsimore dhe DSHS	Baseline: 261 fëmijë romë dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin bazë në vitin 2018 84 fëmijë romë dhe egjiptianë të moshës 3-5 vjeç frekuentuar kopshtet dhe arsimin para-shkollor (2018) Numri i djemve dhe	Raport i paraqitur nga DSHS/Zyra e Arsimit	Çdo 6-mujor	431,200	Drejtoria Social (D Bashki, arsimit n Drejtoria në Elbas

		vajzave rome dhe egjiptiane të regjistruar dhe që ndjekin arsimin parashkollor dhe arsimin e detyruar. Ndarja M/F, etnicitetit, qytet/fshat.				
2.1.2 Regjistrimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe atë të detyrueshëm duke i përjashtuar ata nga garancitë financiare dhe pagesat për ushqim.	Bashkia / DSHS	Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të përjashtuar nga tarifat për ndjekjen e arsimit parashkollor. Të dhëna të disagreguara: M/F, etnicitetit; qytet/fshat.	Raport i paraqitur nga DSHS	Çdo 6-mujor	818,400	Drejtoria Social (D Bashki, Arsmore Arsimit
2.1.3 Rritja e numrit të romëve dhe egjiptianëve (gra dhe burra) që punojnë si edukatorë në arsimin parashkollor dhe si mësues në arsimin e detyrueshëm	Zyra e Arsimit / Bashkia	Numri i romëve dhe egjiptianëve që punojnë si edukatorë në arsimin parashkollor dhe si mësues. Të dhëna të disagreguara: F/M, etnicitetit.	Raport i paraqitur nga Zyra e Arsimit/ Bashkia	Çdo 6-mujor	4,320,000	Drejtoria Social (D Bashki
2.1.4 Krijimi i pozicioneve ndihmëse për romët dhe egjiptianët në arsimin parashkollor dhe atë bazë (për ndihmë për detyrat e shtëpisë dhe studimin në klasat e ulëta, 1-4)	Zyra e Arsimit / Bashkia	Numri i vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga mbështetja në kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe gjatë studimit. Të dhëna të disagreguara: F/M, etnicitetit, qytet/fshat	Raport i paraqitur nga Zyra e Arsimit/ Bashkia	Çdo 6-mujor	4,320,000	Drejtoria Social (D e Arsimit Arsimore
2.1.5 Sigurimi i transportit falas për në shkollë dhe kopshte i fëmijëve romë dhe egjiptianë që i kanë shkollat/ kopshtet larg (edhe nën 2 km) për arsye sigurie të justifikuara	DAR/Zyra e Arsimit Bashkia	Numri i djemve dhe vajzave rome dhe egjiptiane që përfitojnë transport falas për në shkollë Të dhëna të disagreguara: F/M; grupmosha; etnicitetit; qytet/fshat	Raportet e DAR/Zyra Arsimit në Bashki	Çdo vit (2019-2022)	3,920,000	DAR/Zyr Bashkia
2.1.6 Dhënia e bonusit nga Bashkia për familjet me fëmije që	DAR/Zyra e Arsimit Bashkia	Numri i nxënësve dhe studentëve romë dhe egjiptianë	Raportim iZyrëssëArsimit në Bashki	Çdo vit (2019-2022)	3,132,000	DAR/Zyr Bashkia

frekuentojne klasat nga 6-9 me qëllim përfundimin e arsimit të detyrueshëm.		përfitues, F/M,				
2.1.7 Krijimi i një sistemi dhe infrastrukturës për mensat e shkollave që frekuentohen nga fëmijë rome dhe egjiptianë në mënyrë që te konsumohen vakte ushqimi për të gjithë fëmijët	DAR/Zyra e Arsimit Bashkia	Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përfitojnë vakte falas në shkollë	Raportim I Zyrës së Arsimit në Bashki	Çdo vit (2019-2022)	35,640,000	DAR/Zyr Bashkia
2.1.8 Regjistrimi i personave madhorë dhe prindërve romë dhe egjiptianë që ju mungojnë aftësitë e shkrimit dhe leximit dhe nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm në Programin e Arsimit Bazë me Kohë të Pjesshme.	DAR/Zyra e Arsimit Bashkia	Numri i personave mbi të moshës mbi 16 vjeç që regjistrohen në programin e arsimit bazë me kohë të pjesshme (F/M, etniciteti)	Raportim I Zyrës së Arsimit në Bashki	Çdo vit (2019-2022)	1,593,000	DAR/Zyr Bashkia
2.1.9 Organizimi i aktiviteteve ndërkulturore jashtëshkollore për ndërgjegjësimin rreth identitetit rom dhe atij egjiptian.	Bashkia/ Zyra Arsimore/ DAR	Numri i aktiviteteve ndërkulturore Numri indikativ i nxënësve pjesëmarrës	Raportim I Zyrës së Arsimit në Bashki	Çdo vit (2019-2022)	3,000,000	Zyra e a Bashki/D Arsmore
2.1.10 Parandalimi dhe trajtimi i shkollave të segreguara	Drejtoria Arsimore Elbasan/Zyra e Arsimit Bashki	Numri i shkollave të segreguara. Numri i klasave të segreguara. Ndarja sipas: qytet/fshat	MAS/Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD)	Çdo vit (2019-2022)	1,478,400	Zyra e A Bashki/ I Arsimore

Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor						
Masa/Aktiviteti	**Aktorët**	**Treguesit e rezultateve**	**Burimet e të dhënave**	**Afatet**	**Fondet/Financimi**	**Moni**
Objektivi specifik 2.2: Të forcohet bashkëveprimi i shkollës me shërbimet sociale, për adresimin e rasteve të fëmijëve romë dhe e me probleme sociale-ekonomike.						

Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor						
Masa/Aktiviteti	**Aktorët**	**Treguesit e rezultateve**	**Burimet e të dhënave**	**Afatet**	**Fondet/Financimi**	**Moni**
Treguesi: Përqindja e vajzave dhe djemve të pakicave rome dhe egjiptiane me probleme sociale-ekonomike që do të gjejnë mbesh shërbimet sociale si rezultat i koordinimit me institucionet arsimore komunitare.						
2.2.1 Identifikimi dhe regjistrimi i të gjithë vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë në moshë të detyrueshme shkollore në shkollë, nëpërmjet grupeve shumë-sektoriale të punës në nivel lokal.	Zyra Arsimore dhe DSHS/Bashki, qendrat shendetesore/policia	Numri i vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë të regjistruar çdo vit në arsimin fillor (M/F, etnicitetit, qytet/fshat).	Raport i paraqitur nga DSHS/Zyra e Arsimit Elbasan	Çdo vit (2019-2022)	739,200	Drejtc Shërt (DSH Bash Admi e lagj NJA, Arsim nëElb
2.2.2 Përditësimi i bazës së të dhënave për fëmijët që kanë moshën për arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrueshëm (përfshirë romët dhe egjiptianët)	Zyra Arsimore / Bashkia /DSHS	Baza e të dhënave e përditësuar	Raport i paraqitur nga DSHS	Rregullisht (raportim çdo 6-mujor)	616,000	Drejtc Shërt (DSH Bash Arsim Drejtc Arsim
2.2.3 Ndjekja me çdo shkollë e identifikimit të vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë që mungojnë në sistemin e arsimit parashkollor dhe atë të detyrueshëm për të siguruar regjistrimin e tyre	Zyra e Arsimit / Bashkia	Numri i femijëve romëve dhe egjiptianëve të identifikuar që mungojnë në sistemin e arsimit parashkollor dhe në atë të detyrueshëm (F/M, etniciteti)	ROMALB/Raport i paraqitur nga Zyra e Arsimit/ Bashkia	Çdo 3-mujor	492,800	Drejtc Shërt (DSH Bash
2.2.4 Organizimi i takimeve periodike me prindër romë dhe egjiptianë në vendbanimet e tyre për çështje që lidhen me rëndësinë e arsimit të detyrueshëm.	Drejtoria Arsimore, Zyra e Arsimit / Bashkia	Numri i vizitave derë më derë të kryera nga psikologu, punonjësi social ose nga mësuesit ndihmës Numri i prindërve romë dhe egjiptianë që kanë marrë pjesë	Raport i shkollave/Drejtoria Arsimore në Elbasan/ Bashkia	Çdo vit (2019-2022)	739,200	Drejtc Shërt (DSH Arsim Arsim

Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor						
Masa/Aktiviteti	**Aktorët**	**Treguesit e rezultateve**	**Burimet e të dhënave**	**Afatet**	**Fondet/Financimi**	**Moni**
		në fushatat ndërgjegjësuese				
2.2.5 Referimi i familjeve të fëmijëve që braktisin shkollën ose që rrezikojnë të braktisin arsimin e detyrueshëm, në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe burimet e tjera të mbështetjes.	Drejtoria Arsimore/Zyra e Arsimit Bashki / Bordet e prindërve në çdo shkollë	Numri i familjeve të referuara në shërbimet e mbrojtjes sociale ose në burimet e tjera të mbështetjes për fëmijët që braktisin shkollën. (F/M, Ndarja sipas: etnicitetit, qytet/fshat)	Raporti i Drejtorisë Arsimore /Zyra Arsimit në Bashki	Çdo vit (2019-2022)	369,600	Drejt Arsim Arsim
Objektivi specifik2.3: Përmirësimi i rezultateve në mësime te fëmjëve rom dhe rgjiptian Treguesi: Rritja me 20% e notës mesatare të nxënësve romë dhe egjiptianë që përfundojnë arsimin e detyrueshëm.						
2.3.1 Ngritja e ekipit të vijueshmërisë dhe ndihmesës në çdo shkollë për fëmijët romë dhe egjiptianë (drejtor shkolle, mësues kujdestar, psikolog, punonjës social, ndërmjetësues komuniteti) për të ndihmuar në përmirësimin e rezultateve në shkollë.	Drejtoria Arsimore, Shkollat/Njësitë Administrative/Zyra e Arsimit në Bashki	Numri i ekipeve të ngritura në shkollat me nxënës romë dhe egjiptianë	Raportim I Zyrës së Arsimit në Bashki	Çdo vit (2019-2022)	739,200	DAR/ Arsim
2.3.2 Promovimi i rasteve të suksesëshme të nxënësve më të mirë romë dhe egjiptianë	Shkolla, Drejtoria Arsimore, Zyra e Arsimit në Bashki	Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të promovuar.	Raportim I Zyrës së Arsimit në Bashki	Çdo vit (2019-2022)	1,200,000	Drejt Arsim Arsim
Objektivi specifik2.4: Përmirësimi i dialogut ndërkulturor dhe mirëkuptimit të përbashkët						
2.4.1 Organizimi i javës së kulturës rome (2-8 Prill) dhe kthimi në një traditë të përvitshme, 24 Qershor për ditën e egjiptianëve, si dhe	Bashkia/Drejtoria e Politikave Strategjike Inovacionit dhe Medias,DAR, Shkollat, qendra komunitare	Numri indikativ i pjesëmarrësve në eventet / aktivitetet e kryera	Raportim i Bashkisë	Çdo vit (2019-2022)	3,200,000	Bash DSHS

Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor						
Masa/Aktiviteti	**Aktorët**	**Treguesit e rezultateve**	**Burimet e të dhënave**	**Afatet**	**Fondet/Financimi**	**Moni**
aktivitete gjatë vitit.						
2.4.2 Aktivitete për promovimin e identitetit, vlerave kulturore të pakicave rome dhe egjiptiane[47]	Bashkia / Drejtoria e Politikave Strategjike Inovacionit dhe Medias, DSHS, Media lokale, OSHC, qendra komunitare	Numri i evenimenteve /aktiviteteve dhe qëllimi i tyre Numri inditikativ i pjesëmarresve në çdo aktivitet	Raportim i Bashkisë / Publikime në website, OSHC, projekte të donatorëve	Çdo vit (2019-2022)	400,000	Rapo grupit monit Planit
2.4.3 Promovimi i talenteve në art (këngë dhe instrumente muzikore), zeje në aktivitete social-kulturore.	Bashkia/ Qendra sociale komunitare mediet lokale/ DAR	Numri i femijeve të identifikuar si talente në aktivitetet e kryera Numri i fëmijëve të promovuar në mediet lokale	Bashkia / Qendra Sociale / Mediet	Çdo vit (2019-2022)	3,000,000	Rapo grupit monit Planit
2.4.4 Ngritja e një platforme bashkëpunimi dhe koordinimi midis organizatave të shoqërisë civile , Bashkisë dhe donatorëvë dhe aktorëve të tjerë vendore që promovojnë dialogun ndërkulturor	Bashkia	Numri i aktiviteteve Numri indikativ i pjesëmarrësve	Bashkia / OSHC / donatore	Çdo vit (2019-2022)	1,232,000	Rapo grupit monit Planit

Fusha e ndërhyrjes: Kujdesi Shëndetësor **Qëllimi strategjik 3:** Rritja e jetëgjatësisë dhe ulja e sëmundshmërisë së ndër pakicat rome dhe egjiptiane						
Masa/Aktiviteti	**Aktorët**	**Treguesit e rezultateve**	**Burimet e të dhënave**	**Afatet**	**Fondet/Financimi**	**Mor**
Objektivi specifik 3.1: Rritja e aksesit të pakicave rome dhe egjiptiane në shërbimet e kujdesit shëndetësor Treguesi 1: % e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane që do të kenë mundësi të përdorin shërbimet bazë shëndetësore deri n vitit 2020.						
3.1.1 Kontrolle periodike në	NJVKSHE /	Numri i personave	Raport i	Çdo vit	443,520	NJV

[47] Aktivitete në datën 1 Qershor-dita ndërkombëtare e fëmijëve, 17 Tetor – dita botërore kundër varfërisë, 10 Dhjetor-Dita botërore e tolerancës

Fusha e ndërhyrjes: Kujdesi Shëndetësor **Qëllimi strategjik 3:** Rritja e jetëgjatësisë dhe ulja e sëmundshmërisë së ndër pakicat rome dhe egjiptiane						
Masa/Aktiviteti	**Aktorët**	**Treguesit e rezultateve**	**Burimet e të dhënave**	**Afatet**	**Fondet/Financimi**	**Mo**
terren dhe informim i pakicave R&E mbi kontrollin shëndetësor bazë, shërbimin falas dhe kontrollin periodik (check-up)	Qendra Shëndetësore	romë dhe egjiptianë të vizituar në vitin e raportimit Numri i të sëmurëve kronikë romë dhe egjiptianë Numri i personave R&E që kanë bërë check up.	paraqitur nga DSH Publik / Bashkia	(2019-2022)		Qer Shë Bas
3.1.2 Depistim çdo vit të zonave ku jetojnë familjet rome dhe egjiptiane për identifikimin e fëmijëve të pavaksinuar	NJVKSHE / Qendra Shëndetësore	Numri i fëmijëve R&E që kanë bërë vaksinat në vitin e raportimit (F/M). Numri i fëmijëve R&E që kanë bërë vaksinat në përkundrejt numrit të përgjithshëm të fëmijëve.	Raport i paraqitur nga DSHS	Çdo vit (2019-2022)	369,600	NJV Qer Shë Bas
3.1.3 Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për sëmundshmërinë e romëve dhe egjiptianëve	Qendra Shëndetësore	Evidenca për sëmundshmërinë e anëtarëve të pakicav R&E	Raportim nga Qendra Shëndetësore	Çdo vit (2019-2022)	492,800	NJV Qer Shë Bas
3.1.4 Evidentimi i R&E pa kartë shëndeti dhe ofrimi i mbështetjes për paisjen me kartë shëndeti	Qendra Shëndetësore / Qendra komunitare /DRAKPA	Numri i personave R&E të identifikuar me mungesë të kartës së identitetit. Numri i personave të paisur me kartë shëndeti. % e R&E të paisur me kartë shëndeti në raport me numrin e anëtarëve të komuniteteve që jetojnë në bashki	Qendra Shëndetësore / Qendra komunitare /DRAKPA	Çdo vit (2019-2022)	295,680	NJV Qer Shë Bas Rap grup mor
3.1.5 Informim dhe ndërgjegjësim të familje rome për të vaksinuar fëmijët e tyre	Qendra Shëndetësore / Qendra komunitare /Bashkia	Numri i personave romë dhe egjiptianë të informuar	Qendra Shëndetësore / Qendra komunitare/ Bashkia	Çdo vit (2019-2022)	492,800	NJV Qer Shë Bas Rap grup

Fusha e ndërhyrjes: Kujdesi Shëndetësor **Qëllimi strategjik 3:** Rritja e jetëgjatësisë dhe ulja e sëmundshmërisë së ndër pakicat rome dhe egjiptiane						
Masa/Aktiviteti	**Aktorët**	**Treguesit e rezultateve**	**Burimet e të dhënave**	**Afatet**	**Fondet/Financimi**	**Mo**
						mor
3.1.6 Nxitja e katedrave universitare mjekësore që të ndërmarrin punë në terren në ndihme të pakicave rome dhe egjiptiane (ekipe mjekësore dhe studentë të mjekësisë për të ofruar vizita falas)	Bashkia, DSHP	Numri i nismave Numri ipersonave të vizituar dhe këshilluar	Raportim nga DSHP / Bashkia	2019-2020	3,000,000	DSH Shë Bas Rap grup mor
Objektivi 3.2: Përmirësimi i informimit dhe promocionit shëndetësor për shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor për ro egjiptianët. Treguesi i objektivit: Përqindja e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane që do të kenë informacion të plotë në lidhje me çështje ndikojnë në shëndetin e tyre si dhe shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor.						
   "Për kontributin e dhënë, si inxhinier i përpunimit të drurit, me inovacione në punën e tij 40 vjeçare (teorike dhe praktike) në Kombinatin e Drurit Elbasan, ku ai punoi".

2 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Konceptoi:

Drejtoria e TKTS: *E. Krraba* *D. Kristo*

Drejtoria Juridike: *p/ O. Deliallisi*

Zv/Kryetar: *A. Qose*

Sekretari i Përgjithshëm: *A. Bylykbashi*

1594
27.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5606/1 **Prot.** **Datë** 27.11. **2020**

VENDIM

NR. 152 **DATË** 27. **11. 2020**

PËR

"Miratim i marrëveshjes së financimit midis GIZ dhe Bashkisë Elbasan për realizimin e projektit "Promovimi i punësimit të të kthyerve përmes punëve të komunitetit në Bashkinë Elbasan", "Programi GIZ për Migrim dhe Zhvillim".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.11. 2020, pasi shqyrtoi marrëveshjen e bashkëpunimit me GIZ për realizimin e projektit *"Promovimi i punësimit të të kthyerve përmes punëve të komunitetit në Bashkinë Elbasan", Programi GIZ për Migrim dhe Zhvillim",* propozuar nga Kryetari i Bashkisë, mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
b) Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSh" (i ndryshuar);
c) Ligjin nr.10296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar);
d) Ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", (i ndryshuar);
e) VKM nr.717, datë 23.06.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar;
f) Udhëzimin e MF nr.9 datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit";

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e financimit midis GIZ dhe Bashkisë Elbasan *"Promovimi i punësimit të të kthyerve përmes punëve të komunitetit në Bashkinë Elbasan"*, në kuadër të projektit "Programi GIZ për Migrim dhe Zhvillim", financuar nga Qeveria Gjermane, Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. (bashkëlidhur marrëveshja)

2. Të miratojë rritjen e numrit të punonjësve sezonale për ASHP, me afat 2(dy) muaj përgjatë periudhës 15 nëntor 2020 deri me 31 mars 2021, financuar nga projekti "Programi GIZ për Migrim dhe Zhvillim", tabela "Buxheti i detajuar", gjithsej 94 (nëntëdhjetëekatër) :

- punëtor mirëmbajtës, klasa IV, paga baze mujore 33,400 lekë, punonjës 90 (nëntëdhjetë);
- supervizor (përgjegjës sektori), klasa XI, paga bazë mujore 37,000 lekë, punonjës 4 (katër);

Diferencat e fondit për shtesën e vjetërsisë mbi pagë do të kompesohen nga fondi i pagave miratuar në buxhet për ASHP.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe ASHP.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR
Klajd Gripshi

KRYETAR
Hektor Çiftja

Drejtoria e Buxhetit: M. Beluli
Drejtoria ABNJ : L.Balliu
Drejtoria Juridike: O. Deliallisi
Dr.Përgjth. PAABF: Q. Tusha
Dr. Përgj. Sh.O.: B.Çabiri
Zv/Kryetari : I. Sina

1606
27-11-2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 5605/1 **Prot.** **Elbasan, më** 27.11. **2020**

Vendim
Nr 153 **Datë** 27/11/**2020**
Për emërtim rrugësh

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës____/___/2020, pasi shqyrtoi relacionin e komisionit të trashëgimisë historike dhe kulturore, pranë Këshillit Bashkiak me qëllim emërtimn e rrugëve dhe shmangjen e disa emërtimeve të dubluara të tyre, me propozim të këtij komisioni, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 54 të tij,

Vendosi:

1- Rruga "Tomorr Domi" në lagjen "5 Maj", Njësia Administrative Nr.6, të emërtohet rruga "Ali Shashaj"
2- Rruga "Demir Bungo" në lagjen "Skenderbej", Njësia Administrative Nr.3, të emërtohet rruga "Emine Bahja"
3- Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve, Sektori i Transportit dhe Agjensia e Shërbimit Publik me zbatimin e këtij vendimi.
4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

D.P.T.P A.Canaj
Drejt. Juridike O. Deliallisi
Av. Qytetit A. Hoxha
Komisioni i Këshillit Bashkiak
M. Peza
R. Islami
Z. Rapa

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja
Hektor Çiftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

1595
27.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5607 **Prot.** **Elbasan më,** 27.11 **.2020**

VENDIM

Nr. 154 **Datë:** 27.11 **.2020**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e Znj. Tane Isuf Nipolli, banore në Fshatin Gjergjan, Njësia Administrative Gjergjan, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Znj. Tane Isuf Nipolli,** banore në Fshatin Gjergjan, Njësia Administrative Gjergjan si dhe dëmshpërblimin financiar", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr:329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **1 527 570 x 50% = 763 785** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Znj. Tane Isuf Nipolli** është në **763 785** (shtatë qind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatë qind e tetëdhjetë e pesë) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **763 785** (shtatë qind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatë qind e tetëdhjetë e pesë) lekë, për shtetasin **Znj. Tane Isuf Nipolli.**

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

1596
27.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5608/1 **Prot.** **Elbasan më,** 27.11.**2020**

V E N D I M

Nr. 155 **Datë:** 27.11.**2020**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e Znj. Ryzhdije Hekuran Kuqja, banore në Fshatin Thanë, Njësia Administrative Gjergjan, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Znj. Ryzhdije Hekuran Kuqja,** banore në Fshatin Thanë, Njësia Administrative Gjergjan si dhe dëmshpërblimin financiar", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **1 316 476 x 50% = 658 238** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Znj. Ryzhdije Hekuran Kuqja** është në masën **658 238** (gjashtë qind e pesëdhjetë e tetë mijë e dy qind e tridhjetë e tetë) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **658 238** (gjashtë qind e pesëdhjetë e tetë mijë e dy qind e tridhjetë e tetë) lekë, për shtetasin **Znj. Ryzhdije Hekuran Kuqja**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Ciftja

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

1592
27.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5609/11 **Prot.** **Elbasan më,** 27.11.**2020**

V E N D I M

Nr. 156 **Datë:** 27.11.**2020**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e Z.Skënder Riza Mallosi, banor në Fshatin Mamël, Njësia Administrative Gracen, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Skënder Riza Mallosi,** banor në Fshatin Mamël, Njësia Administrative Gracen si dhe dëmshpërblimin financiar", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **710 869 x 50% = 355 434** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Skënder Riza Mallosi** është në masën **355 434** (tre qind e pesëdhjetë e pesë mijë e katër qind e tridhjetë e katër) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **355 434** (tre qind e pesëdhjetë e pesë mijë e katër qind e tridhjetë e katër) lekë, për shtetasin **Z. Skënder Riza Mallosi**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

1598
27.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5610/1 **Prot.** **Elbasan më** 27.11.**2020**

VENDIM

Nr. 157 **Datë:** 27.11.**2020**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e Z.Resmi Ahmet Çehu, banor në Fshatin Rrilë, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Resmi Ahmet Çehu,** banor në Fshatin Rrilë, Njësia Administrative Bradashesh si dhe dëmshpërblimin financiar", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **1 302 504 x 50% = 651 252** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Resmi Ahmet Çehu** është në masën **651 252** (gjashtë qind e pesëdhjetë e një mijë e dy qind e pesëdhjetë e dy) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **651 252** (gjashtë qind e pesëdhjetë e një mijë e dy qind e pesëdhjetë e dy) lekë, për shtetasin **Z. Resmi Ahmet Çehu**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Ciftja

1595
27.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5611/1 **Prot.** **Elbasan më,** 27.11.**2020**

V E N D I M

Nr. 158 **Datë:** 27.11.**2020**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e Z.Shpëtim Zyber Mullahu, banor në Fshatin Petresh, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Shpëtim Zyber Mullahu,** banor në Fshatin Petresh, Njësia Administrative Bradashesh si dhe dëmshpërblimin financiar", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **1 914 865 x 50% = 957 432** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Shpëtim Zyber Mullahu** është në masën **957 432** (nëntë qind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katër qind e tridhjetë e dy) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **957 432** (nëntë qind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katër qind e tridhjetë e dy) lekë, për shtetasin **Z. Shpëtim Zyber Mullahu**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

1600

27.11.2020

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5612/1 **Prot.** **Elbasan më,** 27.11.**2020**

VENDIM

Nr. 153 **Datë:** 27.11.**2020**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e Z.Ruzhdi Ahmet Çehu, banor në Fshatin Rrilë, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Ruzhdi Ahmet Çehu,** banor në Fshatin Rrilë, Njësia Administrative Bradashesh si dhe dëmshpërblimin financiar", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **1 589 438 x 50% = 794 719** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Ryzhdi Ahmet Çehu** është në masën **794 719** (shtatë qind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatë qind e nëntëmbëdhjetë) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **794 719** (shtatë qind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatë qind e nëntëmbëdhjetë) lekë, për shtetasin **Z. Ruzhdi Ahmet Çehu**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

1601
27.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.5613/1 **Prot.** **Elbasan më,**27.11.**2020**

V E N D I M

Nr.160 **Datë:**27.11.**2020**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga shpërthimi i bombulës së gazit në banesën e Z. Ruzhdi Shaqir Ago, banor në Fshatin Katund i Ri, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.____.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Ruzhdi Shaqir Ago,** banor në Fshatin Katund i Ri, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga shpërthimi i bombulës së gazit në banesën e shtetasit **Z. Ruzhdi Shaqir Ago,** e cila është në masën **1 107 735** (një milion e një qind e shtatë mijë e shtatë qind e tridhjetë dhjetë e pesë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **2 029 471 x 50% = 1 014 735 lekë + 93 000 lekë = 1 107 735 lekë.**
3. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **1 107 735** (një milion e një qind e shtatë mijë e shtatë qind e tridhjetë dhjetë e pesë) **lekë,** për familjen e **Z. Ruzhdi Shaqir Ago.**

4. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 252. datë 24.12.2019.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: p/ O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

1602
27.11.2020

20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.5614/1 **Prot.** **Elbasan më,**27.11.**2020**

V E N D I M

Nr. 161 **Datë:** 27.11 **.2020**

"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z.Artam Themi Mëhillka, banor në Lagjen "Haxhias", Lagjja Nr. 5, Elbasan si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së shtetasit **Z. Artam Themi Mëhillka,** banor në Lagjen "Haxhias", Lagjja Nr. 5, Elbasan si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e shtetasit **Z. Artam Themi Mëhillka,** e cila është në masën **62 592** (gjashtëdhjetë e dy mijë e pesë qind e nëntëdhjetë e dy) **lekë**. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **125 184 x 50% = 62 592 lekë.**
3. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **62 592** (gjashtëdhjetë e dy mijë e pesë qind e nëntëdhjetë e dy) **lekë,** për familjen e **Z.Artam Themi Mëhillka.**

4. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 252. datë 24.12.2019.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Specialist: A. Omeri
Drejtori i EC: T. Sinanaj
Drejtori i DPSHI: S. Mehmeti
Drejtori i PPAABF: Q. Tusha
Drejtori i D.Juridike: O. Deliallisi
Zv/Kryetari: I. Sina

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

1603
27.11.2020

3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.5615/1 Prot. **Elbasan më, 27.11.2020**

V E N D I M

Nr.162 Datë: 27.11.2020

"Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesave të Z.Myftar Ibrahim Dervishi dhe Z. Halit Musa Dervishi (Kosta Beshuris) banorë në Fshatit Xibrakë, Njësia Administrative Labinot Fushë, përcaktuar në VKB Nr. 93 datë 24.11.2015 të Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.11.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Infrastrukturës, Bashkia Elbasan, mbështetur në ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.44, datë 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë" dhe shkresës së ardhur nga Ministria e Mbrojtjes me Nr. 948/1 prot., date 03.04.2019, nëpërmjet Prefektit ;

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 93 datë 24.11.2015 "Për miratimin e ndihmës financiare, për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri në banesat e familjeve të **Z. Halit Musa Dervishi (Kosta Beshuris)** dhe **Z. Myftar Ibrahim Dervishi,** fshatit Xibrakë, Njësia Administrative Labinot Fushë"; bëhen këto korigjime:

   Pika 1: Vlara e dëmeve nga ana ndërtimore të ndryshojë:
   Për **Z. Halit Musa Dervishi (Kosta Beshuris)** është 708 012 lekë të bëhet **526 600** (pesë qind e njëzet e gjadhtë mijë e gjashtë qind) lekë.
   Për **Z. Myftar Ibrahim Dervishi** është 388 268 lekë të bëhet **293 675** (dy qind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e shtatëdhjetë e pasë) lekë.

   Pika 2: Vlara e dëmeve në paisje dhe orendi shtëpiake të ndryshojë:
   Për **Z. Halit Musa Dervishi (Kosta Beshuris)** është 115 000 lekë të bëhet **196 000** (një qind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.
   Për **Z. Myftar Ibrahim Dervishi** është 124 000 lekë të bëhet **57 000** (pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

Pika 3: Fondi për pikat 1 dhe 2 nga 1 335 280 lekë të bëhet **1 073 275** (një milion e shtatëdhjetë e tre mijë e dy qind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Infrastrukturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:
Drejt. Emergjencave Civile: *T. Sinanaj*
Drejt.Pergj.Sherbimeve Infrastrukturore: *S. Mehmeti*
Drejtoria Juridike: *O. Dehallisi*

SEKRETARI

Klajd GRIPSHI

KRYETARI

Hektor ÇIFTJA

1604

27.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5616/11 Prot.

Elbasan, më 27.11.2020

V E N D I M

Nr. 163 dt. 27.11 2020

PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM

Për mbarështimin e florës së egër, kultivimin e bimëve të ndryshme, zhvillimin e agropylltarisë dhe për qëllime pushimi e argëtimi, në ngastrat nr. 23ab, 24ab, 25a dhe 26b, në ekonominë pyjore "Zalli Shkumbin".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____.11.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit, mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
- Ligjin nr 57/2020 datë 30.4.2020 "Për pyjet",
- Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar,
- Ligjin nr. 8318, datë 1.4.1998 "Për dhënien me qera të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar (neni 13,16),
- VKM nr. KM 433 dt.8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndrysuar me VKM nr. 684 dt. 2.9.2020.
- VKM nr.1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", të ndryshuar,
- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik",

V e n d o s i :

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim me qira, të fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Elbasan, për mbarështimin e florës së egër, kultivimin e bimëve të ndryshme, zhvillimin e agropylltarisë dhe për qëllime pushimi e argëtimi, nëpërmjet procedurës të konkurimit publik, për sipërfaqet pyjore sipas listës bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjthshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Prokurimeve Publike dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.

3. Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajd Gripshi

KRYETARI
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

Konceptoi:

Specialisti i kadastrës: P. Bardhi

P/Sektorin e Admin_Menaxhimit: J. Bodurri

Drejtori i DSHPBVM: Sh. Çullhaj

Drejtoria Juridike: O. Deliallisi

Zv/ Kryetari: I. Sina

BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PYJORE, BUJQËSISË, VETERINARISË DHE MJEDISIT

SIPËRFAQJA PYJORE QË DO TË JEPET NË PËRDORIM

Për mbarështimin e florës së egër, kultivimin e bimëve të ndryshme, zhvillimin e agropylltarisë dhe për qëllime pushimi e argëtimi, per vendosje panelesh per prodhim energjie në ngastrat nr. 23ab, 24ab, 25ab dhe 26ab, në ekonominë pyjore "Zalli Shkumbin".

Nr.	Ekonomia pyjore	Perdorimi i territorit	Ngastra nr.	Qëllimi i përdorimit parashikuar ne VKM nr. 1064 dt.22.12.2010	VKM Nr. 1064 dt.22.12.2010/ Sip. qe propozohet te jepet ne perdorim (ha) Afati i përdormit (vjet)	Sip. (ha)	Vërejtje
1	Zalli Shkumbin	Tokë me bimësi pyjore	23a	Për mbarështimin e florës së egër, kultivimin e bimëve të ndryshme, zhvillimin e agropylltarisë dhe për qëllime pushimi e argëtimi	6-9	1.5	Bazuar në udhezimin e Ministrisë Mjedisit, nr. 1 dt. 9. 6.2016 "Për rregullat, procedurat e kalimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullsor publik", pika 10. Personat fizik dhe juridik qe marrin pjese ne konkurim publik (ankand) duhet te paraqesin dokumentet e meposhtme:përdorim të fondit pyjor dhe kullsor publik", pika a) kerkese sebashku me te dhenat per gjeneralitetet e tyre;b) ekstraktin e regjistrimit ne QKR per objektin e veprimtarise; c) projektin teknik te hartuar nga specialiste te licencuar ku jane trajtuar te gjitha elementet e nevojshme per zhvillimin e veprimtarise se kerkuar;d) plan-biznesin dhe investimet qe do te behen;e) te dhena per kapacitet teknike, stafin, makinerite dhe pajisjet qe zoteron;f) planin e rehabilitimit te siperfaqes dhe kthimin e saj ne gjendjen e meparshme;g) nivelin e punesimit ne veprirntarih) lejen mjedisore per aktivitetin e kerkuar, i) cmimin e qirase se ofruar per ha/vit;j) adresen e subjektit, telefon, email, dhe fax. 11. Kushtet e pjesemarrjes ne konkurrim jane:a) garanci financiare te mjaftueshme per perballimin e investimeve te parashikuara ne planbiznes;b) te kete te kontraktuar nje specialist te fushes, ku ne Cv profesionale te tregohet pervoja ne fushen e veprimtarise;c) vertetim nga organet perkatese shteterore se subjekti nuk ka procese gjyqesore ne ngarkim, hetim ne proces, detyrime tatimore ose detyrime te tjera ndaj te treteve.
2			23b		6-9	0.5	
3			24a		6-9	3.0	
4			24b		6-9	1.0	
5			25ab		6-9	9.0	
6			26ab		6-9	10.0	
Shuma:						**25.0**	

SPECIALISTI I KADASTRËS
Preni Bardhi

PËRGJEGJËSI SEKTORIT
Jakov Baduri

D R E J T O R I
Shpëtim Çullhaj

1605

27.11.2020

BASHKIA ELBASAN

I/R 169 dt. 27.11.2020

PAKETA FISKALE

MIRATIMI I TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË ELBASAN PËR VITIN 2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5618/1 **Prot.** **Elbasan, më** 27.11.**2020**

VENDIM

Nr. 64 **Datë:** 27.11.**2020**

"PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË ELBASAN PËR VITIN 2021"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____.____.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2021"*, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
- Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;
- Ligjin nr.57/2020, "Për pyjet";
- Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave",i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 11.06.2009 "Për tarifat në sektorin e Kullotave";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018"Përmetodologjinë përpërcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 12.10.2016 "Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së";

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre si dhe nivelin e gjobave për kundravajtjet, si mëposhtë vijon:

- **Tabela A**. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë";
- **Tabela A/1**. Taksa mbi tokën bujqësore;
- **Tabela A /2**. Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike);
- **Tabela B**. Taksa e fjetjes në hotel;
- **Tabela C**. Taksa e ndikimit në infrastrukturë;
- **Tabela C/1**. Taksë për objektet në proçes legalizimi;
- **Tabela C/2** .Vendosja e garancisë financiare për heqjen e inerteve;
- **Tabela D**. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- **Tabela E**. Taksa për vendosjen e tabelës;
- **Tabela F**. Tarifat Vendore;
- **Tabela F/1**.Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit;
- **Tabela F/2**. Tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, shërbimit në tregje dhe zgjatjeve të orarit;
- **Tabela G**. Tarifa për zënien e hapësirave publike;
- **Tabela H**. Tarifat vendore të transportit;
- **Tabela H/1**. Tarifat per liçensa/autorizime/çertifikata;
- **Tabela H/2**. Tarifë për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- **Tabela I**. Tarifat vendore për popullatën;
- **Tabela J**. Tarifat e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Projekteve;
- **Tabela K**. Tarifat vendore të veterinarisë;
- **Tabela L**. Tarifa vendore të shërbimeve të institucioneve vartëse;
- **Tabela L/1**. Tarifat vendore mbi shërbimin e varrimit;
- **Tabela L/2**. Tarifat vendore për shfrytëzimin e truallit publik për tubacionet, kabllot telefonike, fibrën optike;
- **Tabela L/3**. Tarifat vendore për pyjet dhe kullotat;
- **Tabela L/4**. Tarifa për sektorin e bujqësisë;
- **Tabela L/5**. Tarifa për përdorimin e kullotave dhe livadheve për kullotje;

- **Tabela N.** Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

PAKETA FISKALE PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE 2021

Tabela A

1. Tabela A - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë"

Vlera e taksës së ndërtesës do të përllogaritet sipas aneksit 1 dhe 2 të V.K.M nr. 132 *"Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës"*, e ndryshuar.

<u>Për ndërtesat të cilat shërbejnë për banim</u>

a. Për sipërfaqjet ndërtesë banesë në qytet (*Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 04 % x 50.300= 20.120 lekë).*

b. Për sipërfaqjet ndërtesë banesë në të gjitha Njësitë Administrative *(Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 05 % x 35,210= 17.605 lekë).*

<u>Për ndërtesat të cilat shërbejnë jo për banim</u>

<u>Aneksi 2</u>

ÇMIMET MESATARE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR NDËRTESAT QË NUK SHËRBEJNË PËR BANIM

1.a. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi/njësi ku nuk kryhet aktivitet ekonomik është 120.7[1] lekë/m^2 në vit.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.

Për taksën e pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", për të cilat nuk disponojmë vlerën e ndërtesës, do të përdoret vlerat referuese për sipërfaqje të banesës, 100 (njëqind) metër katror sipërfaqje për njësi pronësore, për ndërtesat për banim dhe 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, *"Për privatizimin e banesave shtetërore"*, të ndryshuar ose të ndërtuara para vitit 1991 në Njësitë Administrative.

Përsa i përket kategorisë së ndërtesave që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike nëse subjekti nuk ka realizuar deklarimin nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë vlerësimi realizohet sipas vendimit nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për

[1](75,450 -20%= 60,360. Vlera për m^2= 1m^2 x 0,2 % x 60,360 lekë = 120.7 lekë).

kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar".

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambjentit të ndërtesës.

1. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është:

1. Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, për taksën e biznesit të madh dhe të vogël (pagesa kryhet nëpërmjet çdo banke të nivelit të dytë postës, Unioni Financiar Tiranë).

2. Për subjektet familje të cilat disponojnë kontratë me shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a." pagesa e taksës bëhet çdo muaj si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga kjo ndërmarrje, në cilësinë e agjentit tatimor (taksat e popullatës për vitin 2021 dhe detyrimet e prapambetura për klientët e faturuar).

3. Për subjektet familje të cilat nuk disponojnë kontratë furnizimi me ujë me shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a." afati i pagesës është data 31.10.2021.
Administratorët në Njësitë Administrative dhe Lagjet për ato zona (persona) ku nuk ka kontratë me ujësjellësin.

4. Lagjet dhe Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a." për debitorët familjarë dhe Drejtoria e Tatimeve Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave për debitorët e taksave vendore.

5. Afati i pagesës së taksës së ndërtesës nga subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik do të jetë data 31.07.2021.

6. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj, por jo më shumë se 12 muaj.

2.Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën:

1. Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
2. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me V.K.M, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
3. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
4. Banesat sociale në pronësi të bashkive;
5. Pasuritë e paluajtshme – ndërtesa, pronë e subjekteve juridikë ose fizikë, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
6. Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

7. Strukturat akomoduese "Hotel / Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*";
8. Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
9. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
10. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore;
11. Ndërtesat e invalidëve të punës kur janë kryefamiljarë, pas paraqitjes së dëshmisë së invaliditetit, në ato raste kur familja përbëhet vetëm nga invalidi, ose dhe nga persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë ose pensionistë;
12. Përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e investimeve të kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese me 5 yje, "status special", sipas përcaktimit në legjislacionin përkatës për fushën e turizmit.
13. Në qoftë se ndërtesa dëmtohet nga forca madhore, përjashtohet nga taksa e ndërtesës në masën 75% të vlerës.
14. Kur ndërtesa tjetërsohet ose zhduket gjatë vitit, detyrimi llogaritet për periudhën e të qenit pronar.

Tabela A/1 - Taksa mbi tokën bujqësore:

	Kategoritë e tokës bujqësore	**lekë /ha/vit.**
1.	Klasa I	4200
2.	Klasa II	3500
3.	Klasa III	2800
4.	Klasa IV	2300
5.	Klasa V	1900
6.	Klasa VI	1600
7.	Klasa VII	1400

1. Afati për pagesën e taksës së tokës bujqësore është data **31.07. 2021.**
2. **Strukturat e caktuara për mbledhjen e kësaj takse janë:**

a. Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative, Njësitë Administrative dhe Lagjet.
b. Agjencia e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore.

Shënime:

1. Përjashtohen nga taksimi mbi tokën bujqësore sipërfaqjet e mbjellura me kulturat dru frutor dhe vreshtari për 5 vitet e para nga çasti i mbjelljes.

2. Kur toka bujqësore dëmtohet nga fatkeqësi natyrore i zbritet 75 % e vlerës së taksës, për sipërfaqjen e dëmtuar, nga momenti i dëmtmit.

3. Në rastet e dëmtimit tërësisht të sipërfaqjes së tokës nga gërryeja e lumejve, përrenjve, rrëshqitjeve masive prej të cilave toka humb tërësisht funksionin e saj si tokë bujqësore, ngrihet një komision nga Bashkia Elbasan, prej drejtorisë përkatëse të bujqësisë dhe përpilohet procesverbali, ku merr pjesë edhe përfaqësuesi nga seksioni i mbrojtjes dhe menaxhimit të tokës bujqësore të Këshillit të Qarkut. Në këtë rast qytetari përjashtohet nga detyrimi për pagesën e taksës mbi tokën bujqësore, nga periudha e konstatimit të dëmtimit të tokës e në vazhdim.

Tabela – A /2 Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike)

	Kategoritë dhe nën/kategoritë	**lekë/m²/vit**
1.	Për qëllime banimi nga individët ose troje të tjera me destinacion jo ekonomik	0.42
2.	Për qëllime biznesi	18

1. Trualli është pasuria e paluajtshme e emëtuar e tillë sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
2. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqjes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.
3. Niveli i taksës caktohet në *lekë për metër katror*. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
4. Për të gjitha kategoritë e trullit që nuk shërbejnë për aktivitet ekonomik do të aplikohet taksa sipas pikës 1 të kësaj tabele.
5. **Strukturat e caktuar për mbledhjen e kësaj takse janë:**
Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative, Njësitë Administrative dhe Lagjet.
6.Afati për pagesën e taksës së truallit për kategorinë 1 në Njësitë Administrative është data **31.07 2021.**
7. Afati për pagesën e kësaj takse për kategoritë 2 dhe 3 është data **31.07 2021.**

8. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë 1.8% çdo muaj, deri në 12 muaj, mbi detyrimin.

Tabela B – Taksa e fjetjes në hotel

Nr.	**Baza e taksës**	**Niveli** **lekë/netë fjetje/person**
1	Hotel me 4 ose 5 yje.	175
2	Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese.	70

1. Me "hotel" kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet: hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar si dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
3. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
4. Subjektet janë të detyruar të bëjnë vetëdeklarimin e numrit të netëve të qëndrimit në hotel shoqëruar me dokumentacionin justifikues për muajin paraardhës.
5. Në rastet kur subjektet nuk mbajnë regjistër të klientëve që flejnë në hotel, administratës tatimore i lind e drejta të bëjë vlerësimin.
6. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.
7. Afati për pagesën e kësaj takse është data **31.07.2021.**
8. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj, deri në 12 muaj mbi detyrimin si dhe ndërprietet aktiviteti nga strukturat përkatëse.

Tabela C – Taksa e ndikimit në infrastrukturë

	Emërtimi	**Niveli i taksës**
a.	Strukturë banimi: 1. për ndërtime të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi[2].	4% e çmimit të shitjes për m^2

[2] Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit. Baza e taksës është vlera në lekë për

	Strukturë banimi: 2. për ndërtime për banim e shërbime nga investitorë të tjerë për qëllime jo fitimi.	3% të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
b.	Ndërtime të karakterit, turizëm, industrial, bujqësor, ndërtime individuale për qëllime të përdorimit vetjak të ndërtuara nga vetë individët apo me sipërmarrës.	3 % e preventivit real të investimit, më çmimet në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
c.	Strukturë për qëllime publike, përjashtohen investimet e Bashkisë Elbasan.	2 % të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
d.	Për projekte të infrastrukturës publike, për ndërtimin rrugësh, ujësjellësash, kanalizimesh, në pronësi të Bashkisë Elbasan.	0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;
e.	Struktura me funksion privat (prodhime, tregtimi e shërbimi).	3% të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit të Banesave në fuqi.
f.	Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0.1% të vlerës të preventivit në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
g.	Për ndërtesat në proçes legalizimi.	0.5% e vlerës së investimit në bazë të çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
h.	Për ndryshim funksioni.	3% e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.
i.	Rikonstruksione e struktura të ndryshme.	3% e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.
j.	Për individët që trajtohen nga emergjenca civile për rrëshqitje të tokës ose nga fatkeqësi të tjera natyrore.	0%

metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerrë me akt nga Këshilli i Ministrave.

k.	Investimet e subjekteve që zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si agro-turizem sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit. Subjekte që zhvillojnë veprimtari pritëse duhet të jenë certifikuar si "Subjekt i certifikuar agroturizmi", sipas VKM nr. 22, datë 12.01.2018, si kusht për t'u përjashtuar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.	0 %
l.	Për ndërtesat që destinohen për qëllime banimi në zona malore.	0% të vlerës së investimit
ll.	Personat që aplikojnë për t'u pajisur me leje për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, përjashtohen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë duke paraqitur dokumentacionin përkatës sipas VKM nr. 145, datë 13.02.2020.	0% taksa e ndikimit në infrastrukturë

1. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.

2. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave".

3. Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe:

a) për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 për qind e vlerës së investimit;

b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0, 1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;

c) për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi;

d) për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0 për qind e vlerës së investimit, Këshilli bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.

4. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela C/1– Taksë për objektet në proçes legalizimi

	Kategoritë dhe nënkategoritë për më tepër se një (1) objekt në proçes legalizimi	**Përqindja e ndikimit në infrastrukturë**
1.	Struktura banimi.	3% e ndikimit në infrastrukturë
2.	Struktura me funksione shërbimi dhe njësi.	3% e ndikimit në infrastrukturë
3.	Struktura për qëllime publike si: shkolla, kopshte, spitale etj., (private ose publike).	2% e ndikimit në infrastrukturë

1. Për ndërtesat të cilat janë në proçes legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit.
2. Dokumentacioni i kërkuar do të jetë ai i parashikuar nga drejtoria përkatëse, i cili përfshin kopje të njehësuar të vetëdeklarimit, planvendosje të objektit, si dhe planimetritë me sipërfaqjet përkatëse.
3. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela C/2 – Vendosja e garancisë financiare për heqjen e inerteve

Garancia financiare për heqjen e inerteve	% e vlerës së strukturës së objektit
Garancia financiare për heqjen e inerteve.	4% e vlerës së investimit sipas strukturës së objektit

1. Në mbështetje të pikës 10, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të Bashkisë Elbasan ose kontratë sigurimi, e cila nuk do të jetë më e vogël se 4% e vlerës së strukturës së objektit.
2. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela D- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

Nr.	Kategoritë e ndërtesave	Niveli tregues i taksës (Qyteti Elbasan) lekë/m^2	Njesitë Administrative lekë/m^2
1.	Ndërtesa banimi.	300	100
2.	Ndërtesa për tregti e shërbime.	700	300
3.	Ndërtesa të tjera.	500	200

1.Kjo taksë vendoset për rastet e transferimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
2.Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.
3.Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%.
4.Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
5.Pagesa e taksës së çdo ndërtimi fillon nga momenti i marrjes së lejes së shfrytëzimit, si detyrim i ndërtuesit. Me paraqitjen e kontratave të shitjes prej tij, detyrimi i lind subjektit blerës të sipërfaqjes së ndërtimit.
6.Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit të Bashkisë Elbasan, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Tabela E – Taksa për vendosjen e tabelës

	Kategoritë	Njësia matëse	Niveli i taksës Qyteti	Niveli i taksës Njësitë administrative
I	**Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit).**			
a	**deri në 2 m^2**	lekë/ m^2 /vit	0	0
b	**mbi 2 m^2 deri 10 m^2**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m^2 /vit	10,000	10,000
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m^2 /vit	15,000	15,000
	elektronike.	lekë/ m^2 /vit	20,000	20,000
c	**mbi 10 m^2 deri 20 m^2**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m^2 /vit	8,500	8,500
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m^2 /vit	12,750	12,750
	elektronike.	lekë/ m^2/vit	17,000	17,000
ç	**mbi 20 m^2 deri 40 m^2**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m^2 /vit	5,500	5,500
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m^2 /vit	8,250	8,250
	elektronike.	lekë/ m^2/vit	11,000	11,000
d	**mbi 40 m^2**			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m^2 /vit	4,000	4,000
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m^2 /vit	6,000	6,000
	elektronike.	lekë/ m^2 /vit	8,000	8,000
II	**Taksë tabele për qëllime identifikimi jashtë territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.**			
	Tabela identifikuese.	lekë/ m^2 /vit	120	120
III	**Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme, e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m^2**			

	e thjeshtë(me/pa ndriçim).	lekë/ m^2 /vit	22,500	22,500
	elektronike.	lekë/ m^2 /vit	45,000	45,000
IV	**Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.**			
	të të gjitha llojeve dhe përmasave.	lekë/ m^2 /ditë	1,000	1,000

1. Detyrimi për taksën e vendosjes së tabelës referuar kategorive I dhe II është vjetor.
2. Për "kategoritë I dhe II" për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës **31.07.2021** të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës **31.07.2021,** detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga momenti i deklarimit.
3. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji pasardhës që subjekti regjistrohet pranë QKB dhe taksa paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin, nga muaji pasardhës që regjistrohet pranë QKB.
4. Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.
5. Për "kategorinë III" për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës **31.07.2021** të vitit fiskal. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan.
6. Për "kategorinë IV" detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan dhe paguhet menjëherë.
7. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.
8. Tabelat kategorizohen në:

a.Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela

orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

b.Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

c.Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

9. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
10. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.
11. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.
12. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabele identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.
13. Institucionet e varësisë së Bashkisë Elbasan përjashtohen nga taksa për vendosjen e tabelës.
14. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.

F. Tarifat Vendore

Tabela F/1– Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit

Nr.	Subjekti	Niveli i Tarifës lekë/vit
1.	Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet prodhim metalesh nga skrapi ose minerali, shkrirje e substancave minerale, përpunimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, prodhimi i çimentos.	3,360,000
2.	Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi i mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, industria e peshkut dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjesimi i mbetjeve metalike, prodhim polisteroli, apo aktivitete të tjera, që ndikojnë në mjedis.	448,000
3.	Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: karrire guri (gurore), shfrytëzim të argjilave, shfrytëzim të lumenjve, që ndikojnë në mjedis.	336,000
4.	Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: industria e gomës dhe nënprodukteve të saj, prodhimi i polisterolit, industri të tjera, që ndikojnë në mjedis.	224,000
5.	Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi i mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve metalike, furrë buke, përpunimi i peshkut/mishit dhe nënprodukteve, që ndikojnë në mjedis.	25,000
6.	Subjektet persona fizik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi i mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve metalike, furrë buke, përpunimi i peshkut/mishit dhe nënprodukteve, që ndikojnë në mjedis.	8,000

1. Afati i pagesës së detyrimit është data **31.07.2021.**

Tabela F/2 Tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, shërbimit në tregje, dhe zgjatjeve të orarit

Nr.	Lloji i tarifës	Njësia	Niveli i tarifës

1.	**Tarifë pastrimi:**		
a	Familje.	lekë / vit	1,100
b	Biznesi i vogël (pa TVSH).	lekë / vit	8,000
c	Biznesi i vogël (me TVSH).	lekë / vit	15,000
ç	Biznesi i vogël (me TVSH), taksi dhe transport mallrash 0 - 3.5 ton.	lekë / vit	15,000
d	Biznesi i vogël (me TVSH), taksi dhe transport mallrash mbi 3.5 ton.	lekë / vit	20,000
dh	Restorant - biznes i vogël.	lekë / vit	20,000
e	Restorant - biznes i madh.	lekë / vit	40,000
ë	Biznesi i madh (tregti e shërbim).	lekë / vit	40,000
f	Biznesi i madh (njësi prodhimi).	lekë / vit	55,000
g	Firmë ndërtimi (pas lejes së përdorimit).	lekë / vit	30,000
gj	Firmë ndërtimi.	lekë / vit	60,000
h	Biznesi VIP (NUIS sekondar).	lekë / vit	60,000
i	Biznesi VIP (selia qëndrore).	lekë / vit	100,000
j	Institucione shtetërore.	lekë / vit	30,000
k	OJF	lekë / vit	3,000
2.	**Tarifa e gjelbërimit:**		
a	Familje në qytet.	lekë / vit	500
b	Biznesi i vogël (pa TVSH)/ OJF	lekë / vit	1,000
c	Biznesi i vogël (me TVSH), taksi dhe transport mallrash 0 - 3.5 ton.	lekë / vit	1,500
ç	Biznesi i madh/Institucione.	lekë / vit	5,000
d	Biznesi VIP (NUIS sekondar).	lekë / vit	25,000
dh	Biznesi VIP (selia qëndrore).	lekë / vit	100,000

3.	**Tarifa e ndriçimit:**		
a	Familje	lekë / vit	1,200
b	Biznesi i vogël, taksi dhe transport mallrash 0 - 3.5 ton.	lekë / vit	1,200
c	Biznesi i madh	lekë / vit	6,000
ç	Institucione.	lekë / vit	5,000
d	Biznesi VIP (NUIS sekondar).	lekë / vit	25,000
dh	Biznesi VIP (selia qëndrore).	lekë / vit	100,000
e	OJF	lekë / vit	700
4.	**Tarifë shërbimi në tregje:**		
a	Bagëti e imët në tregje publike.	lekë / krerë	50
b	Bagëti e trashë në tregje publike.	lekë / krerë	100
c	Fruta - perime në merkato dhe në tregjet e Njësive Administrative.	lekë / 1.3 m^2 / ditë	100
ç	Fruta - perime në rrugë.	lekë / 1.3 m^2 / ditë	200
d	Artikuj industrialë në rrugë.	lekë / 1.3 m^2 / ditë	200
5.	**Tarifë për zgjatje orari:**		
a	"Non Stop" për një natë.	lekë /ditë	10,000
b	Deri në orën 24^{00}.	lekë / vit	20,000
c	"Non Stop", karburante, lokale dasmash, etj.	lekë / vit	35,000
6.	**Tarifë për vërtetim**	lekë/vërtetim	100
7.	**Tarifë për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative**	lekë / vit	500

1. Familjet me ndihmë ekonomike përjashtohen nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë).
2. Familjet që figurojnë me banim në territorin e Bashkisë Elbasan por që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga tarifa e pastrimit, gjelbërimit,

ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë), pas paraqitjes së dokumentacionit që vërteton këtë fakt.

3. Personat me aftësi të kufizuar, invalidë, tetraplegjikë dhe paraplegjikë, të verbër, kur janë kryefamiljarë dhe nuk kanë persona të tjerë madhor në familje, me përjashtim të bashkëshortit/bashkëshortes, përjashtohen nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe tarifa për mirëmbajtjen e infrastrukturës në njësitë administrative (aty ku aplikohet kjo tarifë).
4. Institucionet e varësisë së Bashkisë Elbasan përjashtohen nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.
5. Subjektet që tregtojnë tek tregu industrial (lagja "Shënkoll"), tregu i fruta perime (Namazjaja dhe markata tek ish Zyra e Punës), tek fusha e vjetër e sportit, lagja "Luigj Gurakuqi" (tek rruga "Mustafa Sahatçi") trajtohen si ambulant.
6. Subjektet që tregtojnë në tregjet e Njësive Administrative Tregan, Gjinar, Funar, Shmil, Zavalinë, Papër, si dhe në tregun e bagëtive në Mengël, i nënshtrohen tarifës së shërbimit në tregje.
7. Ambulantët menaxhohen nga Sektori i Tregut dhe në fillim të vitit lidhen të gjithë kontratat. Në vazhdimësi, ndryshimet në kontrata depozitohen në Drejtorinë e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, jo më vonë se 5 ditë nga momenti i ndryshimit të kontratës.
8. Tarifat e ambulantëve në tregjet e miratuara bëhen 0 lekë (tarifa e pastimit, e ndriçimit, e gjelbërimit).
9. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është për familjarët U.K.E., Lagjet dhe Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative.
10. Për pikën 5/c (lokale dasmash) lista vendoset në dispozion nga Inspektoriati i Mjedisit para datës 31.01.2021 dhe rast pas rasti për subjktet e reja.
11. Afati për pagesën e tarifave të parashikuara në pikat 1, 2, 3, 5 germat b dhe c, dhe 7 është data **31.07.2021.** Për tarifat e mbetura pagesa ekzekutohet në momentin e marrjes së aprovimit.
12. Për subjektet e reja që nisin veprimtarinë pas datës 31.07.2021, afati për pagesën e tarifave sipas tabelës F/2 është **data 25 e muajit pasaardhës.**
13. Për mos pagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj (deri në 12 muaj). Përjashtohen nga gjoba tarifat e pikës 4, 5 dhe 7.

Tabela G. Tarifa për zënien e hapësirave publike

Nr.	Lloji i Tarifës	Niveli tregues Bashkia Elbasan Njësia	Njesitë e tjera Administrative Njësia
1.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës A.		

		360 lekë m^2/ muaj	
2.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës B.	220 lekë m^2/ muaj	
3.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës C.	100 lekë m^2/ muaj	
4	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti në Njësitë Administrative	50 lekë m^2/ muaj	
5.	Për personat dhe shoqëritë që shesin automjete në hapësirë publike (1 automjet x 5m^2 x 100 lekë).	500 lekë/automjet/ditë	500 lekë/automjet/ditë
6.	Tarifë për zënien e hapësirës publike gjatë ndërtimit për objekt mbi 4 kate.	150.000 lekë/vit	150.000 lekë/vit
7.	Tarifë për zënien e hapësirës publike gjatë ndërtimit për objekt nën 4 kate.	100.000 lekë/vit	100.000 lekë/vit
8	Tarifë kantieri/ ndërtim çatie, muri rrethues apo shkallë	5,000 lekë/ vit	5,000 lekë/ vit
9.	Tarifë për instalimin e "strukturave për nevoja të çastit dhe të përkohshme"	100 lekë/m^2/muaj	
10	Tarifë për instalimin e "strukturave për nevoja të çastit dhe të përkohshme" në Njësitë Administrative	50 lekë/m^2/muaj	
11	Tarifë për zënien e hapësirës publike për kampingje, ngritje tendash, për trajlera, rulotë dhe mjetet të tjera me përdorim të përkohshëm.	100 lekë/automjet/ditë	

1."Zona A", zona "B" dhe zona "C", për efekt tatimor janë zonat sipas hartës bashkëngjitur këtij projektvendimi. Kjo tarifë llogaritet duke shumëzuar sipërfaqjen e zënë me nivelin tregues të tarifës dhe numrin e muajve për të cilët merret në përdorim.

2.Kjo tarifë paguhet sipas kushteve të përcaktuara nga D.P.T.P dhe përllogaritjes së detyrimit nga D.T.T.V.M.A. Pas kryerjes së pagesës subjekti duhet të lidhë kontratë me institucionin.

3.Pagesa e kësaj tarife bëhet në momentin e nënshkrimit të kontratës.

4.Me strukturë të përkohshme do të kuptohen ato struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, muraturë e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 6-mujor.

5.Subjekte të cilët kryejnë aktivitet në shëshet publike përjashtohen nga tarifat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të tabelës së mësipërme pas lidhjes së marrëveshjes me Bashkinë Elbasan.

6.Strukturat e caktuara për vjeljen e kësaj tarife për pikat 1, 2,3 dhe 7 janë Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave dhe Njësitë Administrative, ndërsa për pikat 4 dhe 5, është D.P.T.P.

Tabela H. Tarifat Vendore të transportit

1	**Tarifë Parkimi**		
1-1	Tarifë orare parkimi.	lekë /ora	50
1-2	Tarifë vjetore parkimi.		
1-2a	Taksi 4+1.	lekë /vit	5,000
1-2b	Taksi 8+1.	lekë /vit	5,000
1-2c	Autovetura familjare.	lekë /vit	1,500
1-2d	Automjet transport i përzier deri 3.5 ton.	lekë /vit	2,500
1-2e	Kamion transport malli 3.5 deri 8 ton.	lekë /vit	4,000
1-2f	Kamion transport malli 8 deri 14 ton.	lekë /vit	5,500
1-2g	Kamion transport malli mbi 14 ton.	lekë /vit	6,500
1-2h	Autobus.	lekë /vit	9,000

1-3	Parkim i rezervuar në rrugë dhe sheshe për subjektet e liçensuara.				
paketa/abonim		orari 07:00 deri më 23:00	ditë/vit	lekë/ditë	tarifa/lekë
	Kontrata 1 vit (nga e hëna në të diel).		365	200	73,000
1-3 a	Tarifë rivendosje tabele parkim i rezervuar	lekë/ rivendosje			3,000

2	**Karroatreci**	lekë/ngarkesë	3,000
3	**Tarifë embleme taksi**	lekë/mjet	500
4	**Leje qarkullimi në qytet për mjetet e rënda**		
4.1a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.	lekë/ditë	100
4.2a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.	lekë/ditë	200
4.3a	Leje ditore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.	lekë/ditë	300
4.1b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.	lekë/ 3 muaj	4,500
4.2b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.	lekë/ 3 muaj	6,000
4.3b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.	lekë/ 3 muaj	7,500
4.1c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.	lekë/ vjet	10,000
4.2c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.	lekë/ vit	15,000
4.3c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.	lekë/ vit	20,000
4.1d	Leje vjetore per mjetet me kapacitet deri ne 3.5 ton (ATP)	lekë/vit	5,000
5	Leje qyteti për karrocat.	lekë/vit	2,000

Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, Sektori i Transportit, në Bashkinë Elbasan.

Tabela H/1 Tarifat për liçensa/autorizime/çertifikata

Nr	Emërtimi	Njësia	Tarifa në lekë	Afati
A	***Transport udhëtaresh***			
1	Liçensë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit.	për linjë	80,000	10 vjeçar
1.a	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës.	për mjet	7,500	5 vjeçar

2	Licensë për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit.	për linjë	40,000	10 vjeçar
2.a	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetëse.	për mjet	7,500	5 vjeçar
3	Licensë për kryerjen e Shërbimevetë rregullta të specializuara, të udhëtarëve.	për linjë	20,000	5 vjeçar
3.a	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta specializuara, të udhëtarëve.	për mjet	7,500	5 vjeçar
4	Licensë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve.	për linjë	20,000	5 vjeçar
4.a	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve.	për mjet	7,500	5 vjeçar
5	Çertifikatë e lëshuar për operacione të transportit të udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit.	për mjet	7,500	5 vjeçar
6	Licensë për transport udhëtarësh me taksi.	për mjet	20,000	5 vjeçar
B	***Transport mallrash***			
1	Licensë për transport të mallrave për të tretë dhe/ose me qera brenda vendit.	për licensë	40,000	5 vjeçar
1.a	Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.	ton/kapacitet	100	1 vjeçar
2	Çertifikate për tërheqës.	për tërheqës	1,500	1 vjeçar
3	Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet.	ton/kapacitet	100	1 vjeçar
C	***Shërbime transporti***			
1	Licensë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit.	për licensë	15,000	5 vjeçar
2	Licensë për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh.	për licensë	40,000	5 vjeçar
D	***Veprime të tjera***			

1	Autorizim i përkohshëm.	për autorizim	2,000	1 mujor

Shënim: Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet **30% e vlerës së plotë.**

Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, Sektori i Transportit, në Bashkinë Elbasan.

Tabela H/2 Tarifat për dhënie license për tregtimin e naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Njësitë e tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre				
1	Licensë për tregtimin me pakicë të karburanteve, GLN- ve për automjete e vajrave lubrifikante.	Për licensë	1,000,000	Nga 1 deri në 5 vjet
2	Licensë për tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse për ngrohje dhe gatim (GLN).	Për licensë	100,000	Nga 1 deri në 5 vjet
3	Autorizimin hyrje-dalje në rrugë për pikën e karburantit.	Për autorizim	2,000	Përhershëm

Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, Sektori i Transportit, në Bashkinë Elbasan.

Tabela I. Tarifat vendore për ujitjen dhe mirëmbjtjen e rrjetit kullues dhe ujitës

Nr	**Tarifa për popullatën.**	**Lekë/vit**	**Elbasan**	**Njësitë Administrative**
1	Tarifë mirëmbajtje të sistemit të kullimit.	lekë/dynym	0	130
2	Tarifë mirëmbajtje të sistemit të ujitjes.	lekë/dynym	0	120
3	Tarifë ujitje me kanal të hapur, rrjedhje e lirë.	lekë/dynym	0	150
4	Tarifë ujitje me sistem të mbyllur tubacioni.	lekë/dynym	0	50
5	Tarifë ujitje me pompat private kur merr ujë nga kanali ujitës i fshatit.	lekë/dynym	0	100

Strukturat e caktuara për vjeljen e kësaj Tarife janë:

1. Njësitë Administrative dhe Lagjet në bashkëpunim me strukturat e A.SH.P, Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative.

2. Në ato fshatra ku Bashkia Elbasan nuk kryen shërbimin tarifa është 0 lekë[3].

Tabela J. Tarifat e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit

	Lloji i tarifës	Njësia	
1.	Tarifë aplikimi për Çertifikatë Përdorimi	lekë	5,000
	a. Objekt banimi.	lekë/m^2	80
	b. Objekt për leje biznesi.	lekë /m^2	100
	c. Objekt në fazën karabina.		70% e vlerës totale
2.	Tarifë e hartimit të PDV për sipërfaqjen e pronës (gjatë lejes së ndërtimit).	lekë/m^2	50
3.	Tarifë aplikimi për leje zhvillimi.		
	a. Leje zhvillimi në zonat me PDV.	lekë	0
	b. Leje zhvillimi – objekte deri në 4 kate (zona pa PDV).	lekë	5,000
	c. Leje zhvillimi – objekte mbi 4 kate (zona pa PDV).	lekë	10,000
4.	**Tarifë aplikimi për leje ndërtimi.**		
	a. Leje ndërtimi për objekt deri në 4 kat.	lekë	15,000
	b. Leje ndërtimi për objekt mbi 4 kat.	lekë	30,000
	c. Leje Ndryshim funksioni.	lekë	10,000
	ç. Leje rikonstruksion pa ndryshim funksioni.	lekë	10,000
	d. Leje rikonstruksion me ndryshim funksioni.	lekë	15,000
	dh. Leje për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit.	lekë	5,000
	e. Leje për ndryshim projekti gjatë ndërtimit.	lekë	5,000
	ë. Leje për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit.	lekë	5,000

[3] Përjashtohen nga kjo tarifë fshatrat në të cilat nuk ofrohet shërbimi, pas lëshimit të vërtetimit nga A.Sh.P .

	f. Leje për prishje objekti.	lekë	10,000
	g. Leje për ndërtim mur rrethues dhe ndërtim çatie e pashfrytëzueshme apo shkallë.	lekë	5,000
	gj. Leje për punime infrastrukture	lekë	10,000
5.	**Deklarim paraprak.**	lekë	5,000
6.	**Tarifë për çertifikim relievi.**	lekë	8,000
7.	**Tarifë plan rilevimi:**		
	a. Troje me sipërfaqje deri 500 m^2	lekë	10,000
	b. Troje me sipërfaqje mbi 500 m^2	lekë	15,000
8.	**Tarifë fasade.**	lekë/m^2	25
9.	**Tarifë për dhënie dokumenta nga arkiva DPTP-së:**		
	a. Fotokopje e njësuar 1:500 v.1938-1988 A3.	lekë	500
	b. Fotokopje e njësuar 1:500 v.1938-1988 A4.	lekë	200
	c. Fotokopje të studimeve urbanistike në fuqi A3.	lekë	500
	ç. Fotokopje të studimeve urbanistike në fuqi A4.	lekë	200
	d. Njehësimi hartave me origjinalin A2,1,0.	lekë	1,000
	dh. Fotokopje e çdo dokumenti të njëhsuar A4.	lekë	200
	e. Fotokopje e çdo dokumenti të njëhsuar A3.	lekë	500
10.	Tarifa kantieri brenda pronës	lekë/vit	
	a.Tarifë kantieri/prishje objekti ose rikonstruksion.	lekë/vit	15,000
	b.Tarifë kantieri për objekt deri në 250 m^2	lekë/vit	25,000
	c.Tarifë kantieri për objekt mbi 250 m^2 për qëllimi jo fitimi përjashtuar objektet shumëkatëshe.	lekë/vit	40,000
	ç.Tarifë kantieri për objekt shumëkatësh me qëllim fitimi nga firmat e ndërtimit.	lekë/vit	100,000
	d.Tarifë kantieri/ ndërtim çatie, muri rrethues apo shkallë	lekë/ vit	5,000

Shënim: Për të njëjtin aplikim, në rast përsëritje, tarifa e aplikimit nuk do të të paguhet.

Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve, në Bashkinë Elbasan.

Tabela K. Tarifat vendore të veterinarisë

1	**Tarifa të sektorit veterinar**	**Njësia**	**Tarifa**
a	**Çertifikatë veterinare lëvizje për import**		
	1.Për shpendë të kultivuar.	lekë /krerë	5
	2.Të imta dhe derra.	lekë /krerë	20
	3.Të trasha (njëthundrrake, gjedh).	lekë /krerë	50
b	Kontroll dhe lëshim i çertifikatës veterinare për produkte mishi për eksport.	lekë /ton	100
c	Kontroll dhe lëshim i çertifikates veterinare për produkte baxho, sallami dhe qofte.	lekë /muaj	1,500
d	Kontroll dhe lëshim i çertifikates veterinare për produkte frigoriferike të mishit dhe të qumështit.	lekë /muaj	2,000
e	Kontroll dhe lëshim i çertifikates veterinare për tregtimin e peshkut deri në 1 ton.	lekë /muaj	2,000
f	Kontroll dhe lëshim i çertifikates veterinare për tregtimin e vezëve deri në 100,000 kokrra.	lekë /muaj	1,000
g	**Çertifikatë lëvizjeje të bagëtive të gjalla nga ferma në drejtim të tregut, thertores etj., brenda vendit.**		
	1.Bagëti të trasha (kalë, gomar, lopë, ka, mëshqerrë, mëz, viç, buall, buallicë, kotorr).	lekë /krerë	100
	2.Bagëti të imta (dhi, cjap, dash, rrurza, milor, ftujak, keç, qingj).	lekë /krerë	50
	3.Derra, dosa, gica.	leke/krerë	50
	4.Shpendë të kultivuar.	leke/krerë	5
h	**Kontroll dhe çertifikim veterinar në thertore.**		

	1.Bagëti të trasha (lopë, ka, buall, buallicë, mëshqerrë, mëz, viç, kotorr).	lekë /krerë	100
	2.Bagëti të imta (dhi, dash, cjap, rrurza, milor, ftujak, keç, qingj).	lekë /krerë	50
	3.Derra, dosa, gica.	lekë /krerë	50
i	**Tarifa të therjes në thertoren publike të Bashkisë.**		
	Të trasha:		
	1. Lopë, ka, buall, buallicë.	lekë krerë	700
	2.Mëshqerrë, mëz.	lekë /krerë	500
	3.Viç, kotorr.	lekë /krerë	400
	Të imta:		
	1.Dele, dash, dhi, cjap.	lekë /krerë	100
	2.Rrurza, milor, ftuja, ftujak.	lekë /krerë	100
	3.Qingj, keç.	lekë /krerë	50
	Derra:		
	1.Dosa, harça.	lekë krerë	500
	2.Gica.	lekë /krerë	100

Struktura e caktuar për mbledhjen e këtyre tarifave është Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit (Sektori i Veterinarisë).

Tabela L. Tarifa të shërbimeve të institucioneve vartëse

		Njësia	Tarifa
1.	**Tarifë për përdorim sale.**		
a.	Salla në teatrin "Skampa" për qëllime artistike	lekë/ditë	15,000
b.	Salla në teatrin "Skampa" për jo qëllime artistike	lekë/ora	20,000

c.	Salla e teatrit të kukllave.	lekë/ditë	5,000
d.	Salla e pallatit të sportit të sportit	lekë/bileta	100÷1.000
2.	**Tarifë për shfaqje.**		
a.	Shfaqje në teatër muzikë variete	lekë/bileta	200÷1.000
b.	Për studentët, invalidët, pensionistët		50% të vlerës
c.	Shfaqje në teatrin e kukullave	lekë/bileta	100
d.	Dhënie me qira kostume tradicionale	lekë/kostum/ditë	1.000
e.	Qira për foni + ndriçim	lekë/aktivitet	15.000÷50.000
3.	**Hyrje në vende muzeale**		
a.	Për të rritur	lekë/bileta	200
b.	Për nxënës e studentë	lekë/bileta	50
4.	**Ndeshje sportive**	lekë/bileta	100÷1.000
5.	**Tarifë për ushqime (kuota ushqimore)**		
a.	Për ushqim në çerdhe	lekë/dita	160
b.	Për ushqim në kopësht	lekë/dita	160

1. Për pikën 1.d, 2.a, 2.e, dhe 4 tarifat miratohen nga Bordi Artistik.
2. Strukturat e caktuara për vjeljen e këtyre tarifave janë Qendra e Artit, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Qendra e Trashëgimise Kulturore.

Tabela L/1. Tarifat vendore mbi shërbimin e varrimit

	Tarifat	**Njësia**	**Tarifa**
a.	Përgatitje kurore.	lekë	465
b.	Përgatitje shirit kurore.	lekë	350
c.	Shitje kurore të vogël.	lekë/copë	1,500
d.	Shitje kurore të mëdhe.	lekë/copë	3,400

e.	e- Afishime, fletë thirrje, lajmërime	lekë	95
f.	Transport kufome	lekë	2,110
g.	Prodhim arkivoli të vogël	lekë	2,270
h.	Prodhim arkivoli të madh	lekë	5,850
i.	Hapje/mbyllje varri për të vegjël	lekë	525
j.	Prodhime varri nëntokësore për të vegjël	lekë	1,580
k.	Prodhime varri mbitokësore për të vegjël	lekë	875
l.	Vendosje varri mbitokësorë për të vegjël	lekë	330
m.	Tarifë hapje/mbyllje varri, plaka varri nëntokësore/mbitokësore për të rritur	lekë	10,400
n.	Për proçese brenda varrezave publike për të rritur	lekë	8,245
o.	Për proçese jashtë varrezave publike	lekë	8,650
p.	Për varrimet e thjeshta për të vegjël	lekë	3,700
q.	Për proçese brenda varrezave publike për të vegjël	lekë	3,300
r.	Për proçese jashtë varrezave publike	lekë	5,280
s.	Tarifë zhvarrimi	lekë/zhvarrim	6,700
t.	Tarifë shërbimi me të tretë	lekë/ora	2,500

1. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Agjencia e Shërbimeve Publike.

Tabela L/2. Tarifat vendore për shfrytëzimin e truallit publik për tubacionet, kabllot telefonike, fiber optike

Nr.	Lloji i tarifës		
1-	**Tarifë për shfrytëzim të truallit publik për tubacione të ujrave të bardha e të zeza:**		
	- tubacion uji i pijshëm, diametri > 200÷600 mm.	lekë/ml/vit	20

	- tubacion uji i pijshem, diametri > 80÷200 mm.	lekë/ml/vit	10
	- tubacion uji i pijshem, diametri ÷ 80 mm.	lekë/ml/vit	5
	- tubacion i ujrave të zeza, diametri < 200 mm.	lekë/ml/vit	2
	- tubacion i ujrave të zeza, diametri > 200÷600 mm.	lekë/ml/vit	3
	- tubacion i ujrave të zeza, diametri > 600 mm.	lekë/ml/vit	5
2-	**Tarifë për shfrytëzim të truallit publik për kabllot telefonike, fiber optike:**		
	Kabëll telefonik, fiber optike (nëntokësor dhe ajror).	lekë/ml/vit	20

1. Tarifa për prishje asfalti nga Ndërmarrja "Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.", Ndërmarrja P.T.T., Ndërmarrja Elektrike dhe qytetarët, do të jetë sipas preventivit të depozituar pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.
2. Për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik, tarifat vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore, si: tubacione, kanale etj., të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe për përdorimin e hapsirës publike.
3. Strukturat e caktuara për vjeljen e këtyre tarifave janë Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban dhe Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes se të Ardhurave.

Tabela L/3. Tarifat vendore për pyjet dhe kullotat

Nr.	Emërtimi	Njësia	Vlera e tarifës
1	Tarifë për shërbimet profesionale që kryhen në fondin pyjor privat	lekë/shërbim	500
2	Tarifë për shitjen e vërtetimit të transportit, për lëvizjen e produkteve drusore dhe jodrusore pyjore	lekë/copë	200
3	Tarifë për vërtetim	lekë/copë	200
4	Tarifë për prerje druri për nevoja familjare në pyjet vendore të miratuara në Njësitë Administrative	lekë/m^3	500

1. Për të gjithë tarifat e tjetra që aplikohen në sektorin pyjeve dhe të kullotave do të zbatohen tarifat sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin

e tarfave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" ndryshuar me Vendimin ë Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 'Për disa ndryshime në vendimin e nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarfave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore".

2. Strukturat e caktuara për mbledhjen e këtyre tarifave do të jenë:Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit (Sektori i Pyjeve dhe Kullotave), për tarifat e pikave 1,2,3.
3. Njësitë Administrative dhe Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit (Sektori i Pyjeve dhe Kullotave) për pikën 4.

Tabela L/4. Tarifa për sektorin e bujqësisë

Nr.	Emërtimi	Njësia	Vlera e Tarifës
1	Tarifë për vërtetim toke në pronësi ose në përdorim dhe kategoria e saj.	lekë/copë	100
2	Tarifë për ushtrim aktiviteti bujqësor e blegtoral.	lekë/copë	100
3	Tarifë për kërkesë për ndryshim të bonitetit të tokave.	lekë/copë	200
4	Tarifë për kërkesë për aplikim për subvencione bujqësore e blektorale.	lekë/copë	100

1. Strukturat e caktuara për mbledhjen e ketyre tarifave janë:
2. Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit (Sektori i Bujqësisë) dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan.

L/5. Tarifë për përdorimin e kullotave dhe livadheve për kullotje.

1. Tarifa do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje", me ndryshimet që mund të pësojë ky vendim.
2. Strukturat e caktuara për mbledhjen e ketyre tarifave janë Agjencia e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan.
3. Strukturat e caktuara për mbledhjen e këtyre tarifave janë Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan.

N. Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Nr.	Lloji i tarifës	Njësia	Niveli i tarifës
1.	**Për kundërfirmimin e studimeve urbanistike, të planeve rregulluese, projekteve të shesheve të ndërtimit dhe të objekteve brenda tyre.**		
a	Për projektet e mbrojtjes nga zjarri, që u bëhen studimeve urbanistike dhe planeve rregulluese.	lekë	0.5 % e vlerës së projektit
b	Për banesat, rikonstruksionet e tyre e shtesë kati në to, si dhe për çdo lloj objekti ndërtimi, me vlerë deri në 1 000 000 lekë.	lekë	500
c	Për banesat, dyqanet, lokalet, serviset, repartet artizanale, magazinat e mallrave etj., me vlerë investimi nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë.	lekë	1,000
ç	Për hotelet, motelet, rezidencat, komplekset e dyqaneve ose supermarketet me vlerë investimi deri në 20,000,000 lekë.	lekë	5,000
d	Për objektet me vlerë investimi deri në 50,000 000 lekë.	lekë	10,000
dh	Për objektet me vlerë investimi mbi 50,000,000 lekë.	lekë	15,000
e	Për ndërtime qyteza e fshatra turistike, si dhe për vepra të tjera me vlerë investimi mbi 1 000 000 USD.	lekë	50,000
2.	**Për objektet me rrezik të theksuar për rënie zjarri e shpërthimi.**		
a	Për fabrikat, uzinat e qendrat e përpunimit të naftës e gazit te lëngëzuar, fabrikat e polisterolit e për prodhime kimikatesh, si dhe për vepra e objekte me proçes teknologjik me rrezik zjarri të kategorive "A" dhe "B" (përcaktuar me rregulloren e projektimit te ndërtesave të çdo lloji).	lekë	30,000
b	Për depo qëndrore karburanti, pika të shitjes së karburanteve dhe impiante të depozitimit dhe mbushjes së bombolave me gaz të lëngëzuar.	lekë	20,000
c	Për qendra e magazina të depozitimit të gazit të lëngshëm me shumicë, të karburanteve e lubrifikanteve në fuçi, të kimikateve e lëndëve të tjera me rrezik zjarri.	lekë	15,000
ç	Për projekte të shfrytëzimit të burimeve të naftës, puse të shpim-kërkimit për tubacionet magjistrale të transportimit dhe për të gjithë infrastrukturën që lidhet me shfrytëzimin e tyre.	lekë	20,000
d	Për fabrika mielli, përpunimi druri, përpunimi të bimëve medicinale, të prodhimit të veshjeve dhe objekteve të tjera me proçes teknologjik me rrezik zjarri të kategorisë "C".	lekë	15,000
dh	Për fabrika e ndërmarrje te përpunimit e prodhimit të produkteve ushqimore, të detergjentëve, të prodhimeve kozmetike, të pijeve alkoolike etj.	lekë	20,000

e	Për rikonstruksionet që kryen në të gjitha këto objekte, të cilat bëhen në bazë të projekteve përkatëse.	lekë	5,000
3.	**Për kontrollin teknik.**		
a	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, me përfundimin e veprës apo të objektit, kontrollon, harton dhe u jep personave, juridik e fizikë, shoqërive private e shtetërore, aktin teknik përkatës, në mbështetje të nenit 31, të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001.	lekë	5,000
b	Për përdorimin e automjeteve (autobote) që transportojnë karburante, gaze te lëngëzuar, alkoole, kimikate me rrezik zjarri, jepet akti teknik për plotësimin e normave teknike të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.	lekë	1,000
c	Për ripërtëritjen vjetore të aktit teknik.	lekë	1,000
4.	Dhënia personave juridikë, vendas a të huaj, të liçensës për prodhimin, mirëmbajtjen dhe tregtimin e teknikës, pajisjeve zjarrfikëse dhe lëndëve për shuarjen e zjarrit.	lekë	25,000
a	Ripërtëritja e liçensës.	lekë	10,000
5.	Për kryerjen e aktekspertizes për zjarret e rëna, kur kërkohet nga organet e prokurorisë, të gjykatës ose nga vetë shtetasit, personat juridike e fizike, vendas e të huaj.	lekë	25,000
6.	Tarifa e ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve nga shërbimi i MZSH- së në objektet e siguruara nga zjarri nga shoqëritë e sigurimit.	lekë/orë ndërhyrje	15,000

1. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (M.Z.SH.) rregullohet nga ligji nr. 152/2015 "Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
2. Tarifat në lidhje me shërbimet e MZSH-së përcaktohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 12.10.2016 "Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 9.11.2016 "Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara nga zjarri dhe administrimin e përdorimin e të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor MZSH-së".
3. Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria Vendore e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, pranë Bashkisë Elbasan.

1.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Elbasan

2.Ky vendim hyn në fuqi në 01.01.2021

Konceptoi:

Zv /Kryetar i Bashkisë: Irland Sina Ervin Saraçi
Drejtoria Juridike: Ornela Deliallisi
Drejtoria e P.P.A.A.B.F:Qemal Tusha A. Saraçi E. Behluli A. Merkja
Drejtoria e Përgj.Shërbimeve Organizative: Bardhul Çabiri
Drejtoria e Përgj. Shërbimeve Operacionale: Etleva Kënuti, Alba Canaj
Drejtoria e Përgj. Shërbimeve Infrastrukturore : Albert Hajrullai Servo Mehmeti
Drejtoria e Kordinimit me Njësitë Administrative: Shefqet Bullari
Agjensia e Shërbimeve Publike: Shkëlqim Sinani
Agjensia e Shërb. Pyjore, Bujqësore,Veterinare, Mjedisore: Shpëtim Çullhaj
Inspektoriati i Mjedisit: Leli Kaja
Avokati i Qytetit: Arben Hoxha

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ELBASAN

5618/2
7-12.20

43

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1605/1 **Prot.** **Elbasan më** 7.12.**2020**

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.164 datë 27.11.2020 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2021", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Klevis Xhoxhi

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, www.prefekti.elbasan.gov.al, email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

1672
17.12.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr.6178/1 Prot Elbasan më 17 /12/ 2020

VENDIM
Nr. 165 datë 17 /12/2020

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin NENTOR 2020

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **NENTOR 2020** gjithsej 206 familje me një fond prej 678.136 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:
Dr. Sh. K. S Komunitar Sh. Lika
Drejtori Juridik O. Deliallisi

Drejtori Buxheti p/M. Beluli
Drejtori Finances A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

1673
17.12.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 6171 Prot Elbasan më 17 /12/2020

VENDIM

Nr 166 datë 17 /12/2020.

